BANKA E SHQIPËRISË

BULETINI EKONOMIK

Botim tremujor

Mars 2003

Artikujt e paraqitur në këtë botim, nuk shprehin gjithmonë opinionin zyrtar të Bankës së Shqipërisë. Këtyre artikujve lutemi t'u referoheni si mendime personale të autorëve.

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi jeni të lutur të citoni burimin.
Botuar nga : Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë.
Tel : 355-4-222230; 235568; 235569;
Faks : 355-4-223558

Për informacione lidhur me këtë publikim, lutemi kontaktoni
Sektori i Publikimeve, Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun.
Shtypur në Shtypshkronjën e Bankës së Shqipërisë.
Tirazhi : 1000 kopje

BULETINI EKONOMIK TREMUJOR

MARS 2003

PËRMBAJTJA

TRANSPARENCA NËPËRMJET KOMUNIKIMIT MASIV ME PUBLIKUN
LEKSION I GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, ZOTIT SHKËLQIM CANI NË TAKIMIN ME BIZNESMENË DHE NXËNËS TË SHKOLLAVE TË QYTETIT TË SARANDËS, SHKURT 2003. 4
I. Sistemi bankar, banka e shqipërisë, politika monetare, pavarësia inflacioni etj. 4
II. Sistemi bankar 4
III. Banka qendrore, politika monetare dhe inflacioni. 6
IV. Pavarësia e bankës së shqipërisë 11

BANKA QENDRORE DHE INFLACIONI. 13
LEKSION I GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, ZOTIT SHKËLQIM CANI ME DATË 20 MARS, FAKULTETI EKONOMIK NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR XHUVANI",ELBASAN. 13
I. Konsiderata të përgjithshme për inflacionin. 13
II. Matja e inflacionit: rasti i shqipërisë. 13
III. Natyra e inflacionit dhe shkaktarët e tij kryesorë: raste studimi 16
IV. Bankat qendrore, politika monetare dhe inflacioni. 19
V. Normat e inflacionit dhe matjet e tij. 26
VI. Raporti mujor i politikës monetare dhe inflacioni. 29
VII. Zhvillimet monetare gjatë muajit janar 2003. 30
VIII. Ecuria e normave të interesit. 33

INSTRUMENTET E POLITIKËS MONETARE: SI TË ZGJEDHIM & KUADRI OPERACIONAL I BANKËS SË SHQIPËRISË
LEKSION I GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, ZOTIT SHKËLQIM CANI, NË MARS 2003, NË UNIVERSITETIN BUJQËSOR TË TIRANËS. 34
Evoluimi i instrumenteve te politikës monetare. 36

REAGIMI I TREGJEVE NDAJ VENDIMEVE TË POLITIKËS MONETARE.
PUNUAR NGA SUZANA SHEQERI DHE ARTA PISHA, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE DHE POLITIKAVE MONETARE 43

BANKA TREGTARE E GREQISË (SHQIPËRI) 55

RAPORT I EKSPERTIT KONTABËL TË AUTORIZUAR 56

LAJMET JANAR - MARS 2003 74

LISTA E SUBJEKTEVE TË LICENCUARA NGA BANKA E SHQIPËRISË 78

BANKA DHE DEGË TË BANKAVE TË HUAJA 78

SUBJEKTE JOBANKA 81

SUBJEKTET FINANCIARE QË NUK LICENCOHEN NGA BANKA E SHQIPËRISË PËR KRYERJEN E VEPRIMTARISË SË TYRE, NË MBËSHTETJE TË VENDIMIT NR. 26, DATË 29.03.2000, TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË: "PËR PËRJASHTIMIN E DISA SUBJEKTEVE NGA ZBATIMI I DISPOZITAVE TË LIGJIT NR. 8365, DATË 02.07.1998. 82

ZYRA TË KËMBIMEVE VALUTORE 83

UNIONET E SHOQERIVE TE KURSIM KREDITIT 88

TRANSPARENCA NËPËRMJET KOMUNIKIMIT MASIV ME PUBLIKUN

LEKSION I GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, ZOTIT SHKËLQIM CANI NË TAKIMIN ME BIZNESMENË DHE NXËNËS TË SHKOLLAVE TË QYTETIT TË SARANDËS, SHKURT 2003.

I. SISTEMI BANKAR, BANKA E SHQIPËRISË, POLITIKA MONETARE, PAVARËSIA INFLACIONI ETJ.[1]

Në takimin tonë të sotëm mendova që të bisedoj me ju disa realitete të thjeshta ekonomike, të cilat përveçse ju i hasni rëndom në jetën tuaj të përditshme, shpesh ju qëllon që të jeni dhe protagonistë të tyre. Më konkretisht, do të doja të sillja tek ju një përfytyrim më real të bankingut qendror dhe atij tregtar në Shqipëri, të rregullave të lojës që duhet të respektojë sistemi bankar, për të vazhduar më tej me çështje madhore ekonomike, për të cilat ju shpesh dëgjoni të flitet në ekranet televizive.

II. SISTEMI BANKAR

Në praktikën e përditshme, individët me termin bankë nënkuptojnë të gjitha institucionet që mbajnë këtë emër të shkruar diku në vitrinë dhe, në përgjithësi, ata nuk duan të dinë nëse kanë të bëjnë me një bankë tregtare të tipit universal, apo me një bankë investimesh apo diçka tjetër, me një bankë qendrore për shembull.

Ndoshta është momenti që të bëjmë disa saktësime. Le të japim në fillim një përshkrim të shkurtër të të ashtuquajtuarës bankë qendrore. Historikisht, emri bankë qendrore ju vu atyre institucioneve financiare që në një mënyrë apo në një tjetër gëzuan atributin që të emetonin monedhën e atij shteti ku ato operonin. Me kalimin e viteve, këto institucione erdhën duke u perfeksionuar. Pikë së pari, ato kuptuan se vlera e kësaj paraje që shtypet dhe nxirret në qarkullim nga arkat e tyre, duhet ruajtur me çdo kusht, përndryshe ato duhet të rishtypin pambarimisht monedha të reja. Në këtë rast, besueshmëria mbi paranë dhe vetë institucionin e tyre do të binte vazhdimisht. Pra, përveç rolit të arkës së shtetit dhe emetuesit të monedhës, aktiviteti i tyre u pasurua me elemente të reja, si të ruhet vlera e monedhës, tërësia e të cilave njihet si hartim dhe zbatim i politikës monetare të vendit. Në kohët moderne, ky funksion i bankave qendrore, në mënyrë të vazhdueshme ka fituar terren, dhe sot nocioni bankë qendrore është i pandashëm nga nocioni politikë monetare.

Edhe në rastin e Bankës së Shqipërisë, me pak fjalë do të thosha se kemi të bëjmë me një rast tipik të ekpseriencës ndërkombëtare në fushën e bankingut qendror. Banka e Shqipërisë është bankë e Shtetit Shqiptar, e cila në përputhje me bazën ligjore në fuqi, ka për detyrë:

- Hartimin dhe zbatimin e politikës monetare të vendit.
- Hartimin dhe zbatimin e politikës valutore të vendit.
- Hartimin e rregullave për lëvizjen e fondeve valutore, si brenda vendit ashtu dhe jashtë kufijve të tij.
- Krijimin dhe mbikëqyrjen e sistemit bankar.
- Emetimin e monedhës dhe të kartëmonedhës.
- Këshillimin e qeverisë dhe sigurimin e një niveli të kualifikuar ekspertize në hartimin dhe në zbatimin e të gjitha politikave të tjera ekonomike dhe financiare të vendit.

Nga ana tjetër, bankat tregtare, janë institucione financiare të cilat, në themelin e tyre kanë një "privilegj" të madh, atë të të grumbulluarit të depozitave. Nisur thjesht nga ky fakt, kuptohet se bëhet fjalë për atë grup bankash ku normalisht qytetarët vendosin kursimet e tyre në formë depozitash.

Në Shqipëri, mund të thuhet se praktikisht industria financiare, me përjashtime të vogla pak a shumë vazhdon të identifikohet me sistemin bankar.

Të gjitha bankat e licencuara deri më sot, 15 të tilla, janë të tipit universal. Ato ofrojnë shërbimet e mëposhtme: pranojnë depozita, japin kredi,

[1] Leksion i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, zotit Shkëlqim Cani në takimin me biznesmenë dhe nxënës të shkollave të qytetit të Sarandës, Shkurt 2003

ofrojnë shërbimin e pagesave dhe të arkëtimeve, emetojnë, pranojnë dhe administrojnë mjete të pagesave, ndërmjetësojnë në transaksionet monetare, ofrojnë shërbimin e kasave të sigurimit, ofrojnë garanci bankare dhe garanci të tjera, shërbejnë si agjentë ose këshilltarë financiarë, ushtrojnë veprimtari të tjera bankare dhe financiare.
Pasi krijuam një lloj përshtypjeje mbi të dy tipet e institucioneve, atëherë mund të ngrinim dy pyetje të tjera:

- ç'lidhje ka midis këtyre dy llojeve të ndryshme të institucioneve financiare dhe;
- fakti që bankat tregtare grumbullojnë depozita nga të tretët, përfshirë popullsinë, nënkupton një mbikëqyrje të përdorimit të këtyre fondeve financiare në mënyrë të përshtatshme apo jo?

Po e filloj nga kjo e dyta. Është e vërtetë që bankat tregtare mobilizojnë shuma të mëdha fondesh financiare në formën e depozitave bankare. Kështu, bankës tregtare i jepet privilegji që të administrojë paratë e të tretëve, duke siguruar fitim për si vete ashtu dhe për pronarët e vërtetë të këtyre fondeve. Në jetën reale gjërat janë pak më ndryshe. Eksperienca të shumta, të vjetra dhe të reja, kanë treguar se disa banka nuk kanë qenë të afta të orientohen drejt në ekonominë e tregut e për rrjedhim ato kanë falimentuar, duke bërë që dhe kursimet e vendosura në formë depozitash, të humbasin në mënyrë masive. Rasti më tipik është ai i krizës së rëndë që goditi Shtetin Amerikan gjatë viteve '30, ku një nga simptomat më të dukshme ishte falimentimi masiv i bankave tregtare. Në këtë mënyrë, vijmë në një pikë që më duket se nuk ka nevojë për komente shtesë: Po bankat tregtare duhet t'i nënshtrohen një kuadri të rreptë mbikëqyrës nga autoritetet përkatëse, që në shumicën e rasteve korrespondon me bankën qendrore. Më konkretisht, i takon bankës qendrore të verifikojë periodikisht, nëse çdo bankë anëtare e sistemit, është duke respektuar rregullat e lojës apo jo? I takon asaj që të vlerësojë shkallën me të cilën çdo bankë tregtare është e ekspozuar ndaj rreziqeve të ndryshme, mënyrën si administrohen bankat, rezultatet financiare të tyre etj..

I gjithë ky proces njihet me emrin "mbikëqyrje bankare" dhe në rastin e vendit tonë ai është bashkëmoshatar me vetë sistemin bankar. Megjithatë, duhet të theksoj se me kalimin e viteve aftësia mbikëqyrësëse e Bankës së Shqipërisë është rritur ndjeshëm dhe afrohet dita-ditës me standardet ndërkombëtare.

Në përmbushjen e këtij funksioni kaq të rëndësishëm, Banka e Shqipërisë është përpjekur të ndërtojë një kuadër sa më të plotë të një mbikëqyrjeje të kujdesshme bankare, duke synuar në:

1. Krijimin e një sistemi bankar eficient dhe konkurrues.
2. Ruajtjen e besimit të publikut ndaj aktivitetit bankar.
3. Mbrojtjen e fondeve të depozituara në bankë, që në rast falimentimi të minimizojë humbjet e tyre.
4. Sigurimin e zbatimit të ligjeve dhe të rregulloreve të sistemit bankar.

Mbikëqyrja bankare fillon me licencimin e bankave, që bëhet në zbatim të kërkesave të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe të rregullores "Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë".

Aplikantët paraqesin idenë e tyre për krijimin e një banke, të argumentuar në kërkesën dhe në dokumentacionin e nevojshëm, në Bankën e Shqipërisë.

Kërkesat për aplikimin e marrjes së licencës ndryshojnë nga njeri vend në tjetrin, megjithatë qëllimi kryesor i tyre ka të bëjë me kufizimin e mundësisë që individët jo të ndershëm ose pa eksperiencë të krijojnë ose të marrin pjesë si bashkëaksionerë në një bankë.

Për të vlerësuar aktivitetin e ardhshëm të bankës nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, Banka e Shqipërisë mbështetet në:

- Kushtet ekonomike dhe konkurruese në zonën ku do të përqëndrojë aktivitetin banka.
- Shumën e mjeteve fikse të investuara në bankë dhe nevojat për kapital shtesë në të ardhmen.
- Planin operacional të bankës ose biznesplanin e saj të propozuar, i cili do

të shërbejë për të argumentuar strategjinë e krijuesve dhe të themeluesve të bankës për të marrë pjesë me sukses në treg.

- Kualifikimin e administratorëve të propozuar të bankës, i cili është një faktor i rëndësishëm që banka të ketë sukses. Në rradhë të parë, figura morale dhe integriteti i tyre dhe pastaj aftësia, eksperienca bankare e financiare e tyre.
- Burimin e kapitalit të përdorur për të filluar aktivitetin bankar dhe strukturën e tij. Në qoftë se nuk krijon bindjen se kapitali rrjedh nga një veprimtari e ligjshme dhe e dokumentuar qartë, kjo do të ishte një arsye për të rekomanduar refuzimin e kërkesës.

Dokumentacioni që kërkohet prej aplikuesve është i lidhur me faktorët që ndihmojnë në vlerësimin e kërkesës së bërë apo të iniciativës së marrë. Për të vlerësuar burimin e krijimit të kapitalit të bankës së propozuar, kërkohet informacion mbi themeluesit e bankës, mbi bizneset, mbi gjendjen financiare dhe mbi karakterin e tyre moral. Aplikantët paraqesin me dokumente të vërtetuara, gjendjen financiare të bizneseve të tyre, të ardhurat e tjera, të cilat janë burimi i fondeve që shërbejnë për të themeluar bankën.

Banka e Shqipërisë ka ndjekur nje politikë të hapur për çdo kërkesë të paraqitur për të marrë licencen për të kryer aktivitet bankar, e cila ka plotësuar standardet minimum të vendosura prej saj. Banka e Shqipërisë ka ndjekur dhe ndjek parimin, se është konkurrenca e lirë në treg që do të vendosë për bizneset që do të mbijetojnë apo do të mbyllen.

Banka e Shqipërisë është përpjekur që në kuadrin e saj rregullator dhe mbikëqyrës të zbatojë standardet ndërkombëtare dhe të ofrojë ndihmën e bashkëpunimin e saj për rastet e kërkesave të paraqitura.

III. BANKA QENDRORE, POLITIKA MONETARE DHE INFLACIONI.

Besoj se nga pjesa e parë kuptuat që një dallim thelbësor midis bankës qendrore dhe asaj tregtare qëndron në faktin që e para është autoritet licencues dhe mbikëqyrës i së dytës. Megjithatë, misioni i një banke qendrore, përfshirë dhe Bankën e Shqipërisë është më i madh. Aktualisht, imazhi i bankave qendrore, sa vjen e po identifikohet me një aftësi tjetër të saj, me funksionin që ajo ka për të hartuar dhe për të zbatuar politikën monetare të vendit. Një gjë të tillë kryen dhe Banka e Shqipërisë, e cila në përputhje me dokumentet ligjore më të larta të shtetit, duhet të hartojë dhe të zbatojë politikën monetare të vendit.

Diku në një libër mbi teorinë ekonomike të zotit Mishkin, jepet një shembull shumë i thjeshtë dhe shumë i kuptueshëm, që na ndihmon shumë për të kuptuar thelbin e politikës monetare. Për të qenë më konkret, besoj se ju ka rënë rasti të shikoni momentin e lëshimit të një anijeje të hapësirës të tipit shuttle, moment të cilin do ta shtjelloj pak për të bërë analogji me politikën monetare.

1 - Të dyja rastet e mësipërme kanë një qëllim final: në rastin e anijes hapësinore, objektivi final është bashkimi i anijes me stacionin e hapësirës, ndërkohë që në rastin e politikës monetare qëllimi final ka të bëjë me mbajtjen e inflacionit të ulët. Në dyja rastet qëllimi final, të cilin tani e tutje do ta quajmë objektiv final, nuk mund të arrihet me shkop magjik.

2 - Në rastin e anijes hapësinore fillimisht shërbejnë dy motorë shumë të fuqishëm, të cilët janë të aftë të shkëpusin anijen nga toka dhe ta nxjerrin atë jashtë ndikimit të gravitetit. Po kështu, në rastin e politikës monetare, na duhen një ose disa variabla ekonomikë, me anë të manipulimit të të cilëve arrijmë të ndikojmë një tregues tjetër ekonomik, që është një hap i ndërmjetëm në rrugën e gjatë dhe të vështirë për kontrollin e inflacionit. I gjithë ky proces, në teorinë ekonomike njihet si objektiv operacional i politikës monetare.

3 - Shkëputja nga atmosfera e Tokës është një hap i rëndësishëm për plotësimin me sukses të misionit të anijes hapësinore, por gjithësesi ai përsëri mbetet një hap i ndërmjetëm. Për këtë arsye, konstruktorët kanë menduar një zgjidhje tjetër: ekzistencën e dy motorëve të tjerë me fuqi më të vogël, të cilët do ta orientojnë lëvizjen e anijes

drejt stacionit të hapësirës. Po kështu, dhe në rastin e politikës monetare hap i fundit mbetet manipulimi i variablit të ndërmjetëm, ndryshimi i të cilit është testuar se në një kohë të mëvonshme ndikon atë që thamë në fillim: mbajtjen e inflacionit në nivele të ulëta. I gjithë ky proces, në teorinë ekonomike njihet si objektiv i ndërmjetëm i politikës monetare.

aktivitetin e Bankës së Shqipërisë, citohet se "arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve[3]", është objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë ndërkohë që, të gjithë objektivat e tjerë rrjedhin prej këtij objektivi.

Figura në vijim jep një pasqyrë të saktë se si Banka e Shqipërisë arrin të mbajë politikën e saj monetare.



Duke ju kthyer rastit tonë konkret, politika monetare e Bankës së Shqipërisë, për herë të parë u ideua dhe u zbatua në mesin e vitit 1992, kur, si pjesë e marrëveshjes së mbështetjes të FMN-së për Shqipërinë, u prezantuan për herë të parë disa vendime, të cilat synonin vendosjen e kontrollit mbi ofertën e parasë nëpërmjet përdorimit të instrumenteve të drejtpërdrejta të kontrollit monetar. Që në ligjin e parë të Bankës së Shqipërisë përmendet "ruajtja e vlerës së brendshme dhe të jashtme të monedhës kombëtare[2]", si rrjedhim i së cilës do të ishte sigurimi i stabilitetit të çmimeve të konsumit.

Në rrjedhën e viteve, objektivi final i politikës monetare të Bankës së Shqipërisë u rafinua më tej, duke tentuar gjithnjë e më shumë drejt një përcaktimi të qartë të stabilitetit të çmimeve si objektiv final të politikës monetare. Më konkretisht, në ligjin në fuqi që rregullon

Siç e tregon dhe figura 1, instrument parësor i politikës monetare të Bankës së Shqipërisë është norma fikse e përqindjeve të repos, e cila në varësi të sinjalit që do të çojë në treg Banka e Shqipërisë, ofrohet ose në ankande ku shuma e pranuar është e pakufizuar[4] kundrejt çmimit të fiksuar, ose në ankande ku shuma e pranuar është fikse[5] dhe çmimi i shpallur është nivel kufi.

Pavarësisht formës së ankandit qëllim i vetëm është kontrolli i likuiditetit në sistem, duke synuar mbajtjen e tij në nivele optimale, në mënyrë që të sigurohet eficiencë maksimale e mekanizmit të transmisionit.

Nga ana tjetër, siç mund të meret me mend, përqindja fikse e repove, shërben dhe si referencë për përqindjet e tjera, kryesisht e kam fjalën për lehtësirat kredituese që Banka e Shqipërisë i ofron sistemit bankar.

[2] Ligji nr. 7559, datë 22.4.1992, " Për Bankën e Shqipërisë" , neni 3, paragrafi 1.
[3] Ligji nr. 8269, datë 23.12.1997, " Për Bankën e Shqipërisë" , neni 3, pika 1.
[4] Në këtë rast, mund të thuhet se tregut i jepet sinjali i një politike monetare neutrale, ashtu siç po ndodh aktualisht që prej pranverës së fundit.
[5] Fillimisht, ankandet e repove konsistonin në pranimin e shumave të shpallura që më parë kundrejt një çmimi tavan, gjithashtu, të shpallur. Me anë të këtij veprimi, tregut i jepej një sinjal i qartë për të ulur më tej përqindjet e interesit.



Figura 1. Korniza aktuale e politikes monetare

Pas përshkrimit që i bëmë rrugës që ndjek Banka e Shqipërisë për kontrollin e inflacionit, mendoj se dikush prej jush mund ngrejë pyetjen: po pse kaq shumë kujdes për këtë të ashtuquajtur inflacion? Çfarë është dhe pse duhet të shqetësohemi kaq shumë prej tij? Bie fjala se si do ta masim dhe kujt duhet t'ia "faturojmë" atë. Si shpjegohet që ekonomi me të njëjtat përmasa - ajo amerikane dhe ajo ruse, për shembull - kanë shkallë të ndryshme imunizimi ndaj inflacionit? Pse thuhet që në ekonomitë e brishta shpeshherë inflacioni është pjesë e "mëkateve" të politikanëve?

Nuk është nevoja të jesh një studjues i teorisë ekonomike për të kuptuar se çfarë është inflacioni dhe për më tepër çfarë është i aftë të shkaktojë. Po kështu, është e vërtetë se edhe shkaqet që e prodhojnë atë njihen përgjithësisht. Realisht, ajo çka kuptohet rëndom ka të bëjë me faktin se ku ka shumë para ka rritje çmimesh, se ku të mirat materiale dhe shërbimet e ofruara janë të pakta, përsëri do të ballafaqohemi me rritje çmimesh rritje, e cila në fund të fundit, për të dyja rastet e cituara do të thotë që ka inflacion.

Inflacioni, nga një këndvështrim i përgjithshëm, është thjesht një "superprodhim" i parasë, i cili në njërën anë në mënyrë të dukshme rrit çmimet e mallrave dhe në anën tjetër ul fuqinë blerëse të parasë. Megjithatë, për ta popullarizuar do të thonim se inflacioni ndodh atëhere kur niveli i përgjithshëm i çmimeve dhe i kostove në ekonomi rritet, domethënë kur rritet çmimi i bukës, i naftës, i veturave etj., ose kur rritet niveli i pagave, çmimi i tokës etj.. Është normale që rritja e çmimeve të mos jetë në të njëjtin nivel në të gjithë mallrat e përmendur më sipër dhe po ashtu dhe koha në të cilën evidentohet rritje çmimesh të mos jetë e njëjtë për dy mallra të ndryshëm. Në këtë kuptim, me periudha inflacioniste do të përkufizojmë ato periudha kohe kur niveli i çmimeve të konsumit - i matur nga ndryshimi i një indeksi të çmimeve të konsumit - rritet në përgjithësi. Kështu, sa herë që në gazeta apo në media në përgjithësi, njoftohet se "inflacioni ka rënë" apo "pritjet inflacioniste në ekonomi janë rritur", shkruesit kanë pasur parasysh lëvizjet në një indeks çmimesh, i cili në pjesën më të madhe të vendeve është identifikuar si indeksi i çmimeve të konsumit ose shkurt IÇK (në anglisht CPI - consumer price index).

IÇK nuk është gjë tjetër veçse një matje e çmimeve të një shporte mallrash konsumi dhe shërbimesh. Zakonisht në grupet më të mëdha që përfshihen në një shportë të IÇK-së janë artikujt ushqimorë, veshjet, blerja dhe mirëmbajtja e shtëpive, karburantet, transporti dhe kujdesi mjeksor. Deri në këtë moment,

duket se gjërat janë të thjeshta, por problemi fillon të vështirësohet kur cakton peshën që secili nga këto grupe do të zërë ndaj totalit. E thënë më qartë, duhet vendosur se sa do të rritet niveli i përgjithshëm i çmimeve në qoftë se çmimet e grupit ushqimor do të rriten me 10 për qind. Në praktikë, përcaktimi i peshave bazohet në rëndësinë ekonomike që ka çdo grup, rëndësi e cila matet nga ajo pjesë e shpenzimeve - ndaj totalit - që konsumatorët harxhojnë për atë grup të caktuar mallrash. Më konkretisht, në qoftë se konsumatorët vetëm 15 për qind të buxhetit të tyre e dedikojnë për shpenzime të veshmbathjes, atëhere pesha që ky grup do të zërë në shportë do të jetë 15 për qind.

Siç vihet re, janë konsumatorët që me mënyrën se si shpenzojnë përcaktojnë dhe "fytyrën" e inflacionit. Është për këtë arsye, që indekset e ndërtuara në vende të ndryshme kanë pika të përbashkëta, të cilat më së shumti kanë të bëjnë me praninë e të njëjtave grupe mallrash si dhe me përafrinë e peshave që këto grupe zënë ndaj totalit. Këto ngjashmëri, janë më të dukshme kur krahasohen ekonomi me struktura dhe me shkallë zhvillimi të ngjashme, si për shembull kur krahasohet ekonomia franceze me atë gjermane.

Sa lloje inflacioni do të mund të indentifikonim? Në realitetin e përditshëm na bie rasti të dëgjojmë dhe njoftime të lidhura me tregues të ekonomisë, ku pa dyshim bën pjesë dhe inflacioni. Ajo që duhet të na bëjë përshtypje në shikim të parë është shifra e publikuar; është e lartë apo e ulët; është në nivel vjetor apo mujor etj.. Është një e vërtetë e madhe që ka shoqëruar dhe do të shoqëroje zhvillimin e historisë njerëzore: çmimet e mallrave dhe të konsumit tentojnë gjithnjë të rriten dhe çështja qëndron në faktin se sa do të jetë kjo rritje dhe për më tepër sa i aftë do të jesh për të mbajtur rritjen e çmimeve të konsumit në hapin që ti dëshiron. Si shprehje e koncentruar të gjithë kësaj do të ishte mirë të përmendej thënia e Jimmy Ë. Marsh: "inflacioni mund të ndalet siç pretendojnë ekonomistët, por sa herë që ne shkojmë për të psonisur, duket se ai është liruar para kohe me kusht".

Në praktikë, ashtu si sëmundjet, edhe inflacioni shfaqet me nivele të ndryshme të prekjes, megjithatë, studiuesit, sidomos kur bëhet fjalë për ta dalluar atë nga ana sasiore, kanë arritur të identifikojnë katër lloje: inflacion i ulët, inflacion i moderuar, inflacion galopant dhe hiperinflacion.

Në literaturën e sotme inflacioni i ulët nënkupton një normë pozitive inflacioni që luhatet në intervalin 0 - 4 për qind në bazë vjetore. Që në momentin e parë, çdokush mund të mendojë se bëhet fjalë për një normë inflacioni që është tipike për vendet e zhvilluara.

Inflacioni i moderuar përpara një dekade nënkuptonte një inflacion njëshifror, i cili në ekstremin e sipërm të tij kishte një normë vjetore në masën 10 për qind. Aktualisht, bëhet fjalë për një normë vjetore inflacioni që luhatet në intervalin 5 - 10 për qind, dhe që më së shumti është tipik për një pjesë të ekonomive në zhvillim dhe të atyre në tranzicion. Nga një këndvështrim pak më teknik, ky lloj inflacioni është i pranishëm në ato periudha kur "terapitë" e përdorura në periudha krizash kanë filluar të japin efektin e tyre. Megjithatë, në disa raste, sidomos, kur pas periudhash relativisht të gjata të një inflacioni të ulët vihet re një përshpejtim konstant i inflacionit, duke e çuar atë një klasë më lartë, do të thonim se kanë filluar të bien këmbanat e alarmit.

Inflacioni quhet galopant atëhere kur çmimet në bazë vjetore rriten me përqindje me dy ose tre shifra. Në këtë situatë, janë ndodhur shumica e vendeve në tranzicion në fillimin e viteve '90, pas shthurjes së bllokut të madh komunist në Evropë. Në ambiente ekonomike ku çmimet dyfishohen ose trefishohen në harkun kohor të një viti, problemet janë të shumta dhe jeta e individëve, e firmave, e agjentëve ekonomikë, në përgjithësi, bëhet shumë e vështirë. Ky inflacion shoqërohet me prishje të stabilitetit makroekonomik duke çuar në rënien e prodhimit, përkeqësimin e pozicionit valutor, në shkatërrimin e kursimeve, në dollarizimin e ekonomisë, e plot fenomene të tjera negative. Ndërkohë që ekonomia edhe mund të mbijetojë nga një inflacion galopant, nuk ka dyshim se hiperinflacioni për të është një kancer i vërtet. Përveç të kaluarës së largët kur Gjermania u godit nga një hiperinflacion i egër - vitet 1922 - 24 - një periudhë të gjatë dhe të vështirë hiperinflacioni përjetuan dhe shumica e ish-Republikave të Bashkimit Sovjetik në fillimin e viteve '90.

Kujt duhet t'i kërkojmë llogari për inflacionin? Thamë që bankat qendrore në qendër të aktivitetit të tyre kanë ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. Po ashtu, sqaruam se inflacioni është "mëkat" i politikës monetare për aq kohë sa ekspansioni monetar nuk imponohet prej zbatimit të politikave fiskale të papërgjegjshme. Në këto kushte, lidhja para - inflacion është shumë e fortë dhe merr formën e një spiraleje në të cilën një element shtyn tjetrin dhe anasjelltas.

Duke u kthyer edhe një herë në botën reale, do të donim të sqaronim se jeta e bankierëve qendrorë po bëhet gjithnjë e më e vështirë. I gjithë opinoni i mban sytë tek ata; cila do të jetë lëvizja e tyre e ardhshme; nëse interesi do të rritet siç pritej nga tregjet apo jo; nëse veprimi i marrë ishte në kohën e duhur apo, nëse mesazhi do të përcillet me shpejtësinë e duhur apo jo etj.. Për të qenë më të sinqertë, presioni publik mbi ta është më i fortë në vendet e zhvilluara, por realisht jeta e tyre është më e koklavitur në vendet e pazhvilluara.

Përse kështu? Sigurisht përgjigja e kësaj pyetjeje është një e vetme, pavarësia e bankës qendrore, e cila është vërtet reale në një demokraci perëndimore dhe është gjithnjë nën kërcënim dhe shpesh edhe formalisht jo e plotë në vendet në zhvillim. Nga vrojtime të shumta ka rezultuar se bankat qendrore me shkallë të lartë pavarësie kanë arritjet më të mira në sfidën me inflacionin ashtu siç është evidentuar e kundërta në shumicën e vendeve ku shkalla e pavarësisë së bankave qendrore lë për të dëshiruar.

Sot, gjithnjë e më tepër po vërtetohet se sigurimi i stabilitetit të çmimeve është kontributi më i çmuar që një bankë qendrore mund të japë për zhvillimin ekonomik afatgjatë të vendit. Duke u nisur nga kjo, ndjekja e këtij objektivi shpesh kërcënohet nga interesa afatshkurtër siç janë rritje shumë e shpejtë ekonomike, punësim i lartë etj., të cilat sigurohen "duke falur" disa përqindje nga inflacioni ose duke toleruar një inflacion të lartë. Por, përfitimi afatshkurtër është edhe dritëshkurtër. Ai kthehet në një bumerang për ekonominë, për stabilitetin dhe për zhvillimin e saj në periudhë afatgjatë. Për këtë arsye, ky objektiv i besohet bankave qendrore, të cilat, ndryshe nga qeveritë apo nga politikanët, nuk kanë arsye të priren nga përfitimet apo nga interesat afatshkurtër.

T'i njohësh me ligj bankës qendrore të drejtën të ketë si objektiv stabilitetin e çmimeve nuk do të thotë që banka do ta realizojë atë. Banka qendrore nuk mund të bëjë asgjë pa patur pavarësi të plotë nga ekzekutivi për ta ndjekur këtë objektiv dhe me instrumentet që ajo vetë vendos për t'i përdorur për zbatimin e politikës monetare. Nëse, me ligj, bankës qendrore i njihet si objektiv qendror stabiliteti i çmimeve, por nga ana tjetër ligji parashikon që banka qendrore në çdo kohë është e detyruar të kreditojë drejtpërdrejt qeverinë me çdo lloj shume, atëherë banka qendrore nuk do të jetë në gjendje ta realizojë këtë objektiv. Në këtë mënyrë, suksesi i bankës qendrore në realizimin e detyrave të saj varet nga shkalla e pavarësisë që ajo gëzon.

Pavarësisht kësaj a duhet që një bankë qendrore të fajësohet për çdo lëvizje të çmimeve të konsumit qoftë kjo edhe shumë e dukshme. A duhet të përgjigjet Banka e Shqipërisë pse çmimet e frutave dhe të perimeve në Shqipëri pësojnë luhatje të mëdha në stinë të ndryshme të vitit? A mund të konsiderohen rrjedhoja të politikës monetare efektet negative që gjeneron kriza në vendin fqinj, ajo energjitike etj..

Jo në asnjë mënyrë jo. Bankat qendrore përgjigjen dhe japin llogari për atë pjesë të inflacionit, i cili është derivat i një komponenti të qëndrueshëm, që është gjithmonë i pranishëm, ecuria e të cilit në mënyrë të vazhdueshme udhëhiqet nga kërkesa, ndërkohë që ekzistojnë kapërcime të përkohshme në çmimet relative, zhvillime këto që më së shumti ndodhin si pasojë e ndërveprimit të ofertës. Elementi i përhershëm, zakonisht quhet inflacioni bazë ose inflacioni qendror, dhe ai gjykohet të jetë një kontribut i drejtpërdrejtë i politikës monetare. Ndërkohë, influenca e zhvillimeve në çmimet relative në përgjithësi konsiderohet si "çrregullim" i përkohshëm, i cili nga këndvështrimi i politikës monetare duhet të injorohet si përsa i takon vendimmarrjes ashtu dhe analizës së vendimeve të marra në të shkuarën.

Ekziston ideja e përgjithshme se kushdo është i aftë të shpjegojë se çfarë pësojnë xhepat tanë kur inflacioni fillon ngjitjen. Në të vërtetë, kam përshtypjen se individët e thjeshtë nuk kuptojnë vetëm një gjë, faktin që vetëm politikanët mund të dalin pa u lagur prej tij.

Po të tjerët? Katastrofë e vërtetë. Ato pak para që me mundim vihen mënjanë fluturojnë për një ditë ose në raste të rralla nuk të del dhe rroga e gjithë muajit për të blerë një bukë të vetme.

Dikush e përshkruan inflacion se ai nuk është gjë tjetër veçse tentativa juaj për të kursyer me qëllimin e vetëm për të blerë diçka, të cilën fatkeqësisht me kalimin e kohës nuk arrini ta blini kurrë.

Teoria makroekonomike servir një varg fatkeqësish të tjera "autor" i të cilave është vetëm "zoti" inflacion. Disa nga ato janë më të vështira për t'u asimiluar ndërkohë që, ajo që thamë më sipër lehtësisht dhe realisht është kuptuar dhe do të vazhdojë të kuptohet edhe në të ardhmen.

IV. PAVARËSIA E BANKËS SË SHQIPËRISË

Tashmë të gjithë e dinë se objektivi i Bankës së Shqipërisë është arritja dhe ruatja e stabilitetit të çmimeve ose e thënë më konkretisht, mbajtja e normave të ulëta pozitive të inflacionit. Politika monetare që harton dhe zbaton Banka e Shqipërisë është në funksion të këtij objektivi. Në fakt, një objektiv i tillë ndiqet nga shumë banka qendrore në botë. Pavarësia e bankës qendrore varet nga shumë faktorë. Në rastin e Shqipërisë vlerësohet se banka qendrore gëzon një pavarësi të lartë ligjore. Por, pavarësia reale e saj është mjaft e ulët. Ka një sërë faktorësh që çojnë në reduktimin e pavarësisë reale:

PAQËNDRUESHMËRIA POLITIKE.
Besohet se paqëndrueshmëria politike ka ndikim në pavarësinë e bankës qendrore. Mosrespektimi i rregullave të lojës politike dhe i kalimit të pushteteve sjell edhe ndikime të fuqishme të paqëndrueshmërisë politike në pavarësinë e bankës qendrore.

Në Shqipëri, të dyja situatat e përshkruara më sipër kanë ekzistuar dhe kanë patur ndikimet e veta në pavarësinë e Bankës së Shqipërisë. Pak a shumë, mund të thuhet që është vërejtur paqëndrueshmëri politike si pasojë e mbajtjes së katër zgjedhjeve dhe dy referendumeve për Kushtetutën në një interval kohor prej 8 vjetësh (normalisht duhet të kishim dy zgjedhje). Po kështu, në momentet kur forcat politike në pushtet kanë ndjerë se do të largoheshin prej tij nga zgjedhjet e parakohshme, temë e ditës së tyre ka qenë "respektimi i institucioneve dhe i teknokratëve", përfshi Bankën e Shqipërisë. Në tërësi, paqëndrueshmëria politike ka ndikuar në drejtim të reduktimit të pavarësisë së bankës.

ZHVILLIMI I TREGUT FINANCIAR.
Në rastin e Shqipërisë, mund të thuhet me siguri të plotë se pavarësia e bankës qendrore dëmtohet dhe nga shkalla e ulët e ndërmjetësimit financiar dhe nga mungesa e tregjeve të kapitalit. Kjo bën që në ekonominë e vendit pesha e sektorit financiar të mos jetë e konsiderueshme dhe për pasojë edhe veprimet e vendimet e bankës qendrore, të mos japin efektin maksimal të tyre. Kjo e vë në pozitë inferiore në raport me qeverinë.

BORXHI I BRENDSHËM.
Ekzistenca e një borxhi të madh të brendshëm të qeverisë, bën që klasa politike të mos jetë e interesuar për një bankë qendrore të pavarur. Në Shqipëri, ekziston një borxh i brendshëm relativisht i lartë që, gjithashtu, kufizon pavarësinë reale të bankës qendrore.

OPERACIONET NË TREGUN E HAPUR.
Një bankë qendrore ka pavarësi më të lartë nëse ajo ka hapësirat e nevojshme dhe aftësinë për të ndërhyrë në masë të mjaftueshme në tregun e hapur kur një gjë e tillë nevojitet. Por, kjo aftësi kufizohet ndjeshëm, dhe për pasojë dhe pavarësia e bankës, nëse detyrimet e qeverisë nuk janë të tregtueshme. Praktikisht, në Shqipëri, bonot e thesarit të emetuara nga qeveria (ministria e financave), u kthyen shumë shpejt në një instrument jo të tregtueshëm. Nga ana tjetër, qeveria ka kërkuar që bankat të riinvestonin portofolin që maturohej. Kjo i ballafaqoi bankat me një investim jolikuid duke i vënë shpeshherë përballë mungesës së likuiditetit. Në këto kushte, për të shmangur shfaqjen e problemeve të likuiditetit në sistemin bankar, Banka e Shqipërisë ka ndërhyrë duke ofruar repo ose duke blerë letrat me vlerë nga portofoli i bankave të nivelit të dytë. Rasti më ekstrem është ai i katër obligacioneve shtetërore të emetuara kundrejt detyrimeve të papaguara të kooperativave bujqësore. Këto obligacione, me urdhër administrativ u transferuan në një tjetër bankë shtetërore që kishte pozicion të favorshëm likuiditeti. Por, edhe kjo bankë, shumë shpejt u detyrua t'i nxjerrë këto obligacione në treg sekondar, të cilat, pas tentativave të pasuksesshme për t'i shitur, u blenë nga Banka e Shqipërisë.

FUNKSIONI I KËSHILLTARIT.
Në disa vende, detyrë zyrtare e guvernatorit është edhe funksioni i këshilltarit ekonomik të qeverisë. Ky funksion e lejon atë që t'i drejtohet periodikisht parlamentit ose kabinetit për çështje të tilla si politikat në tregjet e punës dhe ato fiskale. Në Shqipëri, Banka e Shqipërisë nuk merr pjesë aktive në hartimin apo në dhënien e këshillave për politikat jashtë fushës monetare e valutore. Megjithatë, një hap i bërë në këtë drejtim është pjesëmarrja e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë në Komitetin e Politikave Ekonomike që drejtohet nga Kryeministri.

OPOZITA E PUBLIKUT NDAJ INFLACIONIT.
Një tjetër përcaktues i rëndësishëm i pavarësisë është mbështetja e publikut për objektivin e stabilitetit të çmimeve. Besohet se nëse publiku është i prirur të kundërshtojë inflacionin, atëherë banka qendrore ka më tepër autoritet, vendimet e saj kanë më shumë shanse të kenë mbështetje të gjerë dhe për pasojë rritet shkalla e pavarësisë së saj.

A ka në Shqipëri opozitë ndaj inflacionit të lartë? Jo, as në publikun e gjerë, as në rrethet financiare. Por, sidomos negativ në këtë drejtim është mentaliteti i popullsisë, e cila e drobitur ekonomikisht, ka humbur çdo lloj ndjenje "për sakrifikimin e mirëqenies së saj" në këmbim të një zhvillimi ekonomik në të ardhmen. Mund të themi fare hapur se angazhimi i autoriteteve shqiptare në të shkuarën, por edhe sot, për të ruajtur ekuilibrat makroekonomikë dhe për të siguruar një normë të ulët inflacioni, më shumë është arritur nën nevojën për të siguruar marrëveshje me institucionet ndërkombëtare, kryesisht FMN, dhe për të përfituar financimet e nevojshme prej tyre.

PERSONALITETI DHE REPUTACIONI I DREJTUESVE TË BANKËS QENDRORE DHE QEVERISË.
Pavarësia reale e një banke qendrore është edhe produkt i politikës së përditshme, i ndërveprimeve institucionale dhe personale të drejtuesve të saj dhe të qeverisë, ose në kuadër më të ngushtë, të ministrisë së financave që ndikojnë në njërin ose tjetrin drejtim. Tradita dhe personaliteti i guvernatorit mund të ndikojnë ndjeshëm në sjelljen e bankës qendrore. Nga përvojat e punës në Bankën e Shqipërisë, është vërejtur që vërtet personaliteti i drejtuesve të këtij institucioni dhe i ministrave të financave kanë patur ndikim në sjelljen e institucioneve. Nëse Banka ka tentuar të respektojë pavarësinë e vet, kjo fare mirë mund të zbulohet po të ndiqet gjuha e përdorur në dokumentet dhe në korrespondencën e institucioneve apo në prezantimet publike të drejtuesit të institucionit. Nëse personaliteti i guvernatorit ka qenë më i fortë sesa ai i ministrit të financave (apo çdo anëtari tjetër të qeverisë) gjuha e përdorur në dokumente ka qenë më e ftohtë, e prerë dhe e qartë. Në të kundërt, është përdorur një e shkruar lakonike me shumë terma mirësjelljeje në mes.

Një tjetër faktor i vërejtur në Shqipëri, që ka ndikuar në këtë personalitet, është edhe mbështetja që kanë patur këta drejtues nga forca politike në pushtet. Nëse forca politike në pushtet ka mbështetur fuqishëm ministrin e financave është vërejtur një sjellje "më e përulur" e guvernatorit dhe anasjelltas. Tepër i rëndësishëm bëhet ky faktor (personaliteti i guvernatorit) në rastin e Shqipërisë, ku ekzekutivi, edhe pse është miratuar ligji që sanksionon pavarësinë e bankës qendrore, në mënyrë të vazhdueshme bën përpjekje apo ushtron presion për të kufizuar në praktikë këtë pavarësi.

CILËSIA E DEPARTAMENTIT TË KËRKIMEVE TË BANKËS QENDRORE.
Cilësia e Departamentit të Kërkimeve të bankës qendrore i jep mundësi bankës që të krijojë qëndrimin e vet të pavarur në raport me institucionet e tjera ekonomike të kërkimit, brenda sektorit publik dhe të rrisë peshën e saj në raport me qeverinë e sidomos me ministrinë e financave.

Në përfundim, duhet theksuar që për sa kohë ekziston me ligj detyrimi që Banka e Shqipërisë të kreditojë drejtpërdrejt Qeverinë, pavarësia e saj asnjëherë nuk do të jetë e plotë, përkundrazi do të jetë vazhdimisht nën kërcënim. Për më tepër, nisur nga objektivi strategjik që ka shpallur Banka e Shqipërisë për të pasur si model institucional Bankën Qendrore Evropiane, shumë shpejt ajo duhet të plotësojë kushtin që kanë bankat qendrore të Bashkimit Evropian: kreditim zero për qeverinë.

BANKA QENDRORE DHE INFLACIONI.

LEKSION I GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, ZOTIT SHKËLQIM CANI ME DATË 20 MARS, FAKULTETI EKONOMIK NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR XHUVANI",ELBASAN.

I. KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME PËR INFLACIONIN.

Pjesë e rëndësishme e kornizës që përkufizon situatën makroekonomike të një vendi është edhe treguesi i inflacionit, mosha e të cilit në kuptimin ekonomik është e vjetër, ndoshta që atëherë kur grekët e vjetër kërkonin të shpjegonin faktin se është sasia e parasë në qarkullim që përcakton edhe nivelin e çmimeve në ekonomi. Duke hedhur vështrimin në shekullin XX, studimet teorike mbi lidhjen e parasë me inflacionin kanë evoluar në mënyrë të vazhdueshme. Ndërkohë që në ditët e sotme treguesi i inflacionit bën pjesë në "setin" e agregatëve ekonomikë të një vendi, duke ndërthurur dy aspekte të rëndësishme:

- nga njëra anë, inflacioni është një indikator "rezultant" i veprimit të të gjithë faktorëve apo agregatëve të tjerë në ekonomi;
- nga ana tjetër, ai është përbërës që ndikon drejtpërdrejt në ecurinë e agregatëve të tjerë.

Kjo do të thotë që "makina e stërmadhe dhe e ndërlikuar" e ekonomisë së një vendi nuk mund të kuptohet pa shifrën që e karakterizon nga pikëpamja sasiore këtë agregat. Në mënyrë të figurshme do të thonim se kjo shifër, tregon midis shifrave të tjera, nëse agregati është apo jo në gjendje të mirë pune apo nëse ai po "prishet" dhe "ka pësuar difekt". Në këtë rast, makina do të përshkruajë një trajektore të vështirë, ndoshta edhe me kthime prapa, për pasojë më të gjatë. Do të ndodhë që ajo do të lodhet dhe do t'i duhet kohë për t'u rivënë në punë normale. Ndërkohë që, nëse shifrat e agregatit "inflacion" dhe të agregatëve të tjerë, do të rezultojnë brenda kornizave të pranuara për to, atëherë makina ekonomike do të ecë mbi një trajektore krejtësisht të përcaktuar.

Por çfarë është inflacioni?

Me fjalë të thjeshta inflacioni karakterizon situata ekonomike me rritje të përgjithshme të çmimeve të mallrave të konsumit dhe të shërbimeve. Ai është një fenomen që në literaturën bazë ekonomike shpjegohet me mbimbushje të kanaleve të qarkullimit me para, apo ndryshe thënë "superprodhim" dhe ulje e fuqisë blerëse e parasë. Pra, prodhohet inflacion apo rritje çmimesh kur:

disponohen sasi të mëdha parash në duart apo në xhepat e qytetarëve dhe në ekonomi në tërësi;
të mirat materiale dhe shërbimet e ofruara janë më të pakta sesa kërkesa për to.

II. MATJA E INFLACIONIT: RASTI I SHQIPËRISË.

Nëse kemi të bëjmë apo jo me një periudhë inflacioniste, këtë e evidenton një llogaritje e thjeshtë mbi indeksit të çmimeve të konsumit (IÇK). Raporti i dy indekseve për dy periudha kohore të caktuara, rezulton me një shifër, e cila mund të jetë më e madhe, e barabartë apo më e vogël sesa njësia apo 100 për qindëshi.

Nëse rezultati është mbi 100 për qind, atëherë gjendemi përballë një situate inflacioniste në ekonomi, apo kur kostot e saj janë rritur. Është e rëndësishme të theksohet se, situata inflacioniste, nuk karakterizohet nga rritja e çmimit të një apo të disa mallrave apo shërbimeve për periudhat krahasuese, sepse mund të ndodhë, dhe kjo është normale, që çmimet e disa të tjerëve të ulen. **Inflacioni evidentohet nga rritja e përgjithshme e IÇK-së.**

Për ta sqaruar këtë ide më mirë, do të ishte e përshtatshme të shtjellohej shkurtimisht kuptimi i indeksit të çmimeve të konsumit.

[1] Leksion i Guvernatorit të bankës së shqipërisë, zotit Shkëlqim Cani me datë 20 mars, Fakulteti Ekonomik në Universitetin "Aleksandër Xhuvani",Elbasan.

Ekzistojnë disa indekse çmimesh të cilat maten edhe në Shqipëri. Të tillë janë:

- Indeksi i çmimeve të prodhimit: matet dhe publikohet nga INSTAT.
- Indeksi i çmimeve të importit: matet dhe publikohet nga INSTAT.
- Indeksi i çmimeve të konsumit: matet dhe publikohet nga INSTAT.

Megjithatë, indeksi i çmimeve, më familjari për të gjithë, është IÇK-ja. Madje ai është një nga indekset më popullorë dhe më të komentuar në pjesën më të madhe të vendeve. Banka e Shqipërisë, për nevojat e veta të analizës, llogarit edhe indekse të tjera prej të cilave nxjerr matje të ndryshme të inflacionit si:

- inflacionin bazë, i llogaritur për herë të parë në vitin 1995;
- inflacionin mesatar që prej vitit 1993;
- inflacionin në fund të vitit që prej vitit 1992;
- inflacionin e sektorit të mallrave të tregtueshëm dhe të patregtueshëm, që nga marsi i vitit 2002.

Le të vijojmë me IÇK-në.

IÇK-ja është rezultat i një matjeje të tërë statistikore mbi nivelin e çmimeve të mallrave dhe shërbimeve më të nevojshme apo me të cilat popullsia është në kontakt, pothuaj, të përhershëm gjatë procesit jetësor.

Kjo do të thotë që IÇK-ja mat koston e një "shporte të fiksuar" të mallrave dhe shërbimeve për një periudhë të caktuar kohore. Ndryshimet në koston e kësaj shporte lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me ndryshimet në "koston e jetesës". Ato janë ndryshime të të njëjtit kah. Pra, nëse pranojmë që është "shtrenjtuar" kostoja e shportës, atëherë kemi pranuar se edhe "kostoja e jetesës" është shtrenjtuar, madje pothuaj në të njëjtën masë dhe e kundërta. Kështu, rritja e çmimit të bukës, të mishit, të karburanteve, të qirave apo edhe vetë niveli i pagave, çojnë në rritje të kostos së shportës dhe të jetesës.

II.1. PËRBËRJA E SHPORTËS DHE STRUKTURA E SAJ.

Më parë u cilësua se llogaritja e IÇK-së është ngritur mbi një metodologji të tërë statistikore. Metodologjia sqaron si përbërjen e shportës ashtu edhe procedurat përkatëse për matjet. Për të qenë më të qartë në shpjegimin e shkurtër që do t'i bëhet kësaj çështjeje, do të sillet shembulli i matjes së IÇK-së në Shqipëri[2].

Përbërja dhe struktura e shportës shqiptare është vlerësuar për herë të parë në vitin 1993, në bazë të së cilës filloi të matej IÇK-ja dhe për herë të dytë ajo u rivlerësua në vitin 2000. Shporta e re e konsumit në Shqipëri u vlerësua në bazë të anketës "Mbi buxhetin e familjeve shqiptare", në të cilën u vrojtuan në mënyrë të rregullt rreth 4351 familje shqiptare, pranë të cilave u mor informacion mbi konsumin apo blerjet, që ato kryenin gjatë periudhave të caktuara të vitit. Përpunimi i informacionit, nxori në pah llojet e mallrave dhe shërbimeve që familjet shqiptare konsumonin (blinin) mesatarisht më shpesh, si edhe strukturën mesatare të shpenzimeve për secilin mall apo shërbim. Kështu, anketa dha informacion për profilin mesatar të konsumit në përbërje dhe në strukturë për një familje mesatare shqiptare.

Anketa e dytë pranë familjeve dëshmoi për ndryshime strukturore të shportës së matjes së IÇK-së, krahasuar me atë të vitit 1993, ndryshime të pritshme, të rrjedhura nga periudha disavjeçare e një tranzicioni ekonomik, politik dhe social të Shqipërisë dhe të shqiptarëve. Për pasojë, këto ndryshime u pasqyruan në IÇK dhe në treguesin e inflacionit. Ajo evidentoi si grupe të rëndësishme që duhej të bënin pjesë në shportën shqiptare të IÇK-së, artikujt ushqimorë, veshjet, artikujt e pajisjes dhe të mirëmbajtjes së shtëpive, karburantet, transportin, kujdesin mjeksor, edukimin arsimor, argëtimin etj.. Në përgjithësi, këto janë grupe që ndeshen edhe në shportat e IÇK-ve të vendeve të tjera, pavarësisht peshës së ndryshme që ato zënë. Ngjashmëritë dalin më në pah kur krahasohen vende me ekonomi dhe shkallë zhvillimi të ngjashme, si për shembull kur krahasohen ekonomitë e Bashkimit Evropian.

[2] Matja e IÇK-së në Shqipëri, ka ndjekur hapat metodologjikë që zbatohen në vendet e Bashkimit Europian si edhe të pjesës më të madhe të vendeve të tjera të zhvilluara.

Box 1: Shporta e shqiptare e matjes së IÇK-së.

Numri i artikujve në shportën e re ka arritur në 262 ose 41 artikuj më shumë se ajo e vitit 1993. Në këtë mënyrë, inflacioni "I ri" pasqyron edhe informacionin e çmimeve të 41 artikujve të shtuar (një ndër artikujt kryesorë të rinj është renta e imputuar apo një shpenzim në potencë për qira banimi).

Shporta e re i grupon artikujt në 12 grupmallra nga 8 që kishte shporta e vjetër. Rritja e numrit të grupmallrave është realizuar kryesisht duke ndarë grupmallrat e vjetër nisur nga fakti që artikuj të caktuar në grupmallrat e vjetër kishin fituar një peshë të konsiderueshme në strukturën e shpenzimeve të shqiptarëve (për shembull, grupi "ushqim, pije, duhan" është ndarë në dy: "ushqim dhe pije joalkolike" dhe "duhan dhe pije alkolike"; grupi "argëtim, arsim, kulturë" është ndarë në dy nëngrupe "argëtim, kulturë" dhe "arsim").

Shporta e re ndërtohet mbi bazën e informacionit të marrë sipas një ndarjeje territoriale, që respekton ndarjen e prefekturave. Rrethi i Tiranes ka një peshë më të madhe. Vrojtimi i vitit 1993 u realizua vetëm në qytetin e Tiranës dhe modeli i shpenzimeve, i vërtetuar nga ky vrojtim, u zbatua për të gjithë territorin e Republikës. Me shportën e re është e kundërta. Vrojtimi është kryer në të gjithë territorin e Republikës. Baza për llogaritjen e indeksit të çmimeve të konsumit është muaji dhjetor 2001 (indeksi=100). Për periudhën para këtij muaji është bërë rishikimi i informacionit me qëllim që të sigurohet krahasueshmëria e të dhënave.

*Në tërësi, **INSTAT konkludon që inflacioni, i matur me shportën e re, është më realist. Me matjen e re grupi ushqimor është reduktuar në mënyrë të konsiderueshme dhe kjo ka "zbutur apo lëmuar" luhatjet sezonale, fakt që ndihmon në parashikimin e tij.***

Tabelë 1: Përbërjet e dhe struktura e shportave.

Shporta e vjetër (1993)		Shporta e re (2000)	
Totali	1.0000	Totali	1.0000
1. Ushqim, pije dhe duhan	0.7239	1. Ushqime dhe pije joalkolike	0.4263
2. Veshje dhe këpucë	0.0282	2. Pije alkolike dhe duhan	0.0311
3. Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	0.0641	3. Veshje dhe këpucë	0.0379
4. Mobilim, pajisje dhe mirëmbajtje shtëpie	0.0827	4. Qera, ujë, lëndë djegëse dhe energji	0.2436
5. Kujdes mjekësor	0.0092	5. Mobilim, pajisje dhe mirëmbajtje shtëpie	0.0455
6. Transport	0.0516	6. Kujdes mjekësor	0.0212
7. Argëtim, arsim dhe kulturë	0.0357	7. Transport	0.0483
8. Kujdes personal	0.0046	8. Komunikim	0.0132
		9. Argëtim dhe kulturë	0.0262
		10.Shërbim arsimor	0.0098
		11. Hotele, kafene dhe restorante	0.0728
		12. Mallra dhe shërbime të ndryshme	0.0241

Burimi: INSTAT, shkurt 2002.

IÇK-ja është forma klasike e një indeksi agregat të formës së Laspayer-it.

$IÇK_t = (Sp_{it} * q_i / Sp_{i(t-1)} * q_i) * 100$, ku:

p_{it} dhe $p_{i(t-1)}$ janë çmimet e mallit apo të shërbimit "i", përkatësisht në momentin t dhe t-1 të kohës ndërsa q_i është pjesa e shpenzimeve për artikullin "i" ndaj totalit të shpenzimeve apo të konsumit familjar. Ndryshimi i IÇK-së mund të jetë:

- me bazë mujore: në këtë rast kemi norma mujore të inflacionit;
- me bazë vjetore: në këtë rast kemi të bëjmë me normat vjetore të inflacionit.

Siç shihet IÇK-ja pasqyron ndryshimin e vlerës së mallrave dhe shërbimeve në çdo periudhë (muaj) kundrejt periudhës bazë (dhjetor 2001), vetëm si rezultat i ndryshimit të çmimeve, pra kur sasitë e blera apo të konsumuara, mbeten të pandryshuara. Anketa e buxhetit pranë

familjeve, praktikisht, zgjidh problemin e peshave apo të rëndësisë ekonomike që ka çdo artikull apo çdo grup. Thënë ndryshe, është raporti i shpenzimeve të çdo grupi ndaj totalit të shpenzimeve apo të buxhetit të secilës familje.

Shembull:
Sa do të rritet IÇK-ja, nëse çmimet e grupit "ushqime dhe pije joalkolike" janë rritur në muajin (t) në krahasim me muajin (t-1) me 18 për qind, kur dihet që ky grup në shportën e IÇK-së, zë rreth 43 për qind? Nëse gjithë çmimet e tjera do të ishin të pandryshuara, efekti i rritjes së këtij grupi në nivelin e përgjithshëm të çmimeve, do të ishte: (0.18 * 0.43)*100 = 7.74 për qind. Nëse ky grup do të zinte një peshë më të ulët, atëherë ndikimi i rritjes së çmimeve të këtij grupi në nivelin e përgjithshëm të çmimeve do të ishte më i dobët.

Shembulli më sipër jo vetëm që ilustron atë që është shpjeguar më parë për shportën e IÇK-së në përgjithësi dhe atë shqiptare, në veçanti, por nga ana tjetër, sqaron faktin se struktura e shportës përcaktohet nga mënyra me të cilën familjet shqiptare shpenzojnë buxhetin e tyre. Në fund të fundit, sqarohet ideja se është kjo strukturë, e përcaktuar nga konsumatorët, që thekson, dobëson apo mban të pandryshuara nuancat inflacioniste në ekonomi. Kështu, IÇK-ja, mishëron në vetvete profilin e konsumit në familjet mesatare të një vendi, pra edhe në Shqipëri.

III. NATYRA E INFLACIONIT DHE SHKAKTARËT E TIJ KRYESORË: RASTE STUDIMI

III.1. NATYRA E INFLACIONIT

Qëkurse cilësuam se inflacioni është shprehje e "superprodhimit" të parasë, identifikojmë njërin prej faktorëve që e stimulojnë atë. Irving Fischer (1922 – teoria sasiore) konkludoi se ndryshimet në sasinë e parasë shkaktonin ndryshime në nivelin e çmimeve, teori e cila u mbështet dhe u zhvillua më tej nga monetaristë të tjerë. Milton Friedman argumentoi se inflacioni fillon të përshpejtohet sa herë që përshpejtohet dhe rritja e ofertës së parasë. Në këtë këndvështrim ai arriti në konkluzionin se "inflacioni gjithnjë dhe kurdoqoftë është një fenomen monetar".

Ndërkohë Kejnsi (1959 – Radcliffe Report) i atribuon parasë një rol pak më të zbehtë, duke vënë theksin dhe në faktorë të tjerë si politika fiskale, tronditjet në ofertën agregate etj.. Megjithatë, edhe ai, në fund të fundit shpjegon se inflacioni i lartë vjen ose krijohet nga rritja e madhe e ofertës së parasë, dhe se faktorët e tjerë janë kryesisht faktorë të cilët mund ta ndikojnë inflacionin vetëm përkohësisht.

Analizat empirike tregojnë se ekziston një lidhje shumë e fortë midis rritjes së parasë dhe inflacionit. Periudhat historike që përkojnë me këto lidhje janë karakterizuar nga situata të qarta "hiperinflacioniste".

Problemi që duam të sqarojmë nuk lidhet thjesht me periudhat e inflacionit "galopant", kur dukshëm ai paraqitet si një femomen monetar. Shpesh, ekonomitë e vendeve të ndryshme, dhe për më tepër ekonomitë që kalojnë në periudha tranzicioni, siç është edhe rasti i Shqipërisë, ndeshen me lëkundje të inflacionit edhe kur ai është i formës së moderuar. Në të tilla raste, këto lëkundje apo edhe tronditje shpjegohen me praninë e faktorëve të tjerë në ekonomi, që veprojnë në mënyrë të përkohshme.

SHEMBULL:
Viti 2001 dhe gjysma e parë e vitit 2002, janë karakterizuar nga norma të larta të inflacionit. Si një ndër faktorët që ka ndikuar në kahun rritës të tij, Banka e Shqipërisë ka evidentuar "krizën energjitike". Fillimisht, ajo e trajtoi si një faktor të përkohshëm në rritjen e nivelit të çmimeve të mallrave të konsumit. Më pas, kur mungesat e energjisë u kthyen në një refren të vazhdueshëm të jetës së shqiptarëve, ajo thelloi analizën e këtij faktori duke e cilësuar, si faktor që po ndikonte në mënyrë të përhershme mbi inflacionin. Pikërisht, transformimi gradual i faktorëve me ndikim "të përkohshëm" në faktorë me ndikim "të përhershëm", është procesi që duhet të na shqetësojë të gjithëve.

Përse të gjithëve?

Le të vijojmë me shembullin me të dhëna hipotetike:

Nëse për një periudhë dymbëdhjetëmujore, ekonomia çdo muaj do të prodhonte një inflacion mujor në nivelin 1 për qind, për shkak të mungesave të vazhdueshme të energjisë

elektrike, atëherë për gjithë periudhën rritja e inflacionit – inflacioni vjetor – do të rezultonte 12 për qind, për shkak të këtij faktori: një nivel i lartë inflacioni për ekonomistët, për bankierët qendrorë, për qeverinë dhe në fund të fundit për vetë individët, të cilëve do t'u duhet të paguajnë më shtrenjtë, sepse fuqia e tyre paguese bie. Kjo do të thotë që një vit më vonë ekonomia paguan 12 për qind më shtrenjtë për shkakun e mësipërm. Në këtë kuptim, faktori është kthyer me veprim pothuaj të përhershëm, sepse ai prodhon një rritje të vijueshme dhe të qëndrueshme të nivelit të përgjithshëm të çmimeve dhe në këtë pikë ai konsiderohet si një fenomen monetar, ashtu siç edhe ka konkluduar Friedman për natyrën e tij.

III. 2. SHKAKTARËT E TIJ KRYESORË: RASTE STUDIMI.

Inflacioni mund të jetë kombinim i faktorëve nga krahu i kërkesës, i ofertës apo edhe i faktorëve të tjerë specifikë, që në periudha të caktuara kohore marrin rëndësi më të madhe në raport me të tjerët.

Inflacioni mund të shkaktohet nga "faktorë të krahut të kërkesës".

Çmimet rriten si pasojë e kërkesës më të lartë. Kjo do të thotë që kur shpenzimet e konsumatorëve, të bizneseve apo të qeverisë tejkalojnë ofertën e mallrave dhe të shërbimeve të disponueshme, ato ushtrojnë presion në rritje mbi çmimet. Zakonisht, kur ka një rritje të shpejtë të ofertës së parasë kërkesa rritet më shpejt se oferta e mallrave. Prandaj, themi që shumë para në qarkullim ushtrojnë presion për inflacion.

Rast studimi:

Një situatë e ngjashme ndodhi në vitin 2002 kur, si pasojë e panikut që zuri depozituesit u tërhoqën depozitat nga sistemi bankar. Kjo rriti sasinë e parasë në qarkullim dhe mbi agregatin monetar, M1, duke ushtruar presion për rritje inflacioni. Ky fenomen ishte një nga shkaqet që çoi në rritje të inflacionit në gjysmën e parë të vitit.

Inflacioni mund të shkaktohet nga "faktorë të krahut të ofertës".

Çmimet në këtë rast rriten nga prodhuesit të cilët rritjen e kostos së prodhimit e kompensojnë me rritje të çmimeve të prodhimit duke e transferuar koston e shtuar te konsumatorët.

Rast studimi:

Mungesat e energjisë elektrike, në pjesën më të madhe të bizneseve të sektorit të shërbimeve janë zëvendësuar me një alternativë tjetër, atë të prodhimit të energjisë me anë të gjeneratorëve. Blerja e gjeneratorëve dhe përdorimi i karburantit, është një kosto shtesë për bizneset që pasqyrohet në mënyrë të pashmangshme në çmime më të rritura të shërbimeve.

Inflacioni mund të shkaktohet nga faktori "mungesë apo boshllëk në treg".

Në këtë rast çmimet rriten si pasojë e ofertës më të ulët të mallrave apo shërbimeve, ndërkohë që kërkesa për to, të paktën, nuk ka ndryshuar.

Rast studimi 1:

Në vitin 1970 inflacioni në SHBA u përkeqësua edhe si pasojë e kontrollit të OPEK-ut mbi ofertën e naftës në botë, gjë që shkaktoi rritje prej pesë herë të çmimit të naftës.

Rast studimi 2:

I njëjti fenomen kërcënon edhe tani në prag të konfliktit në Irak. Konferenca e vendeve islamike diskutoi mbi mundësinë e reduktimit të shitjeve apo të prodhimit të naftës duke reduktuar ofertën e këtij malli dhe për pasojë duke rritur çmimin e tij. Ky faktor drejtpërdrejt ndikon edhe në inflacionin në vendin tonë. Mjafton të përmendim faktin që çmimet e transportit në muajin janar 2003 u rritën si pasojë e rritjes së çmimit të naftës në tregjet botërore.

Inflacioni i administruar.

Në këtë rast inflacioni shkaktohet prej shoqërive, të cilat duke përfituar nga fakti që veprojnë në tregje jokonkurruese janë në gjendje të rrisin çmimet me lehtësi. Ose në rastet e ekonomive me çmime që përcaktohen apo kontrollohen nga qeveria, çdo ndryshim i një çmimi të tillë ndikon në inflacion.

Rast studimi:

Rritja e çmimit të energjisë elektrike në muajin dhjetor 2001 shkaktoi rritje të inflacionit të këtij muaji me 1 pikë përqindjeje. Kjo nuk ishte rritje njëherëshe, pra të themi një faktor që vepron vetëm një herë, por ai të paktën veproi dy herë: fillimisht ai rriti çmimin e energjisë dhe të grupit

ku ajo bën pjesë (hera e parë) dhe më pas, me anë të efektit zinxhir, rritja pasohet në sektorët ku energjia përdoret si për shembull, në sektorin e shërbimeve (është vlerësuar që efekti zinxhir vijoi të paktën gjatë gjithë pesëmujorit të parë të vitit 2002).

Inflacioni i shkaktuar nga pritshmëritë.
Në përgjithësi, agjentët ekonomikë veprojnë duke parashikuar edhe ata vetë inflacionin. Nëse pritjet e tyre janë për rritje të çmimeve të mallrave të ndryshëm, kjo tendencë nxit në mënyrë të tepruar blerje të këtyre mallrave, qoftë edhe në mënyrë të panevojshme nga ana e konsumatorëve, duke i paraprirë rritjes së çmimeve të tyre. Rritja e kërkesës ka shumë mundësi të shkaktojë edhe mungesa të paparashikuara në treg, fakt që përsëri çon në rritje të çmimeve, pra në inflacion.

Inflacioni që rezulton nga deficitet qeveritare.
Deficitet qeveritare të mëdha mund të shkaktojnë inflacion. Deficitet financohen për shembull, nga kursimet e individëve që blejnë bono thesari të qeverisë. Këto kursime shndërrohen në shpenzime. Deficitet mund të financohen me kredi të drejtpërdrejtë nga bankat qendrore. Nëse këto deficite financohen me krijim paraje, atëherë kemi efekte dramatike mbi çmimet. Për këtë arsye mjaft banka qendrore, sidomos në Bashkimin Evropian, janë të ndaluara të financojnë drejtpërdrejt deficitet qeveritare dhe ky ndalim është i shprehur në ligj.

Rast studimi: Financimi i deficitit buxhetor në Shqipëri.
Duke parë dokumentet statistikore të Bankës së Shqipërisë bie në sy, se një përdorues i fuqishëm i kredisë së sistemit bankar është dhe qeveria ose siç njihet ndryshe, buxheti. Për aq kohë sa kjo e fundit është e aftë të mbulojë vetëm pjesërisht shpenzimet buxhetore, ajo do të drejtohet në tregjet ku ofrohen para borxh. Ndryshe nga shumë vende të tjera, në Shqipëri, qeveria mund të huazojë në mënyrë të drejtpërdrejtë nga banka qendrore, domethënë e financon deficitin buxhetor me prerje të re të parasë duke rritur në këtë mënyrë presionet inflacioniste në ekonomi. Për këtë arsye, edhe për Bankën e Shqipërisë ligji ka parashikuar kufizim sasior mbi sasinë e financimit për qeverinë. Rasti i Shqipërisë e vërteton më së miri. Banka e Shqipërisë në analizat e veta është shprehur mbi efektin që patën në rritje të presionit për inflacion, shpenzimet qeveritare dhe përqendrimi i tyre në periudha të caktuara gjatë vitit 2001. Duke patur parasysh këtë, në vitin 2002, për të përballuar situatën e krijuar nga tërheqja e depozitave, Banka e Shqipërisë kërkoi nga qeveria dhe gjeti mirëkuptim për këto kërkesa, që të reduktojë shpenzimet buxhetore me qëllim që të mbahej nën kontroll inflacioni.

Inflacioni dhe kursi i këmbimit.
Këtu ka një lidhje të drejtpërdrejtë dhe më të qartë. Kështu, nëse monedha e vendit nënçmohet, ushtrohet presion për rritje të inflacionit pasi mallrat e importuar bëhen më të shtrenjtë. Nëse ndodh e kundërta, ushtrohet presion për reduktim çmimesh, pra ulje inflacioni. Por, nëse nënçmohet leku me 1 për qind nuk kemi automatikisht rritje të çmimeve me 1 për qind. Kjo, sepse përveç mallrave të importuar ka edhe prodhim vendi. Përveç kësaj, kjo varet nga fakti se sa konkurrentë janë tregjet, nga lloji i produktit, nëse ato mund të zëvendësohen me produkte të tjera apo jo etj..

Rast studim: Kursi i këmbimit dhe inflacioni në Shqipëri.
Në vendin tonë, si rregull, ka reduktim të çmimeve, pra edhe të inflacionit gjatë sezonit të verës. Në këtë periudhë leku mbiçmohet pasi janë të përqendruara dërgesat në valutë të emigrantëve. Po kështu, në këtë periudhë shfaqet në treg prodhimi vendas, i cili konkurron produktet e importuara. E kundërta ndodh në periudha të tjera të vitit, kur nënçmimi i lekut shoqërohet me rritje të çmimeve. Në ekonominë shqiptare, kursi i këmbimit ka një efekt të konsiderueshëm në inflacion. Por, ky efekt është edhe më i ndjeshëm pasi vendi ynë ende importon sasi të koniderueshme mallrash konsumi dhe importet janë disa herë më të larta se eksportet, duke patur më pak konkurrencë nga prodhimi vendas. Në vitin 2002, inflacionet më të larta në gjysmën e parë ishin pasojë edhe e nënçmimit më të fortë të lekut kundrejt valutave të tjera, ndërkohë që në gjashtëmujorin e dytë, ecuria e monedhës së vendit u normalizua duke mos ushtruar presione për rritje të inflacionit. Është verifikuar se për një mbiçmim të dollarit amerikan ndaj lekut me afro 9 për qind në nivel vjetor, ndikimi në inflacion pasqyrohet me tejkalim të kufirit të sipërm të

objektivit, pra ai shkon mbi 4 për qind. Ky përkon me momentin kur kursi i këmbimit "kap" pikën, le ta quajmë "kritike" të tij në krahun e mbiçmimit, me afër 152.5 lekë për usd.

Nga disa konkluzione të analizave empirike del në pah:

- një mbiçmim i dollarit amerikan ndaj monedhës vendase me 1 lek në muajin paraardhës, rrit mesatarisht inflacionin e muajit në vijim me 0.06 pikë përqindjeje. Megjithatë, në analizat parashikuese Banka e Shqipërisë merr në konsideratë ndikimin e NEER;
- se midis fenomenit të mbiçmimit të monedhës vendase dhe inflacionit lidhja inflacion - kurs këmbimi është statistikisht e parëndësishme, ndërkohë që, në periudhat e nënçmimit të saj ndodh e kundërta, kjo lidhje është plotësisht e rëndësishme, për nivele të larta besueshmërie. Në fakt, rastet e periudhave të mbiçmimeve të forta të monedhës vendase duhet të gjenerojnë ulje të inflacionit dhe kjo lidhje normalisht duhet të rezultonte e rëndësishme, gjë që të dhënat tona nuk e verifikojnë. Ky fakt konfirmon natyrën e tregut tonë, i cili nuk është një rregullator i çmimeve në kahun zbritës, pra ku elementi spekulativ është mjaft i fuqishëm.

Faktorët specifikë.
Në ecurinë e inflacionit ndikojnë edhe faktorë të tillë që janë janë krejtësisht të paparashikueshëm dhe që mund të shfaqen në periudha të ndryshme të vitit. Megjithatë, për kohën kur veprojnë, ata ushtrojnë një presion të caktuar. Fatkeqësitë natyrore janë shprehja më konkrete e këtij grupi faktorësh. Zakonisht ngjarje të tilla shoqërohen me mungesa në treg për produkte të nevojave imediate jetësore, për pasojë edhe me rritje çmimesh. Rriten kostot e transportit që, gjithashtu, përkthehen në rritje çmimesh, gjallërohet elementi spekulativ etj..

Raste studimi:

- rasti i motit tejet të ftohtë që përfshiu Evropën dhe Shqipërinë në periudhën dhjetor 2001 –shkurt 2002;
- rasti i përmbytjeve të periudhës gusht-shtator 2002.

Në këtë grupin e faktorëve specifikë, ata "spekulativë", në periudha të caktuara të vitit, janë shumë të dukshëm dhe për më tepër, me një peshë të konsiderueshme për shtimin e presioneve inflacioniste. Ata deformojnë tregun dhe çmimet, në kahun rritës.

Rast studimi:
"Spekulimi me çmimet në prag të festës së Vitit të Ri". Këtë fenomen Banka e Shqipërisë e bëri objekt të një fushate të saj gjatë vitit 2002. Nga monitorimi i çmimeve në disa tregje për disa mallra u konfirmua që vërtet ka një rritje çmimesh të pajustifikuar në prag të festave. Fushata synonte të sensibilizonte konsumatorët dhe bizneset si dhe autoritetet qeveritare që mund të veprojnë në bazë të legjislacionit në fuqi. Në përfundim mund të thuhet se fushata pati efektet e veta në zbutje të këtij fenomeni.

Ndërkohë që fushata e vitit 2003 mendohet:

- të jetë e shtrirë përgjatë gjithë vitit, duke u theksuar në momentet e festave;
- të ketë një bashkëpunim më të ngushtë me autoritetet tatimore dhe doganore;
- të ketë një jehonë më të gjerë tek publiku me anë të kontakteve më intensive me median

IV. BANKAT QENDRORE, POLITIKA MONETARE DHE INFLACIONI.

IV. 1. BANKA QENDRORE DHE POLITIKA MONETARE.

Meqenëse deri në këtë moment shpjeguam inflacionin si fenomen kryesisht monetar, duket sikur janë bankat qendrore ato që e shkaktojnë ose jo atë, për faktin se ato janë i vetmi autoritet që sot për sot emeton para. Megjithatë, problemi i bankave qendrore në lidhje me inflacionin nuk lidhet vetëm me këtë fakt real, por me një arsye më të rëndësishme: bankat qendrore janë institucione politikëbërëse dhe njëkohësisht besimi. Me politikën që hartojnë dhe me besueshmërinë që përçon kjo e fundit në publik,

ato gjithnjë e më shumë po konsiderohen përgjegjëse për kontrollin e inflacionit. Në dekadën e fundit është shtuar në mënyrë të vazhdueshme numri i bankave qendrore që kanë në objektivat e tyre ruajten e stabilitetit të çmimeve të konsumit. Në këtë mënyrë, edhe shkalla e ndërgjegjësimit të bankierëve qendrorë dhe përgjegjshmëria e institucionit të tyre përballë publikut janë rritur ndjeshëm. Teoritë moderne ekonomike dhe përvoja, po tregojnë gjithnjë e më shumë se ingranazhi i stabilitetit të çmimeve është pika më e ndjeshme dhe më delikate e "makinës ekonomike" të një vendi, duke luajtur rol orientues në rritjen ekonomike, në mbulimin e deficiteve buxhetore, në shkallën e punësimit, dhe në besimin e biznesit dhe të konsumatorëve.

Por a mundet që një bankë qendrore të hartojë politika, që në qendër të vëmendjes së tyre të kenë ruajtjen e stabilitetit të çmimeve? Teorikisht mundet, ndërsa në praktikë problemi është shumë më i ndërlikuar. Aktualisht, kontrolli mbi inflacionin sa vjen e bëhet një proces gjithnjë e më i vështirë. Sot inflacioni nuk është thjesht një fenomen, që ka të bëjë me faktin nëse oferta e parasë është rritur apo jo. Ekzistojnë shumë goditje rastësore, të cilat nga pamundësia për t'u parashikuar kthehen në fenomene, që tentojnë prishjen e ekulibrave të vendosur në ekonomi. Po kështu, suksesi në vendosjen e kontrollit mbi inflacionin, në masë të madhe, varet dhe nga konsolidimi fiskal, i cili në ekonomitë në tranzicion dhe në ato në zhvillim akoma përbën një sfidë të madhe për autoritetet. Nuk duhet harruar se "ekonomi e hapur" do të thotë shkëmbim i lirë mallrash, shërbimesh dhe kapitali, që, në një mënyrë ose në një tjetër, do të thotë importim i një sasie të caktuar inflacioni. Për më tepër në ditët e sotme, globalizimi i tregjeve financiare përveç eleminimit të ndarjeve gjeografike po thith gjithnjë e më shumë kapitale dhe, nga ana tjetër, po e bën gjithnjë e më të vështirë punën e bankave qendrore. Ndërvarësia e madhe midis tregjeve ka bërë që dhe efekti kontaminues të jetë i madh në formën e "efektit domino", gjë që i ka detyruar fuqitë më të mëdha ekonomike t'i kushtojnë shumë kohë përforcimit të rregullave dhe mbikëqyrjes së tyre. Evidencë e qartë e kësaj të fundit janë krizat e ndodhura në rajonin e Azisë dhe në Rusi.

Ndodh që politikat monetare janë hartuar në mënyrë të efektshme, por nuk janë të pakta rastet që ato paraqesin efektshmëri jo të plotë dhe kjo mund të jetë rrjedhojë e dy faktorëve kryesorë:

- **marrjes gabim të vendimeve;**
- **mungesës së një instrumenti monetar efektiv.**

Politika monetare në vetvete është tërësia e veprimeve të bankës qendrore, të ndërmarra për të arritur objektivat e politikës monetare. Në shumicën e vendeve të zhvilluara, instrumenti më i rëndësishëm i politikës monetare është përqindja afatshkurtër e interesit, e vendosur nga banka qendrore, për të influencuar faktorët financiarë, të cilët, nga ana e tyre, ndikojnë kërkesën agregate. Në vende të tjera, veçanërisht aty ku tregjet financiare nuk janë të zhvilluara, ndikimi i bankës qendrore arrihet nëpërmjet rezervave të detyrueshme dhe kontrollit administrativ mbi përqindjet e interesit të ofruara nga bankat tregtare dhe mbi akordimin e kredisë.

Megjithatë, ajo që qëndron në parim është aftësia e bankës qendrore për të kontrolluar ofertën e parasë. Me anë të instrumenteve që ka në dispozicion, ajo mund të tërheqë apo të injektojë para në ekonomi në përputhje me kërkesat që mund të ketë ekonomia. Në një ekonomi tregu kjo gjë realizohet thjesht, mjafton të kujtojmë aftësinë tjetër të bankës qendrore për manipuluar çmimin e parasë – përqindjen e interesit. Duke rritur përqindjen e interesit, politika monetare synon të shtrenjtojë çmimin e kredisë, për rrjedhim do ta bëjë atë më pak të kërkuar, kështu që paraja do të rrijë në arkat e bankës qendrore. Veprimi i anasjelltë nënkupton një vendim të bankës qendrore për të rritur sasinë e parasë që do t'i injektohet ekonomisë, e për pasojë dhe pritjet inflacioniste duhet të shtohen në ekonomi.

Siç pamë më sipër kontrolli mbi çmimin e kredisë – përderisa ajo përbën kanalin kryesor për rrjedhjen e parasë në ekonomi – merr një kuptim të veçantë kur flasim për kontrollin e presioneve inflacioniste në ekonomi. Në këtë pikë, kemi arritur në një moment shumë të rëndësishëm, në citimin e atij inflacioni që shkaktohet nga ekspansoni i kredisë në ekonomi – kredi që mund të marrë një individ, një kompani, një institucion tjetër çfardo etj..

Mënyra se si qeveria financon deficitin buxhetor mund të jetë dhe ajo në vetvete një burim i mundshëm inflacioni, sidomos kur deficiti buxhetor në mënyrë të qëndrueshme është i lartë dhe po në mënyrë të qëndrueshme ky deficit nuk i shitet publikut, por mbulohet me shtypje të re të parasë.

Pra, inflacioni në disa raste mund të jetë pasojë e një politike monetare ekspansioniste dhe në disa raste të tjera, sidomos në ekonomitë në zhvillim, ai mund të rrjedhë thjesht nga arbitrariteti i qeverisë për të financuar deficitin buxhetor me printim të ri parash. Në dyja rastet nuk bëhet gjë tjetër, veçse rritet më tej kërkesa e përgjithshme e ekonomisë për mallra dhe shërbime, e cila në kushtet kur nuk pasohet nga i njëjti ritëm i kapaciteve prodhuese – ofertës – i vendos çmimet kundrejt një presioni të fortë në rritje.

RAST STUDIMI.
Një ilustrim i kësaj situate është akoma i freskët në Shqipëri, mjafton të kujtojmë vitin 1996, kur presionet inflacioniste në ekonomi u shtuan në mënyrë të dukshme në fund të vitit si rezultat i rritjes së fuqishme të kërkesës së brendshme për mallra dhe shërbime.

IV.2. REGJIMET E MBAJTJES SË POLITIKËS MONETARE

Aktualisht, vendimet e politikës monetare marrin jetë nëpërmjet zbatimit të një regjimi të caktuar të ndikimit të tregut. Ky regjim, në fund të fundit, nënkupton përzgjedhjen e një objektivi të ndërmjetëm, i cili vlerësohet të jetë kontribuesi kryesor në përmbushjen e objektivave finalë. Në ndryshim nga objektivat finalë, objektivat e ndërmjetëm janë variabla makroekonomikë, të cilët, në një mënyrë ose në një tjetër, janë nën kontroll të drejtpërdrejtë të bankave qendrore si për shembull baza monetare, kursi i këmbimit etj..

Mënyra klasike e kontrollit mbi këta variabla është e thjeshtë, nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në treg (të parasë, këmbimeve valutore) ku çmimi i vendosur nga banka qendrore bëhet faktor përcaktues në formimin e të gjitha çmimeve të tjera si të huadhënies ashtu dhe atë të shitblerjes së valutave të huaja.

Sot, gjithnjë e më shumë bankat qendrore janë më të drejtpërdrejta në drejtim të inflacionit të pritshëm dhe kjo mundësohet duke bërë publike shifrën e objektivit të inflacionit në të ardhmen si dhe strategjinë, që banka do të ndjekë për ta detyruar inflacionin e pritshëm të përputhet me atë, që është vënë objektiv.

Nëpërmjet manipulimit të përqindjes së interesit, banka qendrore arrin të kontrollojë presionet e ardhshme inflacioniste në ekonomi. Politika monetare duhet të jetë shumë më e kujdesshme, veçanërisht kur ajo duhet të gjykojë për inflacionin në të ardhmen.

Si konkluzion mund të thuhet se ekzistojnë tre regjime të mbajtjes së politikës monetare: regjimi *monetary targeting* (sasisë së synuar të parasë apo targetimit monetar), regjimi *exchange–rate targeting* (kursit të synuar të këmbimit) dhe regjimi *inflation targeting* (inflacionit të synuar). Zgjedhja e llojit të regjimit të politikës monetare, para së gjithash, kushtëzohet nga ambienti ekonomik dhe nga natyra e mekanizmit të transmisionit që karakterizon çdo vend të veçantë. Për shkak se vende të ndryshme përballen me ambiente dhe me struktura të ndryshme ekonomike dhe financiare, është e kuptueshme se dhe ankorat e politikës monetare do të jenë të ndryshme në vende të ndryshme. Siç shkruan dhe Andrew Crockett **"një masë, jo në mënyrë të domosdoshme, duhet t'i korrespondojë të gjitha përmasave".**

Do të ndalemi në veçanti në regjimin e targetimit të parasë dhe në atë të inflacionit të synuar (*IT),* meqenëse janë raste që lidhen përkatësisht me regjimin aktual dhe me atë që synohet të adoptohet në të ardhmen në Bankën e Shqipërisë.

Regjimi i targetimit të parasë, konsiderohet si më i vlefshëm për të ashtuquajturat ekonomi në emergjencë dhe në tranzicion. Në këto vende, ku kanalet e financës nuk janë të zhvilluara (rast tipik ai i vendit tonë) me anë të vendosjes së objektivave monetarë i shërbehet shumë më mirë kontrollit mbi ekspansionin e kredisë në përgjithësi. Është fakt se në këto lloje vendesh kanalet e transmetimit të kredisë, nga këndvështrimi i politikës monetare janë nga më të rëndësishmet. Nga ana tjetër, objektivat e ndërmjetëm monetarë ndihmojnë dhe në vendosjen dhe në ruajtjen e disiplinës së

buxhetit. Kjo është një arsye shtesë pse Fondi Monetar Ndërkombëtar, në programet e tij të mbështetjes, imponon kushte për përqindjen e rritjes së parasë dhe të kredisë.

Faktorët e tjerë, që argumentojnë zbatimin e këtij regjimi, kanë të bëjnë me vështirësitë e mëdha, që hasen në adoptimin e dy regjimeve të tjera në ekonomitë në tranzicion. Regjimi i targetimit të kursit të këmbimit mbart rrezikun e prishjes së ekuilibrit të jashtëm, në rrethanat kur inflacioni i shkaktuar nga brenda vazhdon të jetë jashtë kontrollit. Ndërkohë, *inflation targeting* mund ta pësojë nga besueshmëria e pakët në një ambient me inflacion të paqëndrueshëm. Kjo do të pengonte arritjen e një objektivi themelor për *inflation targeting,* atë të orientimit të pritjeve të çmimeve të brendshme.

Box 2: Tipare të politikës monetare dhe regjimi i targetimit të parasë në Shqipëri.

Ecuria e inflacionit në Shqipëri, dëshmon pak a shumë se Banka e Shqipërisë ka ideuar dhe ka ndjekur një politikë monetare që prej mesit të vitit 1992, kur si pjesë e marrëveshjes së mbështetjes së FMN-së për Shqipërinë, u prezantuan disa vendime, të cilat synonin vendosjen e kontrollit mbi ofertën e parasë nëpërmjet përdorimit të instrumenteve të drejtpërdrejta të kontrollit. Ruajtja e stabilitetit të çmimeve të konsumit u cilësua si objektiv final i politikës monetare dhe si objektiv i ndërmjetëm u zgjodh baza monetare. Që nga korriku i vitit 1992 e deri më sot është adoptuar një regjim luhatës i lirë i kursit të këmbimit, ndërkohë që transaksionet në llogarinë korente janë të liberalizuara plotësisht.

Politika monetare për periudhën 1992-2002, është karakterizuar nga këto tipare kryesore:

- *nga një objektiv final i qartë: ruajtja e stabilitetit të çmimeve – fundi i çdo viti ka patur një objektiv sasior për inflacionin vjetor. Gjykimi për vendosjen e tij nuk ka rrjedhur nga ndonjë proces shumë i qartë analitik apo empirik. Për më tepër rrugët për arritjen e tij deri-diku kanë qenë jo plotësisht të qarta. Për gjithë periudhën nuk është zbuluar ndonjë lidhje mjaft shpjeguese midis rritjes së agregatëve monetarë dhe inflacionit;*

- *nga vendosja e një objektivi të ndërmjetëm për rritjen e parasë, respektimi i të cilit do të çojë në përmbushjen e objektivit final. Fuqia kontrolluese e bankës qendrore është e plotë vetëm mbi bazën monetare. Megjithatë, siç edhe u përmend më lart nuk zbulohen lidhje po kaq të forta, sa edhe fuqia kontrolluese e bankës mbi paranë, të inflacionit me agregatët monetarë, pavarësisht se ato nuk mund të mos merren në konsideratë. Aktualisht, përdorimi i M3 (-5) apo së fundi i M1 (-3), ndërhyjnë si variabla në modelin e parashikimit afatshkurtër të inflacionit mujor;*

- *nga aplikimi i kufizimeve sasiore në krahun e aktiveve: (1) MVN të Banka e Shqipërisë (kufi i poshtëm); (2) MBN të sistemit bankar (kufi i sipërm), i ndarë në kredi për ekonominë dhe në kredi neto për qeverinë. Në përgjithësi, këta objektiva janë realizuar kënaqshëm ndërkohë që realizimi i treguesve monetarë ka qëndruar larg nivelit të programuar për ta;*

- *nga një kontroll i drejtpërdrejtë i parasë – kontroll i cili u hoq përfundimisht në tremujorin e tretë të vitit 2000, duke eliminuar instrumentet direkte të kontrollit monetar;*

- *nga kontrolli i ofertës së parasë nëpërmjet instrumenteve indirekte, konkretisht përqindjes së interesit të repove. Për sa kohë që tregu monetar dhe ai ndërbankar janë ende të pazhvilluar, me mungesë fleksibiliteti, edhe përçimi i vendimeve të politikës monetare është më i vështirë. Nga ana tjetër, pozicioni i Bankës së Kursimeve, e cila ruan ende monopolin e depozitave në tregun e tyre, ka luajtur rolin e njërës palë me një volum transaksionesh jo shumë të konsiderueshëm në ankandin e repove. Në kushtet kur qeveria mbetet thithësja kryesore e rezervave të tepërta, këto të fundit shndërruar në shpenzime buxhetore, për më tepër që sunduesja kryesore e tregut të emetimit të bonove të thesarit ka qenë Banka e Kursimeve, ende e paprivatizuar;*

- *nga një gjendje e lartë e kredisë për qeverinë;*

- *nga një paqartësi dhe eficiencë e ulët apo më mirë të themi e vonuar e mekanizmit të transimisionit monetar që është e shprehur nga një situatë e një tregu ndërbankar të pazhvilluar, e një tregu primar të bonove të thesarit shumë të përqendruar dhe e një tregu formal kredish, ku më shumë huazohet në monedhë të huaj. Kjo bën që sinjalet e bankës qendrore të përçohen me shumë vështirësi, dhe efikasiteti i tyre të mos jetë ai i dëshiruari. Vlerësimi i efektivitetit të vendimeve të politikës monetare bëhet edhe më i vështirë në kushtet e ekzistencës së një ekonomie informale që mendohet të jetë mbizotëruese tek ne.*

Megjithëse nuk mund të jepet një vlerësim i plotë mbi efikasitetin e përdorimit të përqindjeve të interesit të repove, si instrument i politikës monetare, mund të themi se veprimet e vitit të kaluar (2002) të bankës qendrore duke i rritur ato, konkretisht dy herë rradhazi në muajt mars dhe prill 2002, ndihmuan në parandalimin e rritjes së presioneve inflacioniste në ekonomi. ***Kjo do të thotë që përsosja e zbatimit të këtij instrumenti mbetet një sfidë e pashmangshme për përçimin e vendimeve të politikës monetare të bankës sonë qendrore. Kjo përsosje konsiston në përmirësimin e të gjitha kanaleve të transmisionit ndër të cilët ai i tregut të parasë, i kreditit dhe i përcaktimit të pritjeve në ekonomi zënë vendin themelor.***

Sfida e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë: regjimi i inflation targeting (IT) apo i inflacionit të synuar.

Përpjekjet e deritanishme tregojnë se tashmë Banka e Shqipërisë është duke ecur në rrugën e vështirë të krijimit të premisave për zëvendësimin e regjimit aktual politikës monetare me *inflation targeting*. Për më tepër, mbajtja e regjimit të *inflation trageting*, është një ndër objektivat afatmesëm që banka qendrore po përpiqet ta realizojë nën asistencën e FMN-së. **Banka e Shqipërisë ka projektuar dhe synon të arrijë që për një periudhë 2-3 vjeçare të implementojë regjimin e politikës monetare të *inflation trageting*.**

Me përkufizim *inflation targeting* – inflacioni i synuar është një politikë monetare afatmesme, që nënkupton pesë elemente kryesore:

1 bërjen publike për një periudhë afatmesme të shifrës së inflacionit si një qëllim për t'u arritur;
2 angazhimin institucional për stabilitetin e çmimeve, si qëllim parësor të politikës monetare, nga i cili varen të gjitha qëllimet e tjera;
3 ndërtimin e një strategjie në të cilën përfshihen shumë variabla, jo vetëm agregatët monetarë apo kurset e këmbimit, të cilët janë përdorur për të përcaktuar kuadrin e politikës së instrumenteve;
4 rritjen e transparencës së strategjisë së politikës monetare, nëpërmjet komunikimit me publikun dhe me tregun, për planet, objektivat dhe vendimet e autoriteteve monetare;
5 rritjen e përgjegjësisë së bankës qendrore për të arritur objektivat e saj për inflacionin.

Të pesë elementet e mësipërme janë të rëndësishme, por, pa dyshim, më i spikaturi është domosdoshmëria e shpalljes publike të shifrës së vendosur si objektiv për t'u arritur për vitin e ardhshëm. Megjithatë, që të pretendosh se regjimi i adoptuar përkon me një *inflation targeting* është e rëndësishme t'i përmbahesh edhe katër parimeve të tjera. Ky fakt është shumë tregues për vendet në tranzicion ekonomik, sepse mjaft prej tyre e raportojnë objektivin për inflacionin si një rutinë të pjesës së planit ekonomik të qeverisë për vitin e ardhshëm, ndërkohë që strategjia e politikave të tyre monetare akoma nuk karakterizohet si një regjim për arritjen e objektivit të vendosur për inflacionin, i cili kërkon edhe aplikimin e katër elementeve të tjera, si mbështetje përtej periudhave afatmesme. Banka e Shqipërisë, e asistuar edhe nga një mision i asistencës teknike për këtë qëllim, po hedh hapa përpara që ndihmojnë adoptimin e këtij regjimi të politikës monetare. Në mënyrë shumë specifike ajo po punon për hartimin e një strategjie sa më të bazuar të parashikimit të inflacionit, të ndërtimit të një modeli makroekonomik që në bazë ka shpjegimin e mekanizmit të transmisionit të politikës monetare.

Një skemë e mundshme e këtij mekanizmi është:



Në skemë vijat e ndërprera pasqyrojnë lidhje ende të paargumentuara mirë, ndërkohë që ato të plota pasqyrojnë kanale transmetimi deri-diku eficiente. Nga ana tjetër, mbi bazën e diagramës së mësipërme është përvijuar deri-diku dhe një model i vogël makroekonomik.

Skema evidenton:

- një lidhje të dobët midis përqindjes afatshkurtër të interesit dhe inflacionit;
- pranohet dhe deri-diku është verifikuar, se një ndikim më të plotë mbi kërkesën agregate dhe mbi vetë inflacionin e ushtrojnë kursi nominal i këmbimit, politika fiskale, transfertat nga emigrantët etj.;
- edhe pse kursi nominal i këmbimit nuk është një ankorë nominale, përsëri duket se sjellja e përqindjes afatshkurtër të interesit ndikon mbi të;
- mungesën e tregut të kapitaleve, të letrave me vlerë, të aktiveve të qëndrueshme etj..

Vlerësojmë se procesi i parashikimit dhe i ndërtimit të modelit makroekonomik megjithëse ka hedhur hapa progresivë, përsëri ndeshet me probleme serioze:

- në drejtim të serive kohore: (1) ato janë në një moshë të re; (2) ato shpesh vuajnë nga prania e faktorëve *shock*-e, fakt që i bën ato edhe më të shkurtra dhe i kthen në jostacionare; (3) seri kohore të rëndësishme, pjesëmarrëse në modelim si PBB-ja, përqindja e papunësisë, indeksi i çmimeve të importit, janë vlerësime dhe aktualisht kanë pësuar ndërprerje për shkak të ndryshimeve metodologjike;

- në drejtim të tregjeve të pazhvilluara: kjo shkakton përballjen e vendimeve të politikës monetare për ndryshimin e normave afatshkurtra të interesit, me tregje deri-diku inekzistente, pa aktivitetin e të cilëve këto vendime kryejnë një rrugë shumë të ngadaltë duke rezultuar për një periudhë kohore ineficiente;

- në drejtim të njohurive në modelim: ato mgjithëse kanë avancuar, përsëri vlerësohen të jenë në një shkallë disi të kufizuar sidomos në fushën e modelimit etj..

Box 3: Pak histori mbi inflacionin në Shqipëri.

Seria e inflacionit në Shqipëri megjithëse bën pjesë ndër seritë më jetëgjata të treguesve makroekonomikë, përsëri është një seri me moshë të re. Kjo lidhet me historinë e vendosjes së marrëdhënieve të ekonomisë së tregut në vendim tonë, histori që daton prej afër 10 vjetësh të shkuara. Të flisje për inflacionin në kuptimin praktik apo për rritje çmimesh të mallrave të konsumit para vitit 1990 në Shqipëri, nuk ishte gjë tjetër veçse një hereti. Ndërsa sot jo vetëm që flasim për të, por jemi në gjendje që ta masim, ta kontrollojmë, ta analizojmë dhe për më tepër, ta parashikojmë deri-diku, të vendosim regjime të politikës monetare të adoptueshme për parashikimin e tij.

Grafik 1: Norma vjetore inflacionit (2000-2003) në %.



Siç është përmendur më parë inflacioni filloi të matej në dhjetor të vitit 1993, mbi bazën e një shporte mallrash dhe të një strukture konsumi, që rezultoi nga vrojtimi i buxhetit të familjeve shqiptare në vitin 1993.

Që prej asaj kohe e deri më sot, inflacioni ka ndjekur një rrugë në formë spiraleje. Pasi arriti në një nivel njëshifror, në fund të vitit 1995, u trefishua një vit më pas dhe deri në fund të vitit 1997 ai kapi pikën më të lartë të regjistruar, deri në atë kohë, 42 për qind. Kjo tronditje erdhi si rezultat i pashmangshëm i krizës së shkaktuar nga rënia e firmave piramidale në pranverën e këtij viti.

Viti 1998, ishte një periudhë rekuperimi dhe vënieje nën kontroll të tij nga ana e bankës qendrore. Jo më shumë se një vit më vonë, dhjetor 1999, u arrit një normë vjetore e tij në masën 8.6 për qind. Viti 2000 u karakterizua në përgjithësi nga norma vjetore të inflacionit me vlera negative, pra një periudhë e tërë e një "deflacioni" të lehtë. Por, kjo qetësi nuk vazhdoi gjatë. Në fakt që prej fundvitit 2000, banka qendrore paralajmëroi se ekonomia e vendit po hynte në një fazë ku presionet inflacioniste po intensifikoheshin. Ndonëse nën një kontroll të vazhdueshëm dhe mjaft të kujdesshëm, nuk mund të lihen pa u përmendur shifrat që norma mujore e inflacionit arriti në muajin korrik 2001, 5.6 për qind si edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2002, ku inflacioni vjetor shënoi shifra mjaft të larta, ndonëse fundi i tij, u mbyll me një normë vjetore të inflacionit 2.1 për qind, brenda objektivit të dëshiruar të Bankës së Shqipërisë.

Ngjarje e rëndësishme në jetën e inflacionit ishte rivlerësimi i tij mbi bazën e një shporte të re, e cila u publikua në fillim të vitit 2002.

Inflacioni dhe ngjarjet politike.

Studimet e deritanishme kanë konfirmuar se ngjarjet politike të tilla si periudha zgjedhjesh elektorale, presidenciale apo të tjera ngjarje të spektrit politik zakonisht lënë gjurmë në inflacionin e vendit. Në pjesën më të madhe të tyre ngjarje të tilla pasohen me vlera më të rritura të inflacionit, pra me intensifikim të presioneve inflacioniste.

Në fakt, edhe historia e re e inflacionit në Shqipëri nuk ka qëndruar indiferente ndaj ngjarjeve të rëndësishme brenda dhe jashtë vendit. Për më tepër, ato kanë qenë të dendura gjatë dekadës së fundit. Në këtë mënyrë, shpesh ngjarjet dhe efektet që ato kanë gjeneruar në ekonomi janë mbivendosur, duke lëkundur trendin historik të inflacionit. Rezultatet empirike të një studimi të tillë për Shqipërinë, kanë konfirmuar se vërtet trendi ka pësuar deformime pas periudhave të tilla, por ato që i kanë dhënë atij goditjet më të forta, kanë qenë dy:

- *periudha famëkeqe e pranverës së vitit 1997, e cila vijoi deri në gusht të këtij viti;*
- *periudha e krizës kosovare në pranverën e vitit 1999, e cila vijoi deri në fund të qershorit të këtij viti.*

Statistikisht të rëndësishme, këto dy periudha janë evidentuar si momente shock*-e në historinë e inflacionit. Megjithatë, ngjarja e parë, konsiderohet si një nga momentet më të vështira për t'u administruar nga ana e autoritetit monetar. Pasojat e saj e reflektuan për një periudhë më të gjatë në zhvillimin ekonomik të vendit, për të mos thënë që në aspektin social ato ndjehen ende edhe sot e kësaj dite. Gjithashtu, nga vlerësimet më të fundit, vitet elektorale, megjithëse jo në përmasat e ngjarjeve të mësipërme, rrisin inflacionin nga 0.5 -2 pikë përqindjeje më lart, sesa trendi i tij historik mesatar.*

Si konkluzion të përgjithshëm të kësaj pamjeje të shkurtër historike do të nënvizonim idenë se inflacioni ashtu si edhe ekonomia e vendit, është një tregues mjaft i brishtë, eksperienca e administrimit të mirë të të cilit ka kaluar tashmë fazën e saj "të varfër" dhe pa dyshim që i është drejtuar hapave më

V. NORMAT E INFLACIONIT DHE MATJET E TIJ.

Qëllimi final i politikës monetare të Bankës së Shqipërisë, është mbajtja nën kontroll e inflacionit në kushtet e ekzistencës së një regjimi të luhatjes së lirë të kursit të këmbimit. Për mëse tre vjet rresht, objektivi i dëshiruar, i bankës qendrore është përqendruar në arritjen e një norme vjetore të inflacionit në fund të vitit në bandën 2-4 për qind.

PËRSE NORMA VJETORE E INFLACIONIT DËSHIROHET TË JETË NGA 2-4 PËR QIND?

Normalisht normat e inflacionit nga 2-4 për qind konsiderohen të ulëta. Si të tilla ato mbështesin rritje ekonomike të qëndrueshme. Kjo është njëra nga arsyet që ky interval është i aplikueshëm në një varg vendesh me stabilitet makroekonomik të spikatur. Në rastin e Shqipërisë, një bandë e tillë konsiderohet e përshtatshme, sepse prej disa vitesh seria e inflacionit ka njohur nivele të moderuara deri në shumë të ulëta, përballë një rritjeje ekonomike të kënaqshme. Arsyeja e dytë për të kërkuar një normë të ulët të inflacionit ka të bëjë me një ndër parakushtet e rëndësishme të implementimit të regjimit të politikës monetare, *inflation targeting*, pasjen e normave të ulëta të inflacionit, që sigurojnë një stabilitet makroekonomik të përgjithshëm.

Përse nuk synohet një normë inflacioni zero për qind nga ana e Bankës së Shqipërisë?

Literatura ekonomike moderne dhe përvoja botërore nxjerrin në pah tre arsye të forta ekonomike dhe një arsye teknike, të cilat nuk mbështesin apo kundërshtojnë mbajten e një norme zero të inflacionit. Edhe Banka e Shqipërisë nuk e synon një normë të tillë, pikërisht për këto arsye.

- Arsyet ekonomike.

1. Jo gjithmonë çdo rritje çmimi mund të shkaktojë inflacion. Çmimet pasqyrojnë edhe cilësinë e mallrave dhe të shërbimeve. Përmirësimet e cilësisë, zakonisht, kërkojnë kosto "shtesë" njerëzore, materiale dhe teknologjike, që pa dyshim do të reflektohen në rritjen e çmimeve. Rritja e cilësisë së mallrave dhe të shërbimeve, është një kërkesë e brendshme e konsumatorëve dhe shpjegohet fare qartë në parimet e sjelljes konsumatore. Kjo do të thotë, që një pjesë jo e vogël e tyre, shpenzojnë të mira duke synuar drejt cilësive më të larta. Një inflacion zero, do të thotë një situatë e pandryshuar e çmimeve të mallrave të shportës, pra edhe cilësi e pandryshuar, fakt që nuk është praktikisht i vërtetë.

2. Mund të përmendet fakti që një inflacion i moderuar (i ulët) shërben si sinjal pozitiv për zgjerimin e prodhimit nga ana e prodhuesve, ndërkohë që një inflacion në nivelin zero për qind mund të konceptohet nga prodhuesit si shenjë që ekonomia është në stanjacion dhe që rritja e ofertës nuk do të përballohet nga kërkesa për konsum. Kjo arsye lidhet njëkohësisht, me synimin e Bankës së Shqipërisë për të patur një inflacion nga 2-4 për qind.

3. Një tjetër arsye ekonomike për mospreferimin e nivelit prej zero për qind të inflacionit është efekti pozitiv i një inflacioni të moderuar mbi konkurrencën në tregun e punës. Dihet që çdo vit sjell një rritje të pashmangshme në nivelin e pagave, i cili është vështirë të mbahet konstant ose të ulet në raport me vitin paraardhës. Nga ana tjetër, rritja e vazhdueshme e nivelit të pagave rrit kostot e prodhimit dhe konceptohet si një disavantazh krahasimor. Një inflacion i moderuar është një mënyrë indirekte për të ulur efektin real të rritjes së nivelit të pagave dhe për të ruajtur konkurrencën e tregut të punës.

- Arsyeja teknike.

e Shqipërisë, kontrolli mbi inflacionin në nivelin zero të jetë praktikisht i pamundur.

PARAQITJE E DISA MATJEVE TË INFLACIONIT.

Politika e bankës qendrore nuk mjaftohet vetëm me mbajtjen nën kontroll të inflacionit total. Matje të tjera i kanë ardhur në ndihmë politikëbërësve dhe vendimmarrësve të saj. Një nga matjet më të rëndësishme që deri-diku pasqyron punën e një banke qendrore dhe që ndeshet në të gjitha materialet dhe analizat, deri në fund të vitit 2001[3] është ajo e inflacionit bazë apo e inflacionit qendror. Ai mishëron praninë e elementit të përhershëm në inflacion që gjykohet të jetë kontribut i drejtpërdrejtë i politikës monetare. Ndërkohë, ndikimi i zhvillimeve në çmimet relative, në përgjithësi, konsiderohet si "çrregullim" i përkohshëm, i cili nga këndvështrimi i politikës monetare duhet të injorohet si përsa i takon vendimmarrjes aktuale, ashtu edhe përsa i takon vendimeve të marra në të shkuarën. Në vitin 1995, Doris Shiesser, arriti në konkluzionin se përqasja më e përshtatshme e matjes së inflacionit bazë në rastin e Shqipërisë, është ajo që merr për bazë 75 për qind të mallrave të vendosur në qendër të shpërndarjes.

Grafiku 2: Matjet e inflacionit.



Kjo arsye lidhet me mënyrën e matjes së IÇK-së. Është e pranueshme që derisa matja e këtij indeksi, mbi bazën e të cilit matet inflacioni, ngrihet mbi një proces të tërë vrojtimi, atëherë gabimet në matje dhe në llogaritje supozohen të jenë të pranishme, pavarësisht se metodologjitë synojnë drejt minimizimit të tyre. Mund të ndodhë që IÇK-ja të tregojë çmime më të larta sesa realiteti ose e kundërta. Kjo bën që për disa arsye, të cilat nuk varen nga Banka

Shihet qartë që edhe kjo matje ka reflektuar në periudhën 2000-2001, tendencën rritëse të inflacionit total, fakt që verifikon deri-diku, hyrjen e ekonomisë shqiptare në një periudhë inflacioniste.

Matje tjetër e inflacionit është ajo që merr në konsideratë ndarjen e shportës në dy sektorë, të mallrave të tregtueshëm dhe të patregtueshëm.

Grafik 3: Ndryshimet mujore të indeksit të çmimeve sipas sektorëve.



Box 4: Llojet e inflacionit që mund të përdoren në të ardhmen nga Banka e Shqipërisë si nivele objektive të politikës monetare.

Objektivi i politikës monetare për normën e inflacionit, është një pikë e diskutueshme, sidomos, në kushtet e ekonomisë shqiptare, e cila është në rrugën e rregullimeve strukturore. Tashmë dihet që, politika monetare Bankës së Shqipërisë, ndjek si tregues për objektivin e saj normën vjetore të inflacionit në fund të vitit.

Megjithatë, spektri i versioneve të tjera për zgjedhjen e një regjimi për objektivin për inflacionin është i larmishëm dhe pa dyshim, zgjedhja midis tyre me qëllim adoptimin e një forme tjetër në të ardhmen, nuk është e lehtë. Kjo për faktin se procesi i përzgjedhjes së versioneve lidhet ngushtësisht me një varg kushtesh që, mbi të gjitha, i referohen stadit aktual të zhvillimit ekonomik të vendit. Ndër matjet që përdoren më shpesh si objektiva për politikën monetare të bankave qendrore në botë do të përmendnim:

- *objektivi për të arritur një nivel* ***inflacioni aktual*** *në normë vjetore,* ***në fund të vitit****, në formën e një* ***intervali vlerash****;*
- *objektivi për të arritur një nivel* ***inflacioni aktual*** *në normë vjetore,* ***në fund të vitit****,* ***në një vlerë të vetme*** *apo* ***regjimi i*** **inflation targeting** *;*
- *objektivi për të patur një nivel vjetor* ***të inflacionit bazë****,* ***në formë intervali apo të një vlere të vetme****;*
- *objektivi për inflacionin mund të fokusohet në* ***një vlerë apo interval vlerash mesatare vjetore****.*

Aktualisht, Banka e Shqipërisë përdor variantin e parë, i cili ka tre karakteristika thelbësore:

së pari, është një objektiv në interval;
së dyti, është një vlerë aktuale;
së treti, është një vlerë e fundit të vitit.

Bazuar në këto veti, do të gjykonim që një objektiv në interval është i përshtatshëm për situatën aktuale të zhvillimit ekonomik të vendit. Mendojmë se vendosja e objektivit në një vlerë të vetme është ende shpejt. Parametra të tjerë mjaft të rëndësishëm ekonomikë duhet të plotësohen për të arritur në pika mjaft "strikte". Nga ana tjetër, ai është më fleksibël përballë reformave strukturore në vend. Në një anë tjetër, vetia e vlerës aktuale të inflacionit mbart në vetvete më shumë transparencë, kërkesë e domosdoshme për ushtrimin e një politike monetare të qartë. Për më tepër, ekzistenca e një transparence reale, është një kusht i domosdoshëm për zbatimin e një regjimi të ardhshëm të inflation targeting *në politikën monetare të bankës sonë qendrore.*

Vetia e tretë, inflacioni i faktuar në fund të vitit, është një informacion përfundimtar, që kufizohet vetëm për një moment kohe. Duket sikur edhe përpjekjet e politikës monetare kufizohen vetëm brenda një muaji apo vetëm në një shifër statistikore. Në fakt, fundviti kurorëzon punën mjaft të kujdesshme të kryer gjatë gjithë vitit nga autoriteti i vetëm monetar për realizimin e inflacionit brenda objektivit.

Prandaj, duke mos e kufizuar punën vetëm në një moment kohor dhe vetëm në një interval, Banka e Shqipërisë, në procesin e vendimmarrjes mbështetet edhe tek informacioni që sjellin kategoritë e tjera të inflacionit.

VI. RAPORTI MUJOR I POLITIKËS MONETARE DHE INFLACIONI.

Një nga faktorët që kushtëzon besimin e publikut ndaj politikës monetare të Bankës së Shqipërisë është që çdo veprim i saj të jetë i mirëkuptuar prej tij. Për këtë arsye, ajo përgatit dhe publikon në mënyrë periodike dokumente të rëndësishme të politikës monetare ndër të cilat është edhe Raporti Mujor i Politikës Monetare (RMPM). Ky raport përgatitet në Bankën e Shqipërisë që prej muajit tetor 2001 dhe që nga ajo kohë, cilësia e analizës që pasqyrohet në të ka ardhur në rritje.

Ai është një dokument shumë i rëndësishëm, sepse vihet në shërbim të drejtpërdrejtë të procesit vendimmarrës në Bankën e Shqipërisë. Në të bëhen vlerësime dhe analiza mbi zhvillimet monetare mujore më të fundit dhe mbi inflacionin e muajit paraardhës. Gjithashtu, jepen vlerësime mbi qëndrimet e së ardhmes duke paraqitur skenarë të mundshëm të zhvillimeve të ardhshme afatshkurtra në inflacion dhe propozon qëndrimet e politikës monetare duke i argumentuar ato.

Struktura e një raporti mujor, në përgjithësi, ndjek disa pika të rëndësishme që vlerësohet se japin një pamje të qartë të situatës monetare dhe të asaj të çmimeve konsumit nëpër të cilën po kalohet, duke krijuar premisat shpjegues për vendimet e së ardhmes.

Për të qenë më konkretë në vijim do të jepet shkurtimisht, struktura dhe përmbajtja e raportit të fundit të politikës monetare, shkurt 2003.

a) Struktura e raportit:

I. Zhvillimet kryesore.
II. Ecuria e inflacionit dhe faktorët që kanë ndikuar në muajin janar.
III. Zhvillimet monetare gjatë muajit janar 2003.
III.1 Zhvillimet monetare, inflacioni dhe politika monetare e Bankës së Shqipërisë.
III.2 Zhvillimet monetare.
III.3 Ecuria e likuiditetit të sistemit bankar.
III.4 Krediti i brendshëm.
III.4.1 Kredia për qeverinë.
IV. Ecuria e normave të interesit.
IV.1 Normat e interesit në tregun ndërbankar.
IV.2 Normat e interesit në tregun e bonove të thesarit.
IV.3 Normat e interesit të depozitave.
V. Pritshmëritë për inflacionin dhe qëndrimi i politikës monetare.
V.1 Pritshmëritë për inflacionin.
V.2 Qëndrimi i politikës monetare.

Që në fillim do të sqarohet se struktura e mësipërme paraqet variantin konfidencial, i cili i paraqitet Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Pjesa konfidenciale ka të bëjë me kapitullin e pestë, në të cilin paraqiten vlerësime të parashikimit të inflacionit, të paktën për një periudhë tremujore, ndërkohë që ekziston edhe një parashikim për gjithë vitin. Parashikimet mbështeten në zhvillimet historike të inflacionit si edhe në modelet që përmirësohen vazhdimisht nga ana e një stafi të specializuar në Departamentin e Kërkimeve dhe të Politikave Monetare në Bankën e Shqipërisë. Përkrah vlerësimeve sasiore për pritshmëritë e inflacionit, janë edhe argumentet apo analizat cilësore që i mbështesin ato. Pra, në trajtën e skenarëve të mundshëm për të ardhmen, kjo pjesë synon të krijojë një spektër më të gjerë arsyetimi për atë që mund të ndodhë me çmimet e konsumit. Duke u mbështetur në këta skenarë, bëhen propozime për qëndrimin e politikës monetare mbi normat e interesit, nëse ato do të ndryshohen (rriten apo ulen) apo nëse do të mbeten të pandryshuara. Kjo pjesë do të mbetet konfidenciale për sa kohë që procesi parashikues është ende në hapat e parë.

b) Një përmbledhje të shkurtuar:

II. Ecuria e inflacionit dhe faktorët që kanë ndikuar në muajin janar 2003.

Inflacioni vjetor i muajit janar 2003 rezultoi 0.28 për qind, një normë dukshëm nën kufirin minimal të intervalit objektiv të Bankës së Shqipërisë prej 2-4 për qind. Mesatarisht norma vjetore e inflacionit vazhdon të mbetet e lartë në 4.83 për qind, megjithëse këtë muaj prirja rritëse që prej mesit të vitit 2000 duket të jetë thyer.

Ndër faktorët që kanë ndikuar në normën e ulët të inflacionit gjatë këtij muaji mund të përmenden:

- Rënia e kërkesës për mallra ushqimorë dhe për shërbime pas festave të fundvitit.
- Mbajtja nën kontroll e agregatëve monetarë, kryesisht M1, të cilët kanë qëndruar brenda objektivit të Bankës

së Shqipërisë duke filluar nga muaji korrik i vitit të kaluar.

- Vlerësohet se ecuria e kursit të këmbimit ka ndihmuar në rënien e presioneve inflacioniste në ekonomi. Kështu, në dhjetor 2002 dollari amerikan u nënçmua, me 1.48 pikë përqindjeje në terma mesatarë, ndërsa euro u mbiçmua me 0.48 për qind kundrejt monedhës shqiptare. Nënçmimi i dollarit vazhdoi edhe gjatë muajit janar 2003 dhe mendohet të ketë ndikuar në uljen e çmimeve të mallrave të importuar.
- Përsa i përket inflacionit të importuar vlen të theksohet se megjithëse inflacioni i dhjetorit të vitit të kaluar për Eurozonën kaloi objektivin e Bankës Qendrore Evropiane (2 për qind) ai mbeti i ulët në 2.3 për qind. Ndërkohë që inflacioni vjetor i Eurozonës për muajin janar ka qenë më i ulët se objektivi (Financial Times, 10/02/03) duke treguar një prirje rënëse.

VII. ZHVILLIMET MONETARE GJATË MUAJIT JANAR 2003.

VII.1. ZHVILLIMET MONETARE, INFLACIONI DHE POLITIKA MONETARE E BANKËS SË SHQIPËRISË.

Zhvillimet monetare në muajin janar duket se po përmirësohen pas çrregullimeve që ndodhin zakonisht në muajin dhjetor. Paraja jashtë bankave u kthye me ritme të shpejta në sistem. Në muajin janar, paraja jashtë bankave u ul me 5 miliardë lekë nga 5.1 miliardë lekë të dalë në qarkullim në muajin dhjetor. Ulja e parasë jashtë bankave në janar, në terma absolutë, ishte mjaft e ngjashme me janarin e kaluar. Norma e rritjes vjetore të saj, e cila pësoi një ulje të ndjeshme në muajin dhjetor, qëndroi pothuaj në të njëjtin nivel edhe në muajin janar. Kthimi i parasë në sistem është shoqëruar me një rritje të shpejtë të depozitave në lekë dhe një qetësi në nivelin e normave të interesit.

Grafik I.1 . Inflacioni i 4 grupeve kryesore të shportës së IÇK-së (në përqindje).



Grafik II – 1: Norma vjetore e rritjes së parasë jashtë bankave dhe inflacioni.



Banka e Shqipërisë, ka ruajtur të pandryshuar qëndrimin e politikës monetare gjatë muajit janar. Politika monetare neutrale zbatohet në kushtet e uljes së inflacionit faktik, të inflacionit të parashikuar brenda kufijve të intervalit objektiv, si dhe të përmirësimit të gjendjes monetare. Ky pozicion i Bankës së Shqipërisë u përforcua më tej me ndryshimin e formës së ankandit të repove në muajin dhjetor.

së investimeve në letrat me vlerë në euro, si rezultat i mbiçmimit të euros kundrejt dollarit. Rritja e mjeteve valutore neto ka vazhduar edhe në muajin shkurt, si pasojë e aktivitetit valutor në blerje të Bankës së Shqipërisë.

Kthimi i parasë në sistem ka ndikuar në uljen e nivelit të mjeteve të brendshme neto gjatë muajit janar.

Tabelë II - 1: Realizimi i objektivit të RNN gjatë vitit 2002 (milionë dollarë).

	Qershor	Shtator	Dhjetor'02*	Janar'03*
Objektivi	530.6	546.6	558.6	559.27
Aktuale	550.1	570.9	563.1	574.0
Diferenca	19.5	24.34	4.49	14.69

*të dhëna operative.

Tabelë II - 2: Realizimi i objektivit të MBN gjatë vitit 2002 (miliardë lekë).

	Qershor	Shtator	Dhjetor'02*	Janar'03*
Objektivi	89.1	90.1	95.1	95.8
Aktuale	87.6	83.5	85.9	79.7
Diferenca	-1.6	-6.60	-9.22	-16.11

*të dhëna operative.

Banka e Shqipërisë, nëpërmjet politikës së saj, ka garantuar respektimin e objektivave sasiorë, edhe gjatë muajit janar. Rezerva ndërkombëtare neto e Bankës së Shqipërisë është rritur me rreth 10 milionë dollarë gjatë muajit janar. Rritja e saj është kryesisht pasojë e rritjes së vlerës

Mungesa e të dhënave të plota nuk na mundëson matjen e objektivit të tretë, atë të kredisë së brendshme neto për qeverinë. Megjithatë, ky objektiv u arrit të respektohej në muajin nëntor me një diferencë të ngushtë, 0.5 miliardë lekë.

Tabelë II - 3. Ecuria e kredisë së brendshme neto për qeverinë (në miliardë lekë).

	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor
Objektivi	244.2	245.1	246.1	247.0	250.3	253.7
Aktuale	246.8	249.1	250.1	247.0	250.4	253.1
Diferenca	2.6	4.0	4.0	0	0.1	-0.5

VII. 2. ZHVILLIMET MONETARE[4].

Sipas të dhënave operative të muajit janar 2003, ecuria e treguesit të parasë jashtë bankave dhe të depozitave në sistemin bankar manifeston të njëjtat tendenca si në muajin janar të vitit të kaluar.

Tabelë II – 4: Treguesit monetarë në muajin janar (në miliardë lekë).

	Ndryshimi absolut mujor Janar 2002	Janar 2003[5]
Paraja jashtë bankave	-3.5	-4.9
Depozita gjithsej	6.4	5.1
-në lekë	4.1	4.1
-në valutë	2.3	1.0
Depozita pa afat	-1.6	-1.4
-në lekë	-0.3	-1.8
-në valutë	-1.3	0.4
Depozita me afat	8.0	6.5
-në lekë	4.4	5.9
-në valutë	3.6	0.6

Reduktimi i parasë jashtë bankave është shoqëruar me një rritje të lartë të depozitave gjithsej, ndonëse me një ritëm më të ngadalësuar krahasuar me një vit më parë.

VII. 3. ECURIA E LIKUIDITETIT TË SISTEMIT BANKAR.

Gjendja e likuiditetit pati përmirësime të ndjeshme gjatë kësaj pjese të vitit 2003. Mungesa e likuiditetit në sistem zbriti nga 3.4 miliardë lekë në fund të muajit dhjetor, në 1.3 miliardë lekë në fund të muajit janar. Kjo tendencë vazhdoi edhe gjatë javëve të para të muajit shkurt. Sipas të dhënave operative, në datë 14 shkurt huamarrja e sistemit pranë Bankës së Shqipërisë ishte praktikisht 0[6].

Grafik II – 2: Ndryshimi vjetor i depozitave, në përqindje.



Kontributin kryesor në rritjen e depozitave gjithsej e kanë dhënë tërësisht depozitat me afat, ndërsa depozitat pa afat shënuan ulje.

Vëllimi total i investuar në **tregun primar** për periudhën e marrë në studim, ka qenë më i lartë se një vit më parë.

[4]Për analizën e këtyre zhvillimeve janë përdorur të dhëna operative, në pamundësi të shfrytëzimit të të dhënave të gjendjes monetare.
[5] Të dhënat janë operative.
[6] Huamarrja në këtë datë ishte vetëm 0.03 miliardë lekë.

Grafik II – 3: Krahasimi i vëllimit të investuar në treg primar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar (në milionë lekë).



Rastet e mosplotësimit të shumës së shpallur nga qeveria në tregun primar gjatë vitit 2003 kanë qenë më të shpeshta se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Politika neutrale, e ndjekur nga Banka e Shqipërisë gjatë kësaj periudhe, ka bërë që huamarrja e sistemit bankar të dominohet nga marrëveshjet e anasjellta të riblerjes me afat njëjavor (rreth 71 për qind[7]). Në javën e dytë të shkurtit, për herë të parë, pas një periudhe gati dhjetëmujore, Banka e Kursimeve nuk mori pjesë në ankandin e marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes njëjavore.

VII.4. KREDITI I BRENDSHËM[8]

VII. 4.1 KREDIA PËR QEVERINË.[9]

Në fund të vitit 2002 deficiti buxhetor arriti në 23.9 miliardë lekë. Muaji dhjetor shënoi një ulje të deficitit prej 9.3 miliardë lekësh krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Rreth 80 për qind e financimit të deficitit buxhetor ishte financim i brendshëm kryesisht nga financimi me bono thesari dhe obligacione dyvjeçare.

Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, rritja mujore e deficitit buxhetor ka qenë në nivele të ulëta. Ky deficit është mbuluar totalisht nga financimi i brendshëm.

VIII. ECURIA E NORMAVE TË INTERESIT.

Normat e interesit kanë qenë përgjithësisht të qëndrueshme gjatë muajve janar-shkurt. Në fillim të muajit shkurt janë vënë re tendeca të uljes së interesave në tregun e depozitave dhe në tregun primar të bonove të thesarit.

Grafik II - 4 : Ecuria e deficitit buxhetor (në miliardë lekë).



[7] Në nivel mesatar ditor.
[8] Në mungesë të të dhënave të kredisë për ekonominë ky seksion është reduktuar vetëm në kredinë për qeverinë.
[9] Të dhënat për muajt dhjetor 2002, janar dhe shkurt 2003 janë të dhëna operative.

INSTRUMENTET E POLITIKËS MONETARE: SI TË ZGJEDHIM & KUADRI OPERACIONAL I BANKËS SË SHQIPËRISË

LEKSION I GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, ZOTIT SHKËLQIM CANI, NË MARS 2003, NË UNIVERSITETIN BUJQËSOR TË TIRANËS.

HYRJE

Politika monetare e një bankë qendrore materializohet nëpërmjet instrumenteve të saj. Në mënyrë që një bankë qendrore të jetë e suksesshme në plotësimin e objektivave të saj, para së gjithash ajo duhet të disponojë një mjet efikas, nëpërmjet të cilit të mund të materializojë vendimet e saj, që merren nga bordet apo organet e tjera vendimmarrëse. Në këtë mënyrë, në praktikën e përditshme të punës sonë krijohet një shprehje, e cila rëndom njihet si **politika dhe instrumentet monetare**, një shprehje kjo që mishëron simbiozën e këtyre dy elementeve kyçe të bankigut qendror.

Instrument monetar, nuk është gjë tjetër vetëm se një veprim konkret i bankës qendrore, me anë të të cilit pretendohet të arrihet një synim i paracaktuar i politikës ekonomike.

Për të qenë pak më konkret, dëshiroj të marr një shembull, në qendër të të cilit është një ekonomi e brishtë, me një sistem bankar apatik, me tregje të pazhvilluara mirë ku ndërmjetësimi financiar është ende i ulët, me një deficit të lartë buxhetor etj.. Supozojmë për një moment se inflacioni në këtë ekonomi është duke u rritur vazhdimisht, si pasojë e politikës monetare ekspansionte, e cila në përgjigje të kërkesave të mëdha për likuiditet nga ana e qeverisë dhe e agjentëve ekonomikë për kredi, rrit vazhdimisht ofertën e parasë. Rritja e ofertës së parasë, nënkupton që banka qendrore nuk bën gjë tjetër veçse rrit sasinë e parave *cash* në qarkullim, duke bërë që likuiditeti në duart e konsumatorëve të jetë gjithnjë në rritje duke ushtruar në këtë mënyrë një trysni të fortë për rritjen e nivelit të përgjithshëm të çmimeve në ekonomi.I gjendur në këtë situatë, këshilli drejtuës i bankës qendrore, merr vendim për të vënë inflacionin nën kontroll, vendim ky që nënkupton se banka qendrore ka synimin që për një periudhë kohe të caktuar, të themi për 1 vit, ta ulë inflacionin nga niveli i rritur *x* në nivelin më të ulët *y*. Alternativat që i vihen para bankës në këtë moment janë disa. Çështja kryesore është si ta kontrollojmë rritjen e shfrenuar të ofertës së parasë në mënyrë që ajo të jetë në harmoni me nivelin e programuar të inflacionit *y*.

Në këtë rast, banka qendrore mund të ketë dy mundësi për të arritur rezultatin e dëshiruar, me instrumente të kontrollit direkt (të drejtpërdrejtë) dhe me instrumente indirekte (të tërthorta). Ajo mund t'i imponojë sistemit bankar kufizime të drejtpërdrejta, si për shembull të vendosë kufij në kapacitetet kredituese të bankave tregtare, të aplikojë nivele të larta të mobilizimit të një pjese të depozitave nga bankat tregtare në arkat e saj, mund të imponojë nivele dysheme interesi për depozitat e pranuara nga sistemi bankar etj.. Të gjitha këto raste, në literaturë njihen si kontroll i tregut të parasë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose ndryshe haset edhe termi instrumente monetare të drejtpërdrejta.

Në rastin tjetër, banka qendrore vendos që t'i imponojë tregut monetar vendimet e saj në një mënyrë më të tërthortë. Siç mund ta dini, bankat qendrore kanë aftësinë që të hyjnë në marrëdhënie financiare me bankat e nivelit të dytë. Më konkretisht, kjo do të thotë që banka qendrore mund të kreditojë bankën *a* kur ajo ka nevojë për likuiditet ndërkohë që nga banka *b*,



Figura 5. Roli i perqindjes se interesit ne ekonomi

[1]Leksion i guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, zotit Shkëlqim Cani, në mars 2003, në Universitetin Bujqësor të Tiranës.

e cila ka tepricë likuiditeti mund ta tërheqë atë në formën e depozitës.

[* File contains invalid data | In-line.JPG *]Të dy krahët e kësaj marrëdhënieje financiare bankë qendrore – bankë tregtare, kryhen kundrejt një çmimi, i cili në literaturë njihet me emrin përqindja e interesit me të cilën banka qendrore ofron likuiditet ose ndryshe përqindja bazë e interesit në ekonomi.

Në të gjitha rastet kur banka dëshiron të pakësojë ofertën e parasë, atëherë ajo rrit përqindjen bazë në ekonomi, e për rrjedhim çmimi i parasë bëhet më i lartë. Kjo bën që investitorët dhe agjentët ekonomikë, në përgjithësi, të ulin kërkesat e tyre për para, duke ndikuar në këtë mënyrë kërkesën agregate e për rrjedhim, edhe presionet inflacioniste në ekonomi. Në të vërtetë, kjo nuk ndodh në një mënyrë të menjëhershme dhe kaq perfekte. Siç dihet, marrëdhënie të ndërsjella të huazimit të parave nuk krijohen vetëm në marrëdhëniet bankë qendrore – bankë tregtare. Vetë tregu financiar është më i madh si nocion dhe ai nuk nënkupton vetëm tregun e parasë. Ekziston edhe një treg tjetër, që quhet tregu i kapitaleve ku para të lira investohen për të rikapitalizuar koorporatat dhe bizneset e ndryshme. Po kështu, ekziston dhe një treg tjetër, ai i letrave me vlerë ku agjentë ekonomikë në nevojë plotësojnë nëpërmjet huamarrjes nevojat e tyre për likuiditet. Përveç tregut financiar ekzistojnë edhe tregje të tjera si ai ku valuta kombëtare shkëmbehet me valutat e huaja ose si ai ku shiten dhe blihen pasuri të paluajtshme etj..

Qëllimi im nuk është që të shpjegoj se cilët janë dhe si funksionojnë tregjet. Ndoshta këtë mund ta bëjmë një herë tjetër. Ajo që unë e shoh me interes për momentin ka të bëjë me faktin se ashtu si në rastin e marrëdhënies bankë qendrore – bankë tregtare edhe në këto tregje ekziston një çmim për çdo transaksion, i cili edhe ky, në literaturë njihet si përqindje interesi. E rëndësishme është të theksojmë se edhe këto përqindje interesi, që siç e shpjeguam më sipër përbëjnë çmimin me të cilin tregtohet, ndikohen nga ndryshimi i përqindjes bazë në ekonomi, ndonëse me një periudhë vonesë. Ky proces transmetimi i efektit të ndryshimit të përqindjes bazë në përqindjet e tjera që mbizotërojnë në segmentet e tjera të tregut financiar si dhe në tregjet, në përgjithësi, njihet si procesi i transmisionit monetar (shih figurën 1 – rasti i ekonomive të zhvilluara dhe figurën 2 – rasti i Shqipërisë) i cili në praktikën e përditshme përbën thelbin e mekanizimit që shpjegon efektivitetin e politikës monetare në një ekonomi të caktuar.



Figura 2. Korniza aktuale e politikes monetare

I gjithë ky proces i kontrollit të tregjeve nëpërmjet manipulimit të përqindjes bazë në ekonomi njihet si kontroll i tregjeve në mënyrë të tërthortë ose ndryshe haset me termin përdorim i instrumenteve të tërthorta të kontrollit të parasë. Të dyja rastet e kontrollit monetar kanë një synim: kontrollin e ofertës së parasë, por siç e vutë re, mënyra se si arrihet ky kontroll është i ndryshëm. Zgjedhja e njërës alternativë apo e alternativës tjetër ndryshon nga njeri vend në tjetrin.

Në qoftë se i referohemi shembullit tonë për ekonominë që përshkruam më sipër, besoj se e kuptoni që për arsyet e përmendura gjatë shpjegimit të secilit prej dy rasteve, banka qendrore do të ishte e predispozuar të zgjidhte instrumente e kontrollit të drejtpërdrejtë të parasë, ndërkohë që do të kishte shumë pak shanse për të qenë e suksesshme në rast se do të tentonte me anë të kontrollit të ofertës së parasë nëpërmjet tregut të parasë. Megjithatë, në praktikë procesi seleksionues për ekonomi si ajo që ne morëm shembull është më i vështirë.

Rasti i dytë është tipik për ekonomitë e zhvilluara aty ku dhe efekti ishte maksimal. Kjo, për shkakun e thjeshtë se mobiliteti dhe zhvillimi i tregjeve është i madh e për rrjedhim, një reagim i bankës qendrore perceptohet menjëherë prej tyre dhe reflektohet me po atë shpejtësi.

Nga ana tjetër, dua të them se edhe një grup bankash qendrore të vendeve në tranzicion, midis të cilëve bën pjesë edhe Banka e Shqipërisë, kanë përshtatur këtë sistem të kontrollit të parasë, domethënë kontrollin monetar nëpërmjet instrumenteve të tregut. Ndryshe nga ekonomitë e zhvilluara, kontrolli monetar në ekonomitë tona nuk është i përsosur, e kjo para së gjithash, për vetë shkallën e zhvillimit të sistemit bankar, të tregut financiar, të infrastrukturës bankare etj..

Megjithatë stadi aktual i kontrollit monetar nëpërmjet tregut, përbën një arritje për këto ekonomi, aq më tepër po të kemi parasysh se 10 vjet më parë, pothuajse shumica e tyre operonte me instrumente të drejtpërdrejta të kontrollit monetar. Ky zhvillim, në vetvete tregon se edhe pse disi në mënyrë të ngadaltë, tregjet në vendet tona po zhvillohen dhe gjithnjë e më shumë po krijojnë hapësira për perfeksionimin e transmetimit të vendimeve monetare në ekonomi.

EVOLUIMI I INSTRUMENTEVE TE POLITIKËS MONETARE.

Aktualisht, politika monetare e Bankës së Shqipërisë ka hyrë në një fazë të re interesante të zhvillimit të saj, që nga momenti (tremujori i tretë i vitit 2000) kur u hoq dorë në mënyrë përfundimtare nga aplikimi i instrumenteve të drejtpërdrejta të kontrollit monetar. Për një kohë relativisht të gjatë, rreth 8 vjet, zbatimi i politikës monetare ju besua dy instrumenteve kryesore, të cilat në vetvete ishin thjesht dy vendime administrative të Bankës së Shqipërisë, të cilat konsistonin në rritjen e kufizuar të tepricës së kredisë nga ana e bankave tregtare si dhe në detyrimin që kishin bankat me kapital shtetëror, për të respektuar nivelin minimal të normës së interesit për depozitat me afat në lekë, të shpallur nga ana e Bankës së Shqipërisë.

KUFIRI I KREDISË

Sistemi bankar i pazhvilluar dhe mosprania e një tregu formal të zhvilluar të kredisë, i imponuan Bankës së Shqipërisë, domosdoshmërinë, që duke filluar nga mesi i vitit 1992, të kontrollonte sasinë e kredisë të dhënë sektorit joqeveritar, nëpërmjet aplikimit të kufijve të kreditit në mënyrë të veçantë për çdo bankë të sistemit bankar. Për të siguruar një lloj fleksibiliteti si dhe për të inkurajuar bankat që të fillonin forma të thjeshta të transaksioneve ndërbankare, u pa e arsyeshme që kufijtë të ishin të tregtueshëm midis bankave.

Gjithësesi, duhet thënë se problemet e hasura ishin të shumta, sidomos ato që kishin të bënin me raportimin dhe me mbikëqyrjen e respektimit të kufijve të akorduar. Kredia e re për sektorin privat[1] filloi të rritet me ritme të shpejta, dhe në fund të vitit 1993, ajo zinte rreth 11 për qind të totalit të kredisë krahasuar me 4 për qind që ishte një vit më parë. Për shumë arsye objektive dhe subjektive, respektimi i këtyre kufijve, në shumë raste, u bë e pamundur të arrihej, duke ulur kështu, eficiencën e këtij instrumenti.

Megjithatë, shtimi i huamarrjes në sektorin informal të ekonomisë, uli gradualisht kërkesën për kredi ndaj sistemit bankar, ndërkohë që,

duke filluar nga muaji maj i vitit 1995, sistemit bankar iu shtua dhe një alternativë tjetër investimi, bonot e thesarit. Në këtë mënyrë, roli i kufirit të kredisë ra ndjeshëm dhe sidomos pas krizës së vitit 1997, kur si për shkaqe të normave të mbikëqyrjes bankare ashtu dhe për arsye të skepticizmit që karakterizon sistemin bankar ndaj biznesit privat në përgjithësi, ky instrument filloi të humbasë kuptimin e tij derisa në vitin 1999, u hoq dorë përfundimisht nga aplikimi i mëtejshëm i tij.

PËRQINDJA E INTERESIT

Në kontekstin historik, përpara vitit 1992, përqindja e interesit nuk ka luajtur ndonjë rol shpërndarjeje në ekonomi. Gjatë gjithë viteve '80, përqindja e interesit për depozitat ishte e pandryshuar në intervalin 0.5 – 3 për qind, ndërkohë që, nuk ekzistonte diferencimi midis përqindjeve të kredisë me depozitat. Edhe pse në nëntor të vitit 1991, pati një rritje të përgjithshme të përqindjeve të interesit, përsëri ato nuk mundën të ishin "konkurruese" me normat e një inflacioni galopant që po kalonte ekonomia në atë periudhë.

Me fillimin e përpjekjeve për stabilizimin e ekonomisë, në mesin e vitit 1992, akordimi i një përqindjeje reale në kthim u mendua se do të ishte kyçi kryesor në arritjen e suksesit, sidomos për mobilizimin e burimeve dhe të investimeve financiare. Lëvizja e parë ishte rritja e përqindjes minimum për depozitat me afat në lekë, nga nivele të ulta në 4 – 8 për qind në 22[2] – 32 për qind. Në përgjigje të kësaj të fundit edhe normat për përqindjet e kredisë u rritën ndjeshëm, duke arritur kulmin me 39 për qind për kreditë me maturim njëvjeçar. Efekti i kësaj rritjeje, në dy-tre vitet e para të tranzicionit ishte i qartë dhe i dukshëm. Frenimi i hemoragjisë së parasë, përkoi me një rritje të depozitave në sistem, ndërkohë që inflacioni u frenua ndjeshëm duke zbritur në mënyrë konstante, derisa arriti në një nivel njëshifror, në fundin e vitit 1995.

Pa qenë nevoja t'i kthehemi fenomenit fajde, periudha 1996 – 1997, ndoshta dhe diçka me herët, përkon me një kolaps të përqindjes së interesit dhe, për rrjedhim, dhe të vetë politikës monetare të asaj kohe, derisa vijmë në një periudhë tjetër rritjeje të madhe të përqindjes administrative të interesit për depozitat me afat në lekë. Zhvillimet e faktuara në inflacion gjatë periudhës, 1999 – 2000, ishin të pazakonta, pasojë e tyre ishte një zbutje e vazhdueshme e kushteve të politikës monetare përgjatë gjithë kësaj periudhe. Në këtë mënyrë, vijmë në tremujorin e tretë të vitit 2000, kur reagimi i bankave nuk po ndiqte më uljet e vazhdueshme të përqindjes administrative, nga ana e Bankës së Shqipërisë. Në këto rrethana u mor në konsideratë, një rikonceptim i tërë kuadrit operacional të deriatëhershëm, dhe u vendos që politika monetare e Bankës së Shqipërisë të bazohej vetëm në aplikimin e instrumenteve të tregut. Më konkretisht, u vendos që roli i përqindjes bazë në ekonomi t'i jepej, normës së përqindjeve të marrëveshjes së riblerejes (repove), transaksione këto që do të zhvilloheshin në ankande të rregullta javore[3], të cilat do të mbaheshin nga ana e Bankës së Shqipërisë.

Siç e tregon dhe figura 3., instrument parësor i politikës monetare të Bankës së Shqipërisë është norma fikse e përqindjeve të repos javore, e cila në varësi të sinjalit që do të çojë në treg Banka e Shqipërisë, ofrohet ose në ankande ku shuma e pranuar është e pakufizuar[4] kundrejt çmimit të fiksuar, ose në anakande ku shuma e pranuar është fikse[5] dhe çmimi i shpallur është nivel kufi. Pavarësisht formës së ankandit, qëllim i vetëm është kontrolli i likuiditetit në sistem, duke synuar mbajtjen e tij në nivele optimale, në mënyrë që të sigurohet eficiencë maksimale e mekanizmit të transmisionit.

Nga ana tjetër, siç mund të merret me mend, përqindja fikse e repove, shërben dhe si referencë për përqindjet e tjera, kryesisht e kam fjalën për lehtësirat kredituese që Banka e Shqipërisë i ofron sistemit bankar (një paraqitje e detajuar jepet në çështjen e tretë të këtij leksioni).

---

[1] Ndonëse duhet thënë që baza e nisjes ishte shumë e ulët.

[2] Përqindja për depozitat me maturim tremujor.

[3] Në varësi të synimeve të Bankës së Shqipërisë, ankandet mund të jenë: (i) marrëveshje riblerjeje – për të thithur likuiditet – ose marrëveshje të anasjellta riblerjeje – për të injektuar likuiditet në treg.

[4] Në këtë rast mund të thuhet se tregut i jepet sinjali i një politike monetare neutrale, ashtu siç po ndodh aktualisht që prej pranverës së fundit.



Figura 1. Korniza aktuale e politikes monetare

INSTRUMENTE TË TJERA

Përdorimi i disave prej instrumenteve të tërthorta të kontrollit monetar është i hershëm, dhe për këtë do të kujtoj aplikimin e rezervave të detyrueshme, ofrimin e një numri lehtësirash kreditimi nga ana e Bankës së Shqipërisë etj.. Megjithatë, duhet theksuar se vitet e fundit kanë shënuar lëvizje të mëdha në drejtim të kuadrit operacional të Bankës së Shqipërisë dhe, më konkretisht, do të evidentoja shkurtimisht listën, statusin, qëllimin etj. të instrumenteve monetare, aktualisht në dispozicion të Bankës së Shqipërisë.

SHITBLERJET ME TË DREJTA TË PLOTA TË LETRAVE ME VLERË.

Shitblerjet permanente të letrave me vlerë mund të përdoren në ato raste kur kërkohet një sterilizim, me bazë të qëndrueshme, i tregut. Aktualisht, si instrumenti që përdoret në kryerjen e këtyre transaksioneve shërbejnë bonot e thesarit me maturim deri në një vit si dhe me afat maturimi të mbetur, jo më pak se 14 ditë. Gjatë vitit 2001, janë kryer dy shitje permanente bonosh thesari për një shumë prej rreth 8 miliardë lekësh dhe në të dyja rastet, blerësi ka qenë Banka e Kursimeve.

NDËRHYRJET NË TREGUN VALUTOR

Megjithëse Banka e Shqipërisë ka adoptuar një regjim këmbimi valutor plotësisht fleksibël, ajo përsëri gjatë gjithë kohës ka qenë e pranishme në treg, në shumicën e rasteve për të shmangur spekulimet me lekun. Në rastin e shitblerjes së valutës, transaksionet mund të jenë me të drejta të plota ose me bazë të përkohshme (*sëaps*). Të tilla raste ka patur edhe gjatë vitit 2002. Në periudhën mars – prill të këtij viti, Banka e Shqipërisë ka shitur rreth 6 milionë dollare valutë ndërkohë që në muajin dhjetor 2002, ka blerë diçka më shumë se 2.5 milionë dollarë. Po kështu, kemi blerë valutë edhe gjatë tremujorit të parë të këtij viti.

LEHTËSIRAT KREDITUESE

KREDIA LOMBARD.

Lehtësia e kreditimit lombard është prezantuar relativisht herët, por duhet thënë se ajo është përdorur në raste shumë të rralla[6]. Kuptohet që qëllimi i saj është klasik, ofron një ndihmë për bankat me probleme të përkohshme[7] likuiditeti dhe konsiderohet si burim kreditimi i fundit, pasi

[5] Fillimisht ankandet e repove konsistonin në pranimin e shumave të shpallura që më parë kundrejt një çmimi tavan gjithashtu, të shpallur. Me anë të këtij veprimi, tregut i jepej një sinjal i qartë për të ulur më tej përqindjet e interesit.
[6] Në periudhën 2000 – 2002 është përdorur vetëm një herë.
[7] Maturimi i saj shkon deri në tre muaj dhe mund të përfitohet vetëm një herë gjatë një tremujori.

të jenë shfrytëzuar paraprikisht të gjitha mundësitë e tjera. Aktualisht, përbën dhe përqindjen më të shtrenjtë që ofron Banka e Shqipërisë në sistem.

Çmimi i kredisë lombard[8], caktohet si shumë e përqindjes së repove plus një penalizim në masën 6 për qind.

KREDI NJËDITORE.

Kjo lehtësi kreditimi i është ofruar sistemit bankar vitin e fundit, dhe ka për qëllim furnizimin me likuiditet njëditor të bankave të veçanta, që kanë nevojë për të. Nga vetë emri kuptohet që kredia duhet shlyer ditën pasardhëse dhe çmimi[9] i saj, ashtu si kredia lombard bazohet në çmimin e repove javore plus një penallti në masën 2.5 për qind. Kredia[10] njëditore është përdorur relativisht rrallë.

REZERVA E DETYRUESHME

Rezerva e detyrueshme është një nga instrumentet e pakta të kontrollit të tërthortë, që është përdorur që nga korriku i vitit 1992, dhe që për më tepër ka ruajtur të njëjtin nivel, prej 10 për qind që prej asaj kohe.

Rezerva e detyrueshme llogaritet mbi të gjitha depozitat[11] (detyrime të bankave tregtare ndaj të tretëve) si në lekë ashtu dhe në monedhë të huaj. Një risi e kohëve të fundit, i përket tetorit të vitit 2000, kur Banka e Shqipërisë, me qëllimin e vetëm për të ulur koston e ndërmjetësimit të sistemit bankar, ofroi një nivel remunerimi të tyre, fillimisht në masën 1/3 e përqindjeve[12] të tregut dhe duke filluar që nga tremujori i parë i vitit 2001, nisur nga dëshira për të pasur një efekt më të shpejtë, niveli i remunerimit kaloi nga 1/3 në ½ e përqindjeve të tregut.

OPERACIONET E TREGUT TË HAPUR

Operacionet e tregut të hapur luajnë rolin kryesor në transmetimin e politikës monetare në sistemin bankar. Ato kanë për qëllim të rregullojnë normën e interesit në treg, të administrojnë likuiditetin e tregut si dhe t'u transmetojnë bankave sinjale në lidhje me politikën monetare që do të ndiqet nga Banka e Shqipërisë. Theksohet se operacionet e tregut të hapur janë ekskluzivitet i Bankës së Shqipërisë, e cila vendos llojin e instrumentit që do të përdorë si dhe kushtet përkatëse lidhur me ekzekutimin e tyre.

Sipas qëllimit të përdorimit të tyre, operacionet e tregut të hapur ndahen në: *operacioni kryesor i tregut*, *operacione rregulluese* dhe *operacione strukturore*. Marrëveshjet e riblerjes janë instrumenti kryesor dhe mund të përdoren për të tre qëllimet e lartpërmendura, ndërsa shitblerjet më të drejta të plota përdoren vetëm për qëllime rregulluese ose strukturore.

MARRËVESHJET E RIBLERJES

LLOJI I INSTRUMENTIT

Marrëveshjet e riblerjes janë operacione të tregut të hapur gjatë të cilave Banka e Shqipërisë u shet letra me vlerë bankave të nivelit të dytë dhe i rible ato në datën e caktuar sipas kushteve të paracaktuara. Ndërsa marrëveshjet e anasjellta të riblerjes janë operacione të tregut të hapur gjatë të cilave Banka e Shqipërisë ble letra me vlerë dhe i rishet në datën e caktuar sipas termave të kontratës. Natyra ligjore e instrumentit

Letrat me vlerë që tregtohen nëpërmjet zhvillimit të marrëveshjeve (e anasjellta) të riblerjes janë të blera paraprakisht nga Banka e Shqipërisë ose nga bankat e nivelit të dytë në tregun primar apo sekondar të bonove të thesarit.

Vetëm marrëveshjet e anasjellta të riblerjes konsiderohen si hua të kolateralizuara, ku vlera e kolateralit është 115 për qind e shumës pjesëmarrëse në ankand. Kjo shumë duhet të jetë minimalisht 5 milionë lekë, dhe ajo mund të rritet vetëm me shumëfisha prej 100 mijë lekësh. Si kolateral shërbejnë bonot e thesarit me afat fillestar maturimi deri në një vit dhe me periudhë të mbetur deri në maturim jo më pak se 14 ditë.

---

[8] Aktualisht, çmimi i saj është 13 për qind.
[9] Aktualisht çmimi i saj është 9.5 për qind.
[10] Deri më 31 tetor 2001.
[11] Bëjnë përjashtim depozitat ndërbankare.
[12] 1/3 e përqindjes së bonove të thesarit me maturim tremujor për rezervën në lekë dhe 1/3 e përqindjes së depozitave mujore në usd dhe në euro respektivisht për rezervën në usd dhe për rezervën në euro.

OPERACIONI KRYESOR I TREGUT

Operacioni kryesor i tregut konsiderohet marrëveshja (e anasjellte) e riblerjes me maturim shtatë ditë, e cila është edhe instrumenti kryesor i Bankës së Shqipërisë për zbatimin e politikës monetare. Karakteristikat themelore të marrëveshjeve (të anasjellta) të riblerjes mund të përmblidhen si më poshtë:

- Qëllimi i përdorimit të tyre është rregullimi i interesave të tregut, administrimi i likuiditetit dhe sinjalizimi për drejtimin e politikës monetare.
- Janë të tipit ankand me shumë të përcaktuar dhe me shumë çmime ose ankand me çmim fiks dhe shumë të papërcaktuar.
- Norma fikse e interesit të marrëveshjeve (të anasjella) të riblerjes miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë. Kjo normë shërben dhe si nivel maksimal ose minimal për ankandet me shumë çmime.
- Marrëveshja e riblerjes përdoret për tërheqjen e likuiditetit nga sistemi bankar, ndërsa marrëveshja e anasjelltë e riblerjes përdoret për injektimin e likuiditetit në sistem.
- Ankandi për këto lloj marrëveshjesh organizohet çdo javë dhe është i tipit standard.
- Maturimi i këtij instrumenti është shtatë ditë.
- Të gjitha bankat e nivelit të dytë, që kanë llogari pranë Bankës së Shqipërisë kanë të drejtë të jenë pjesëmarrëse në këto ankande.

OPERACIONE STRUKTURORE

Instrumentet që përdoren për operacione strukturore të tregut të hapur janë marrëveshjet (e anasjellta) e riblerjes me maturim një dhe tre mujor si dhe shitblerjet me të drejta të plota. Më poshtë vijojnë karakteristikat e marrëveshjeve (të anasjellta) të riblerjes me maturim një dhe tre mujor:

- Qëllimi i përdorimit të tyre është rregullimi i pozicioneve strukturore si dhe administrimi i likuditetit (shtimi ose pakësimi me baza të përkohshme).
- Ankandet për këto lloj marrëveshjesh janë të tipit të shpejtë dhe nuk janë të fiksuara paraprakisht.
- Norma e interesit për këto marrëveshje i referohet normës së tregut në kohën e shpalljes së ankandit.
- Banka e Shqipërisë ka të drejtë t'i refuzojë kërkesat, të cilat lëvizin shumë nga normat aktuale të interesit në tregun e parasë.
- Të gjitha bankat e nivelit të dytë, që kanë llogari pranë Bankës së Shqipërisë kanë të drejtë të jenë pjesemarrësë në këto ankande
- Operacionet rregulluese
- Për ekzekutimin e operacioneve rregulluese të tregut të hapur përdoren marrëveshjet (e anasjellta) e riblerjes me maturim një ditë, një dhe tre muaj si dhe shitblerjet me të drejta të plota. Tiparet operacionale të marrëveshjeve (te anasjellta) të riblerjes me maturim njëditor janë:
- Qëllimi i përdorimit të tyre është rregullimi i luhatjeve të papritura në treg.
- Ankandet janë të tipit të shpejtë dhe frekuenca e tyre nuk është e standardizuar.
- Norma e interesit i referohet normës fikse të interesit të marrëveshjeve (të anasjellta) të riblerjes me maturim shtatëditor, e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.
- Të gjitha bankat e nivelit të dytë, që kanë llogari pranë Bankës së Shqipërisë kanë të drejtë të jenë pjesëmarrëse në këto ankande.

PROCEDURAT E ANKANDIT

Operacionet e tregut të hapur në Bankën e Shqipërisë zhvillohen në formën e ankandit. Box 1 përmbledh hapat e ndjekur gjatë organizimit dhe zhvillimit të ankandeve. Banka e Shqipërisë operon me dy lloje ankandesh: ankand i tipit standard dhe ankand i shpejtë. Procedurat e të dy llojeve të ankandeve janë njësoj përveç kohës së organizimit.

ANKANDI STANDARD

Ankandet standarde ekzekutohen 24 orë pas

njoftimit të bërë nga Departamenti i Operacioneve Monetare në Bankën e Shqipërisë. Këto ankande zhvillohen çdo javë, ditën e mërkurë ose ditën paraardhëse kur e mërkura është pushim zyrtar. Diagrama 1 prezanton etapat kohore të zhvillimit të ankandit standard. Vetëm ankandi i operacionit kryesor të tregut, domethënë i marrëveshjeve (të anasjellta) të riblerjes është i tipit standard.

ANKANDI I SHPEJTË

Ankandet e shpejta zhvillohen për marrëveshjet (e anasjellta) e riblerjes me maturim njëditor, njëmujor dhe tremujor. Ato zhvillohen sa herë të gjykohet e nevojshme nga Banka e Shqipërisë. Për marrëveshjet (e anasjellta) e riblerjes me maturim njëditor, ankandi zhvillohet brenda dy orëve nga njoftimi i Departamentit të Operacioneve Monetare. Ndërsa për marrëveshjet njëmujore dhe tremujore, ankandi zhvillohet brenda katër orëve nga njoftimi.

ANKANDET ME ÇMIM FIKS DHE ME SHUMË ÇMIME

Banka e Shqipërisë operon me dy lloje ankandesh: ankande me çmim fiks dhe ankande me shumë çmime. Ankandi me çmim fiks nënkupton ankandin e marrëveshjeve (të anasjellta) të riblerjes, të organizuar nga Banka e Shqipërisë, në të cilin plotësimi i kërkesave të pjesëmarrësve bëhet sipas interesit të riblerjes, të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë. Ndërsa në ankandin me shumë çmime, plotësimi i kërkesave të pjesëmarrësve bëhet sipas interesit të riblerjes të kërkuar nga bankat, por jo më i lartë/ më i ulët se interesi i riblerjes i ofruar nga Banka e Shqipërisë.

NJOFTIMI PËR ANKANDIN

Mesazhi që u dërgohet bankave për organizimin e ankandeve të marrëveshjeve (të anasjellta) të riblerjes, përmban informacionin e mëposhtëm:

- numrin e ankandit;
- tipin e ankandit (shitje/blerje);
- llojin e ankandit (me shumë çmime/me çmim fiks);
- shumën që ofrohet/kërkohet në/nga ankandi;
- normën maksimale/ minimale ose fikse të interesit;
- datën dhe orën e ankandit;
- datën e kryerjes së veprimit të kundërt;
- datën e pastrimit dhe të rregullimit të llogarive.

Box 1: Hapat operacionalë për zhvillimin e ankandeve.

Hapi 1. ***Njoftimi për ankandin.***
Banka e Shqipërisë njofton të gjitha bankat për llojin dhe për kushtet e ankandit me një prej sistemeve të informacionit si: SWIFT, teleks, REUTERS, faks ose me shkresë zyrtare.

Hapi 2. ***Dorëzimi i kërkesave për ankand.***
Bankat dërgojnë kërkesat e tyre për pjesëmarrje në ankand me teleks, REUTERS, faks ose me shkresë zyrtare në Departamentin e Operacioneve Monetare në Bankën e Shqipërisë.

Hapi 3. ***Shqyrtimi i kërkesave.***
Kërkesat e bankave për pjesëmarrje në ankand shqyrtohen nga një komision me anëtarë të përhershëm, të zëvendësueshëm në rast mungese, punonjës të Departamentit të Operacioneve Monetare dhe të Politikës Monetare si dhe të Ministrisë së Financave.

Hapi 4. ***Plotësimi i kërkesave dhe njoftimi i rezultatit të ankandit.***

a. Komisioni vendos për plotësimin e kërkesave.
b. Pas përfundimit, bankat pjesëmarrëse marrin njoftimin përkatës për rezultatet e ankandit.

Hapi 5. ***Njoftimi për rezultatin e ankandit për të gjitha bankat.***
Hapi 6. ***Kalimi i veprimeve pas përfundimit të ankandit.***

Si për ankandin standard ashtu edhe për ankandin e shpejtë, ndiqen të njëjtat procedura për shpalljen e njoftimit të ankandit.

DORËZIMI I KËRKESAVE PËR PJESËMARRJE NË ANKAND

Kërkesat e bankave të nivelit të dytë për

pjesëmarrje në ankandet e marrëveshjeve (të anasjellta) të riblerjes duhet të përmbajnë informacionin e mëposhtëm:

- datën e ankandit;
- numrin e ankandit;
- tipin e ankandit (shitje/blerje nga këndvështrimi i Bankës së Shqipërisë);
- datën e kryerjes së vepimit të kundërt;
- emrin dhe informacionin për bankën pjesëmarrëse;
- shumën e pjesëmarrjes në ankand në lekë (me shifër dhe me fjalë);
- shumën e bonos së thesarit që përdoret si kolateral (në rastin e përdorimit të kolateralit);
- interesin e riblerjes, shprehur në dy numra pas presjes vetëm në rastin e ankandit me shumë çmime;
- emrin dhe firmën e personit të autorizuar.

Kërkesat me mungesë informacioni dhe të paraqitura më vonë se afati i fundit, nuk merren parasysh për pjesëmarrje në ankand.

PROCEDURAT PËR PLOTËSIMIN E KËRKESAVE (ANKANDI ME ÇMIM FIKS)

Në ankandet e marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes me çmim fiks, bankat cilësojnë vetëm shumën e kërkuar në ankand. Komisioni i organizimit të ankandit llogarit kërkesën agregate të bankave të nivelit të dytë duke u paguar bankave ose duke marrë nga to (sipas tipit të ankandit shitje ose blerje) normën fikse të interesit, të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

PROCEDURAT PËR PLOTËSIMIN E KËRKESAVE (ANKANDI ME SHUMË ÇMIME)

Në ankandet e marrëveshjeve të riblerjes ose të anasjellta të riblerjes me shumë çmime, bankat saktësojnë në kërkesat e tyre normën e interesit dhe shumën që ato kërkojnë. Bankat pjesëmarrëse në ankand, që kërkojnë normë interesi më të lartë/më të ulët se norma maksimum/minimum e publikuar nga Banka e Shqipërisë skualifikohen automatikisht.

Kërkesat rradhiten në mënyrë rritëse/zbritëse sipas interesit të riblerjes, që ato kanë kërkuar. Nëse shuma e kërkuar nga bankat është më e vogël ose e barabartë me shumën e ofruar nga Banka e Shqipërisë, të gjitha kërkesat e bankave shpallen fituese automatikisht. Në rastet kur shuma e kërkuar nga bankat është më e lartë se shuma e ofruar nga Banka e Shqipërisë, atëherë aplikohet *prorata*, në mënyrë të barabartë për të gjitha kërkesat me interes të riblerjes më të lartë/më të ulët, por të barabartë ndërmjet tyre, për shumën derisa të barazohet me shumën e ofruar nga Banka e Shqipërisë. *Prorata* do të jetë e barabartë me raportin e sasisë së mbetur për t'u shpërndarë, me shumën e kërkesave me interes të riblerjes më të lartë/më të ulët, të barabartë.

NJOFTIMI PËR REZULTATET E ANKANDIT

Pas përfundimit të ankandit, Banka e Shqipërisë njofton bankat pjesëmarrëse për rezultatet e ankandit. Ky njoftim përmban informacionin e mëposhtëm:

- numrin e ankandit;
- tipin e ankandit (shitje/blerje);
- llojin e ankandit;
- datën e ankandit;
- datën e kryerjes së veprimit të kundërt;
- datën e pastrimit dhe të rregullimit të llogarive;
- shumën dhe interesin e kërkuar nga banka;
- shumën dhe interesin e ofruar nga Banka e Shqipërisë;
- shumën përkatëse të fituar nga banka pjësmarrëse.

Përveç bankave pjesëmarrëse në ankand, njoftohen të gjitha bankat e sistemit. Njoftimi që u dërgohet bankave të sistemit përmban informacion vetëm mbi shumën totale të ofruar, shumën totale të kërkuar nga bankat pjesëmarrëse dhe shumën totale të pranuar nga Banka e Shqipërisë, ndërsa kërkesat specifike të secilës bankë dhe rezultatet lidhur me to, iu bëhen të ditura vetëm bankave përkatëse.

REAGIMI I TREGJEVE NDAJ VENDIMEVE TË POLITIKËS MONETARE.[1]

Vendimet e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë për ndryshimin e interesit bazë të tregut janë përcaktuese në sjelljen e interesave në tregje. Bazuar në njoftimin e bërë nga Banka e Shqipërisë për ndryshimin e qëndrimit të politikës monetare, tregjet sigurojnë informacionin e nevojshëm, i cili shërben si sinjal për ndryshimet e interesave.

Niveli i zhvillimit të tregut financiar në Shqipëri, struktura më e zhvilluar e të cilit konsiderohet sektori bankar, bën që vendimet e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë të ndikojnë kryesisht në tregun e parasë duke mbetur kështu të kufizuar në një afat kohor jo më të gjatë sesa një vit. Kjo pasi nuk mund të flasim për ndikim të vendimeve të politikës monetare në çmimet e aseteve në kushtet kur nuk ekziston tregu i këtyre aseteve dhe në periudha kohore më të gjata sesa një vit.

Transmetimi i vendimeve të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë në vite të ndryshme ka specifikat e veta, të cilat janë kushtëzuar nga instrumentet e përdorura nga Banka e Shqipërisë për të transmetuar vendimet në tregje, nga zhvillimet që ka njohur vetë tregu i parasë, nga ndryshimet strukturore që ka njohur sektori bankar si shtimi i numrit të bankave, rritja e peshës së bankave me kapital joshtetëror kundrejt bankave me kapital shtetëror, rritja e numrit të bankave aktive në tregje, rritja graduale e konkurrencës në tregje të ndryshme etj..

Në vazhdim, do të përpiqemi të analizojmë se si janë transmetuar vendimet e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë në periudha të ndryshme kohore, për të evidentuar zhvillimet që janë shënuar në procesin e transmetimit si nga pikëpamja e progresit të bërë, ashtu edhe nga pikëpamja e pengesave që kanë frenuar rritjen e efikasitetit të këtij transmetimi.

Tabelë 1. Qëndrimi i politikës monetare të Bankës së Shqipërisë për periudhën 1997-2002.

Sinjali i politikës monetare	Data ndryshimit të interesit bazë.	Istrumenti kryesor i përdorur nga Banka e Shqipërisë.	Ndryshimi i interesit bazë në pikë përqindjeje	Interesi bazë i Bankës së Shqipërisë
VITI 1997, NDRYSHUAR 8 HERE		Interesi i depozitave me afat për bankat me kapital tërësisht shtetëror		
Politikë shtrënguese	30 janar	12 mujore 6 mujore 3 mujore	+3.0 +2.5 +2.0	22.0 21.0 20.0
Politikë shtrënguese	5 mars	12 mujore 6 mujore 3 mujore	+6.5 +7.0 +6.5	28.5 28.0 27.0
Politikë shtrënguese	22 maj	3 mujore	+7.0	34.0
Politikë shtrënguese	27 qershor	3 mujore	+3.0	37.0
Politikë e lehtësuar	18 shtator	3 mujore	-2.0	35.0
Politikë e lehtësuar	10 nëntor	3 mujore	-3.0	32.0
Politikë e lehtësuar	24 nëntor	3 mujore	-2.0	30.0
Politikë e lehtësuar	3 dhjetor	12 mujore 6 mujore 3 mujore	-1.5 -2.0 -4.0	27.0 26.0 26.0
VITI 1998, NDRYSHUAR 5 HERE		Interesi i depozitave me afat për bankat me kapital tërësisht shtetëror		
Politikë e lehtësuar	19 maj	12 mujore 6 mujore 3 mujore	-3.0 -2.0 -2.0	24.0 24.0 24.0

[1] Punuar nga Suzana Sheqeri dhe Arta Pisha, Departamenti i Kërkimeve dhe Politikave Monetare

Politikë e lehtësuar	18 qershor	12 mujore 6 mujore 3 mujore	-3.0 -2.0 -2.0	21.0 22.0 22.0
Politikë e lehtësuar	24 gusht	12 mujore 6 mujore 3 mujore	-2.0 -2.0 -1.0	20.0 20.0 20.0
Politikë e lehtësuar	22 tetor	12 mujore 6 mujore 3 mujore	-2.0 -2.0 -2.0	18.0 18.0 18.0
Politikë e lehtësuar	12 nëntor	12 mujore 6 mujore 3 mujore	-1.5 -1.5 -1.5	16.5 16.5 16.5
VITI 1999, NDRYSHUAR 6 HERE		Interesi i depozitave me afat për bankat me kapital tërësisht shtetëror		
Politikë e lehtësuar	17 shkurt	12 mujore 6 mujore 3 mujore	-1.5 -1.0 -1.0	15.0 15.5 15.5
Politikë e lehtësuar	27 maj	12 mujore 6 mujore 3 mujore	-1.0 -1.0 -1.0	14.0 14.5 14.5
Politikë e lehtësuar	2 qershor	12 mujore 6 mujore 3 mujore	-1.0 -1.0 -1.0	13.0 13.5 13.5
Politikë e lehtësuar	7 korrik	12 mujore 6 mujore 3 mujore	-2.0 -2.0 -2.0	11.0 11.5 11.5
Politikë e lehtësuar	14 shtator	12 mujore 6 mujore 3 mujore	-1.0 -1.0 -1.0	10.0 10.5 10.5
Politikë e lehtësuar	3 nëntor	12 mujore 6 mujore 3 mujore	-1.00 -1.25 -1.25	9.00 9.25 9.25
VITI 2000, NDRYSHUAR 3 HERE	Liberalizimi i interesit të depozitave me afat për bankat me kapital tërësisht shtetëror dhe kalimi në përdorimin e ankandeve të repove			
Politikë e lehtësuar	19 janar	12 mujore 6 mujore 3 mujore	-0.50 -1.00 -1.25	8.50 8.25 8.00
Politikë e lehtësuar	29 mars	12 mujore 6 mujore 3 mujore	-0.50 -0.75 -1.00	8.0 7.5 7.0
Liberalizimi i interesave 6 mujore	17 maj			
Politikë e lehtësuar	7 qershor	12 mujore 3 mujore	-0.25 -0.50	7.75 6.50
Liberalizimi i interesave 12 mujore	19 korrik			
Politikë e lehtësuar	27korrik	Repo me shumë çmime &shumë të përcaktuar		9.00
Politikë e lehtësuar	3 gusht	Repo me shumë çmime &shumë të përcaktuar	-1.50	7.50
Politikë e lehtësuar	10 gusht	Repo me shumë çmime &shumë të përcaktuar	-0.50	7.45
Politikë e lehtësuar	17 gusht	Repo me shumë çmime &shumë të përcaktuar	-0.15	7.30
Politikë e lehtësuar	31 gusht	Repo me shumë çmime &shumë të përcaktuar	-0.30	7.00
Politikë e lehtësuar	7 shtator	Repo me shumë çmime &shumë të përcaktuar	-0.10	6.90
Politikë e lehtësuar	5 tetor	Repo me shumë çmime &shumë të përcaktuar	-0.40	6.50
Liberalizimi i interesave 3 mujore	6 tetor			
VITI 2001, NDRYSHUAR 1 HERE		Ankandet javore të repove/anasjelltë të repove		

VITI 2002, NDRYSHUAR 3 HERE			Ankandet javore të repove/anasjelltë të repove		
	Politikë shtrënguese	21 mars	Repo me çmim fiks	+0.5	7.5
	Politikë shtrënguese	10 prill	Anasjelltë repo me shumë çmime	+1.0	8.5
	Politikë neutrale	10 dhjetor	Anasjelltë repo me çmim fiks		8.5

Sipas të dhënave të tabelës 1, për periudhën 1997 –2002, Banka e Shqipërisë ka sinjalizuar tregun duke ndryshuar interesin bazë 26 herë ose mesatarisht 4.3 herë në një vit. Nga këto, 22 herë ose mesatarisht 5.5 herë në një vit, i përkasin periudhës 1997 –2000, periudhë në të cilën sinjalizimin e qëndrimit të politikës së saj monetare në treg e realizonte përmes instrumentit direkt të interesit të depozitave me afat për bankat me kapital tërësisht shtetëror dhe vetëm 4 herë ose mesatarisht 2 herë në një vit, përmes ndryshimit të interesit të instrumentit indirekt të repove njëjavore.

Sinjalet që ka transmetuar Banka e Shqipërisë në treg kanë qenë lehtësuese për pjesën më të madhe të kohës së marrë në shqyrtim. Përjashtim bëjnë viti 1997 dhe viti 2002, ku sinjalet e politikës monetare, në pjesën më të madhe të vitit, kanë qenë shtrënguese. Gjatë vitit 1997, tregu u sinjalizua katër herë për shtrëngime të politikës monetare, ndërsa gjatë vitit 2002 tregu u sinjalizua 2 herë. Edhe pse qëndrimi i politikës monetare është i njëjtë për të dyja periudhat, ndryshimet midis tyre qëndrojnë në mënyrën e transmetimit, në instrumentin e përdorur, në frekuencën e sinjaleve të transmetuara në treg, në masën e ndryshimit të interesit bazë, e cila në vitit 1997 ka qenë konsiderueshëm më e lartë krahasuar me vitin 2002 etj..

Këto qëndrime të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë në të dyja periudhat janë diktuar nga tronditjet që ka pësuar sektori bankar. Konkretisht, nga kriza e sistemit financiar e vitit 1997 pas falimentimit të firmave piramidale, e ndihmuar edhe nga dobësitë e sektorit bankar dhe paniku i depozitave në pranverën e vitit 2002, e cila ishte një ngjarje e pastër e sektorit bankar. Banka e Shqipërisë u pozicionua në rolin e siguruesit të qëndrueshmërisë së sistemit financiar, duke synuar kthimin e besimit të publikut në sistemin bankar. Rritja agresive e interesit bazë, gjatë periudhës janar - qershor të vitit 1997, tregoi se ishte efektive në kthimin e likuiditetit në sistem. Pas falimentimit të skemave piramidale, të cilat kishin thithur një pjesë të madhe të depozitave, bankat u treguan të shpejta në rritjen e normave të interesit. Shpejtësia e reagimit në drejtim të rritjes së interesave për depozitat me afat ishte e kushtëzuar edhe nga instrumenti i përdorur në atë periudhë, i cili kishte karakter administrativ dhe ishte i detyrueshëm për t'u zbatuar nga bankat me kapital tërësisht shtetëror. Ndërsa bankat e tjera të sistemit ishin të detyruara që të ndiqnin ndryshimet e interesave të bankave me kapital shtetëror për të mos humbur pjesë në tregun e depozitave në lekë, duke mbetur tërheqëse për publikun.

Tabelë 2. Reagimi në tregun e depozitave me afat në lekë, në pikë përqindjeje.

	Interesi depozitave 12 mujore	Interesi depozitave 3 mujore
Periudha janar – mars 1997		
Ndryshimi i interesit bazë.	+9.5	+8.5
Masa e reagimit të tregut		
Janar - mars	+6.86	+5.58
Janar - prill	+9.59	+8.51
Periudha maj -qershor 1997		
Ndryshimi i interesit bazë		+10.0
Masa e reagimit të tregut		
Maj - korrik		+9.84
Periudha shtator - dhjetor 1997		
Ndryshimi i interesit bazë	-1.5	-11.0
Masa e reagimit të tregut		
Shtator - dhjetor	-1.17	-7.99

Të dhënat e tabelës 2 tregojnë se në tregun e depozitave shtrëngimi i politikës monetare me 9.5 pikë përqindjeje për depozitat dymbëdhjetëmujore dhe 8.5 pikë përqindjeje për depozitat tremujore, gjatë periudhën janar-mars, u transmetua rreth 72.2 për qind për depozitat vjetore dhe rreth 65.4 për qind për depozitat tremujore brenda periudhës janar – mars. Ndërsa transmetimi i plotë, në masën 100.0 për qind, u arrit në muajin prill.

Vlen të përmendin se për periudhën në fjalë tregu i depozitave sundohej në masën 93.9 për qind nga bankat me kapital tërësisht shtetëror. Por, kjo rritje administrative e interesave në tregun e depozitave në lekë diktonte rritje të kostos së pranimeve të reja të depozitave për bankat. Mbulimin e kostos së krijuar, bankat e sistemit e transmetuan në tregun primar të bonove të thesarit duke çuar në një rritje të shpejtë dhe paralele të *yield*-it të bonove të thesarit. Rritja e *yield*-it sipas maturiteteve përputhej me rritjen e interesit të depozitave në lekë për të njëjtat maturitete. Konkretisht, ajo qe më e lartë për bonot e thesarit tremujore, nga 20.4 për qind në muajin janar 97, në 38.22 për qind në gusht[1] (ose 17.82 pikë përqindjeje) dhe më e ulët për bonot dymbëdhjetëmujore, nga 22.5 për qind në janar 97 në 35.5 në muajin gusht 97 (ose 13 pikë përqindjeje).

Grafik 1. Sjellja e tregut të depozitave ndaj vendimeve të politikës monetare për vitin 1997. Në për qind.



Tabelë 3. Reagimi në tregun e bonove, në pikë përqindjeje.

	Yieldi i bonove 12-mujore	Yieldi i bonove 3-mujore
Periudha janar – mars 1997		
Ndryshimi i interesit bazë.	+9.5	+8.5
Masa e reagimit të tregut		
Janar - mars	+9.49	+7.80
Janar - prill	+9.49	+8.92
Periudha maj -qershor 1997		
Ndryshimi i interesit bazë		+10.0
Masa e reagimit të tregut		
Maj - korrik		+8.19
Periudha shtator - dhjetor 1997		
Ndryshimi i interesit bazë	-1.5	-11.0
Masa e reagimit të tregut		
Shtator - dhjetor	-0.50	-2.92

[1] Në muajin gusht yield-et shënuan nivelin më të lartë.

Në dallim nga tregu i depozitave, në tregun e bonove masa e reagimit të tregut është më e lartë brenda periudhës së ndryshimit të interesit bazë duke treguar për një transmetim më të shpejtë në këtë treg në kahun shtrëngues të politikës monetare. Ndërsa vërehet e kundërta në kahun lehtësues të politikës monetare. Shpjetësia e reagimit në tregun e depozitave është ndjeshëm më e lartë krahasuar me tregun e bonove.

periudhës së lehtësimit të politikës monetare duke arritur në 6.4 pikë përqindjeje. Luhatshmëria ndaj nivelit mesatar mujor të këtij viti është shumë e lartë. Ndërsa për maturitetin dymbëdhjetëmujor kjo diferencë erdhi duke u zgjeruar nga 3.4 pikë përqindjeje në muajin janar, në 7.2 pikë përqindjeje në muajin dhjetor 97, duke shënuar një nivel mesatar mujor 5.2 pikë përqindjeje. Marzhi i fitimit për këtë maturitet është dushkëm shumë i lartë.

Grafik 2. Sjellja e *yield*-it të bonove të thesarit pas ndërhyrjeve të Bankës së Shqipërisë. Në përqindje.



Ndërthurja e këtyre tendencave, në kushtet lehtësuese, ka ndikuar në rritjen e diferencave midis interesave respektivë të këtyre tregjeve. Konkretisht, ndërsa diferenca midis interesave të depozitave dhe *yield*-it të bonove tremujore zgjerohet në 4.77 pikë përqindjeje, në fillim të periudhës së shtrëngimit të politikës monetare, ajo manifeston të njëjtën sjellje edhe gjatë

Si periudha e shtrëngimit të politikës monetare ashtu edhe periudha e lehtësimit të politikës monetare janë shoqëruar me zgjerime të diferencës së interesave duke nxjerrë në pah një treg me nivel të ulët konkurrence dhe ndikimin administrativ mbi nivelin e interesave në tregun e depozitave në lekë.

Grafik 3. Diferenca midis interesave të depozitave&bonove të thesarit sipas maturiteteve 3 dhe 12-mujore dhe niveli mesatar, në pikë përqindjeje.



Gjithashtu, krahas luhatshmërisë së diferencës midis interesave për maturitete të njëjta në tregje të ndryshme, evidentohet se marzhi i fitimit ka rezultuar më i lartë për maturitetet afatgjata, kundrejt një marzhi më të ulët për maturitetet afatshkurtra. Ruajtja e këtyre diferencave në marzhet e fitimit për maturitete të ndryshme përbëntë një fitim të pamerituar për bankat, duke rritur në mënyrë jo të drejtë deficitin buxhetor dhe borxhin e brendshëm.

E njëjta situatë paraqitet edhe në tregun e kredive në lekë. Edhe pse diferenca midis interesave për depozitat dhe interesave për kreditë, pas rritjes së interesave të depozitave mbetej e lartë, bankat i rritën interesat e zbatuar për kredinë në lekë duke e kaluar një pjesë të kostos së tyre në kreditimin e ekonomisë. Interesi për kredinë nga 6 muaj deri në një vit u rrit nga 24 për qind në janar në 43 për qind në dhjetor (ose 19 pikë përqindjeje), ndërsa interesi për kreditë mbi tre vjet u rrit nga 15.7 për qind në 21.02 për qind (ose 5.32 pikë përqindjeje).

monetare të Bankës së Shqipërisë, gjatë vitit 1997, në tregje konsiderohet i shpejtë dhe i plotë me një muaj vonesë në të gjitha tregjet dhe për të gjitha maturitetet. Diferencat e interesave për të njëjtat maturitete në tregje manifestojnë luhatshmëri të lartë gjatë vitit dhe për maturitetin njëvjeçar një nivel të lartë. Kjo sjellje reflekton prirjen e bankave për të siguruar fitime të larta. Ndërsa luhatshmëria e lartë diktohet nga forma administrative e sinjalizimit të qëndrimit të politikës monetare në tregun e depozitave. Nga ana tjetër, pozicioni dominues i Bankës së Kursimeve në tregun e depozitave, e bënte edhe më të vështirë konkurrencën e bankave të tjera të sistemit në lojën e interesave në tregun primar të bonove dhe në tregun e kredive në lekë.

Tronditja për të dytën herë e sektorit bankar, nga krijimi i papritur i panikut të depozitave kushtëzoi vendimet e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë gjatë viti 2002. Kjo situatë u shoqërua me rritjen e parasë jashtë bankave[2], rritjen e presioneve inflacioniste[3], luhatjen e

Grafik 4. Sjellja e interesave në tregun e kredive në lekë, në përqindje.



Rritja më e lartë e interesave për depozitat me afat tremujor, krahasuar me dy maturitetet e tjera, u shoqërua me rritjen më të lartë të interesave për maturitetet me afat më të shkurtër, si në tregun e bonove, ashtu edhe në tregun e kredive, duke diktuar rritje të shpejtë të deficitit buxhetor dhe ulje të normës së fitimit të bizneseve të kredituara për periudha afatshkurtër. Në përgjithësi, transmetimi i vendimeve të politikës kursit të këmbimit etj.. Paniku i krijuar në rradhët e depozituesve krijoi mungesë të menjëhershme të likuiditetit në sistem, e cila u transmetua në tregun e depozitave, pasi bankat e prekura nga paniku nuk disponoin likuiditetin e nevojshëm për të mbuluar kërkesat e depozituesve dhe në tregun primar të bonove të thesarit, pasi sistemi bankar nuk plotësonte shumat e ofruara nga qeveria në treg primar[4].

[2] Muajit mars dhe prill u shoqëruan me rritje të shpejtë, prej 16.4 miliardë lekësh.
[3] Rritja e çmimeve u manifestua kryesisht në nivelin e çmimeve të prodhimeve bujqësore, sidomos në rrethet e Vlorës dhe të Fierit, ku edhe fenomeni i tërheqjes së depozitave qe më i theksuar.
[4] Kjo ishte e pritshme, pasi pesha e dy bankave të përfshira në fenomenin e tërheqjes së depozitave në portofolin e bonove të thesarit që zotëronin bankat e nivelit të dytë llogaritej rreth 89.9 për qind.

Ndërhyrja e Bankës së Shqipërisë qe e shpejtë dhe e përcaktuar sipas një plani veprimesh. Në treg u ndërhy tërësisht me instrumente indirekte për t'i krijuar tregut të gjithë likuiditetin e nevojshëm. Kështu, u ndryshua pozicioni i Bankës së Shqipërisë nga tërheqëse e likuiditetit në injektuese të likuiditetit, duke mundësuar injektimin me frekuencë të rregullt javore të likuiditetit në treg. Paralelisht u përdorën edhe instrumente të tjera si blerjet dhe shitjet me të drejta të plota, lehtësia e kredisë njëditore, kredia lombard, repo njëmujore. Ndërkohë, për të rritur bashkëveprimin midis bankave u ndërpre gjatë dhjetëditëshit të parë të muajit prill përdorimin i lehtësisë së depozitës njëditore. Tkurrja e shpejtë dhe e paparashikuar e gjendjes së depozitave në Bankën e Kursimeve dhe në Bankën Kombëtare Tregtare u transmetua dukshëm dhe menjëherë në tregun primar të bonove të thesarit. Nevojat e qeverisë herë tregun për shtrëngim të politikës së saj monetare.

Edhe pse sinjalet e politikës monetare ishin shtrënguese, ashtu si dhe gjatë vitit 1997, krahasueshmëria e reagimit të tregjeve paraqet vështirësi në disa drejtime. Konkretisht, rritja e normave te interesit gjatë vitit 2002 nuk ishte në të njëjtat përmasa me atë të vitit 1997, dhe për më tepër, transmetimi i vendimeve në tregun e depozitave ishte indirekt dhe jo administrativisht i detyrueshëm. Mbi nivelin e interesave ndikohej edhe me instrumentet e tjera, gjithashtu, edhe numri i lojtarëve në treg kishte ndryshuar. Politika monetare e Bankës së Shqipërisë, gjatë vitit 2002, zbatohej vetëm me instrumente indirekte. Tashmë në treg ekzistonte një korridor orientues interesash të tregut dhe tregu ndërbankar, ndonëse jo i formuar plotësisht, kishte një eksperiencë.

Grafik 5. Niveli i interesave të zbatuara nga Banka e Shqipërisë përmes intrumenteve indirekte, në përqindje.



për financim nuk arrinin të plotësoheshin nga tregu. Për pjesën e pambuluar të financimit të brendshëm Banka e Shqipërisë akordoi kredi direkte, duke respektuar kufijtë e lejuar për vitin 2002.

Kjo ndërhyrje në treg, duke plotësuar mungesat e likuiditetit ishte e nevojshme për të garantuar qëndrueshmërinë e sistemit. Në perspektivë prioritet merrte kthimi i besimit të humbur të publikut në bankat e sistemit. Nisur edhe nga eksperienca e vitit 1997, Banka e Shqipërisë rriti normën e interesit të repove. Deri në mesin e muajit prill, Banka e Shqipërisë sinjalizoi dy Format krejt të ndryshme të transmetimit të qëndrimit të politikës monetare dhe fleksibilitetit që ofronin instrumentet indirekte të përdorura, krahasur me ato direkte, diktuan edhe një formë tjetër të sjelljes së tregjeve nga ajo e vitit 1997.

Çdo vendim i politikës monetare të Bankës së Shqipërisë u shoqërua me rritje të menjëhershme dhe të plotë të interesit të transaksioneve në treg ndërbankar, të diktuara këto nga ndryshimi i korridorit të lehtësive të ofruara. Ndërkohë, në këtë treg kërkesa për likuiditet ishte më e lartë sesa oferta.

Grafik 6. Sinjalet e Bankës së Shqipërisë dhe reagimet në tregje (në pikë përqindjeje).



Sinjalizimi i tregut për shtrëngim të politikës monetare, i ndërthurur me kërkesën më të lartë për fonde të buxhetit të shtetit krahasuar me vlerën nominale të maturimeve në çdo ankand të vitit të kaluar, kryesisht si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave nga privatizimi, ndikuan në përshpejtimin e rritjes së *yield*-it të bonove të thesarit për të gjitha maturitetet. Rritja e *yield*-eve ishte e menjëhershme, por jo e plotë.

Vetëm brenda muajit prill, sinjalet e politikës monetare u transmetuan në masën 81.3 për qind për bonot njëvjeçare dhe 96.0 për qind për bonot tremujore. Në muajin maj, rritja në maturitetin tremujor e kalon rritjen e interesit bazë të Bankës së Shqipërisë.

Sjellja e interesave të bonove të thesarit paraqet rritjen më të shpejtë të tyre në afatin e shkurtër të maturimit, duke sjellë një sheshim të kurbës kohore të normave të interesit, e cila zgjati deri muajin gusht. Në përgjithësi, brenda një periudhe dymujore për maturitetet afatshkurtra dhe gjashtëmujore për bonot njëvjeçare u arrit të transmetohej plotësisht sinjali i politikës monetare të Bankës së Shqipërisë në tregun e bonove.

Yield-et e bonove të thesarit manifestuan tendenca rritëse në shtator dhe tetor, duke u shoqëruar me rritje më të forta në muajin nëntor[5]. Deri në fund të vitit, llogaritet që *yield*-i i bonove njëvjeçare u rrit sa dyfishi i rritjes së interesit bazë, ndërsa *yield*-i i bonove tremujore llogaritej 1.42 herë më i lartë sesa rritja e interesit bazë.

Tabelë 4. Reagimi në tregun e bonove, në pikë përqindjeje.

	Interesi i repove	Yieldi i bonove 12 mujore	Yieldi i bonove 3 mujore
Periudha mars – prill 2002			
Ndryshimi i interesit bazë.	+1.5		
Masa e reagimit të tregut			
Mars – prill		+1.22	+1.45
Mars- maj		+1.31	+1.81
Mars- shtator		+1.78	+2.31
Mars - dhjetor		+3.21	+2.13

[5] Jo vetëm si rezultat i rritjes së kërkesës së qeverisë më shumë se oferta në treg, por edhe i gjenerimit të ngadaltë të likuiditetit pas tërheqjeve masive dhe kostos së krijuar nga pagimi i primit të sigurimit Agjencisë së Sigurimit të Depozitave.

Grafik 7. *Yield*-i mesatar i ponderuar në treg primar (në përqindje).



Veprimi qe më i ngadalësuar dhe i distancuar në kohë në tregun e depozitave në lekë. Bankat e prekura nga fenomeni i tërheqjes së depozitave reaguan për herë të parë, në muajin maj dhe në përqindje të vogla. Rritja në këto nivele e interesit të depozitave në lekë nga Banka e Kursimeve nuk dha efektet e pritura në reagimin e publikut. Kjo diktoi një rritje të dytë të këtyre interesave gjatë muajit qershor.

bonove sipas maturiteteve përkatëse rezulton të jetë dukshëm më e ulët dhe manifeston një luhatshmëri më të vogël. Kjo diferencë paraqitet e qëndrueshme për maturitetin njëvjeçar. Luhatjet e kësaj diference, brenda vitit, kanë qenë në përgjithësi në nivele të ulta dhe janë zgjeruar kryesisht gjatë periudhës së shtrëngimit të politikës monetare. Megjithë tendencën në rritje përgjatë vitit, përsëri ajo është luhatur në kufij të ngushtë, 2.7 –3.3 pikë përqindjeje.

Tabelë 5. Reagimi në tregun e depozitave me afat në lekë, në pikë përqindjeje.

	Interesi i repove	Interesi depozitave 12 mujore	Interesi depozitave 3 mujore
Periudha mars – prill 2002			
Ndryshimi i interesit bazë.	+1.5		
Masa e reagimit të tregut			
Prill		+0.01	+0.06
Prill - qershor		+0.88	+0.78
Prill - korrik		+0.99	+1.05
Prill - dhjetor		+1.50	+1.07

Deri në fund të muajit korrik ose katër muaj që nga dhënia e sinjaleve në treg, tregu i depozitave i pasqyroi në nivel të kënaqshëm sinjalet e Bankës së Shqipërisë. Sipas maturiteteve, vërehet se sinjalet e politikës monetare në tregun e depozitave u transmetuan në masën 66.0 për qind për depozitat njëvjeçare dhe 70 për qind për depozitat tremujore. Transmetimi i plotë i vendimeve të Bankës së Shqipërisë në tregun e depozitave u shënua në fund të vitit për depozitave njëvjeçare ose vetëm pas 8 muajsh, ndërkohë që u arrit të transmetohej vetëm 71 për qind për depozitat tremujore.

Por, në ndryshim nga viti 1997, diferenca midis interesave të depozitave në lekë dhe *yield*-it të

Ndërsa diferenca për maturitetin tremujor është zgjeruar më shumë krahasuar me maturitetin njëvjeçar duke u rritur nga 1.06 pikë përqindjeje në muajin janar, në 3.23 pikë përqindjeje në muajin dhjetor. Luhatjet e saj kanë qenë më të larta ndaj nivelit mesatar mujor për vitin 2002 duke treguar se bankat janë prirur drejt sigurimit të një fitimi sa më të shpjetë në afat kohor.

Reagimi i tregut të kredive vazhdoi të mbetet i dobët në raport me sinjalet e politikës monetare. Mungesa e likuiditetit në sistem u transmetua dukshëm në tregun primar të bonove të thesarit, por nuk pati efekt në tregun e kreditimit të ekonomisë. Krahas faktorëve të tjerë si, ndryshimi i strukturës së kredive të reja,

Grafik 8. Diferenca midis interesave të depozitave&bonove të thesarit sipas maturiteteve 3 dhe 12-mujore dhe niveli mesatar, në pikë përqindjeje.



konkurrenca jo shumë e lartë, përqëndrimi i kreditimit kryesisht në valutë, kjo u kushtëzua dhe nga fakti që bankat e prekura nga tronditja kishin një shkallë të ulët ose pothuajse zero të kreditit në lekë. Transmetimi në nivele krejt të ndryshme i mungesës së likuiditetit në tregje, u kushtëzua nga shkalla e ulët ose pothuajse zero e kreditit në lekë nga ana e bankave të prekura nga tronditja dhe nga fakti që 75 për qind e kredisë për ekonominë është kredi në valutë.

Vlerësimet empirike të arritura në këtë material tregojnë se gjatë periudhës së shtrëngimit të politikës monetare, tregjet kanë prirje për të reaguar më shpejt dhe në përqindje më të larta në instrumentet që krijojnë fitime, kundrejt një reagimi më të vonuar dhe gradual në instrumentet që krijojnë kosto, duke konfiguruar në përfundim reagime jo të plota dhe jouniforme me "sferim kohor" të ndryshëm.

Transmetimi i vendimeve të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë, përgjatë vitit 2002, nga pikëpamja e përqindjeve të reagimit të tregjeve rezulton më e vonuar në kohë sesa ajo e realizuar përgjatë vitit 1997. Megjithatë, siç e theksuam edhe gjatë materialit, periudhat nuk janë të krahasueshme. Instrumenti bazë i përdorur gjatë vitit 2002, nuk kishte karakter administrativ të detyrueshëm për bankat, por sinjalizonte tregun për qëndrimin e politikës monetare dhe secili treg vepron sipas parimeve të lojës së tregut të lirë.

Sjellja e interesave në tregje të ndryshme reflektoi kushtet e secilit treg, nivelin e kërkesës dhe të ofertës për likuiditet. Ndoshta, transmetimi i vendimeve në tregje mund të ishte më i shpejtë dhe më i plotë në rast se nuk do të ekzistonte pozicioni dominues i Bankës së Kursimeve në treg, i cili edhe i reduktuar përgjatë vitit 2002, përsëri përbën një pengesë për vendosjen e të gjithë pjesëmarrësve të tregut në të njëjtat pozita.

Më konkretisht, gjatë vitit 2002, u vu re se kjo bankë nuk ishte shumë e interesuar për rritje të larta të interesave të depozitave në lekë. Kjo vonesë në reagim nga ana e kësaj banke, si kryesorja në tregun e depozitave, ndikonte në zgjatjen e afatit kohor të transmetimit të vendimeve të politikës monetare në tregun e depozitave në tërësi. Pra, edhe gjatë vitit 2002, konkurrenca në treg nuk qe aq e fortë për t'i bërë më aktive bankat në drejtim të shpejtësisë dhe të masës së rritjes së normave të interesit. Ky evidentohet si një faktor që ka përkeqësuar transmetimin e sinjaleve të politikës monetare. Transmetimi indirekt i vendimeve të politikës monetare për ndryshimin e interesit bazë, i ndërthurur edhe me përdorimin e intrumenteve të tjera që ndikonin mbi likuiditetin e sistemit, ka sjellë një reagim natyral të interesave në tregje, duke treguar për rritje të efektivitetit, pavarësisht nga pengesat. Kjo reflektohet në ngushtimin e diferencave midis interesave në tregun e depozitave dhe *yield*-it të bonove të thesarit për maturitetet afatgjata nga 5.2 pikë përqindjeje në vitin 1997, në 3.1 pikë përqindjeje në vitin 2002, ndërkohë që për maturitetin tremujor kjo diferencë është ruajtur në po ato nivele. Gjithashtu edhe luhatshmëria e këtyre

diferencave paraqitet më e zbutur gjatë vitit 2002, krahasuar me vitin 1997. Krahas përmirësimeve në kuadrin operacional të Bankës së Shqipërisë, efekt në ngushtimin e diferencave dhe zbutjen e luhatjeve ka dhënë edhe rritja e konkurrencës së bankave në tregun e bonove të thesarit njëvjeçare.

Nga ana tjetër, evidentohet se ndërsa gjatë periudhave të shtrëngimit të politikës monetare ka tendenca për reagime më të shpejta dhe në masa më të mëdha për interesat që sjellin të ardhura kundrejt atyre që krijojnë kosto, në periudhat e lehtësimit të politikës monetare vërehet reagimi i kundërt. Kjo është evidente gjatë vitit 1997. Ndërsa në fund të vitit 2002, edhe pse sinjalet e politikës monetare ishin neutrale, interesat në tregun e bonove vazhduan të rriten, kundrejt një niveli të stabilizuar të interesave të depozitave në lekë. Në të dyja rastet marzhi i fitimit të bankave zgjerohet. Këto momente, megjithë përmirësimet e shfaqura në vitin 2002, mbeten ende pika të dobta të cilat kërkojnë studime të veçanta.

Faktori që duket se ka peshën kryesore të ndikimit në reagimet e tregjeve ka qenë situata e likuiditetit në sektorin bankar, e cila ka krijuar terren për spekulime me interesat në kushtet kur edhe tregu i kredive në lekë ka qenë pothuajse joaktiv dhe Banka e Kursimeve ruan pozicionin donimues në tregun e depozitave dhe të bonove.

Gjithësesi, evidentohet përmirësimi i efektivitetit të transmetimit të politikës monetare, në faktin që deri në fund të vitit 2002, situata e krijuar nga paniku i depozitave u rikuperua plotësisht dhe besimi i humbur në bankat më të mëdhaja të sistemit bankar u rikthye, si dhe u përmbushëm me sukses objektivat sasiorë dhe objektivi i ruajtjes së stabilitetit të çmimeve. Tregjet arritën të përçonin sinjalet e vendimeve të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë.

BANKA TREGTARE E GREQISË (SHQIPËRI)

PASQYRAT FINANCIARE PËR 31 DHJETOR 2002

(DHE RAPORTI I EKSPERTIT KONTABËL TË AUTORIZUAR)

RAPORT I EKSPERTIT KONTABËL TË AUTORIZUAR

KPMG POLSKA AUDYT SP.Z.O.O.

ul. Chlodna 51, XVI p.
00-897 Ëarszava
Polska

Telefon:
+48 22 528 11 00

Telefaks:
+48 22 528 10 09

Drejtuar: Aksionerëve të BANKA TREGTARE E GREQISË (SHQIPËRI) SH.A

Ne revizionuam bilancin kontabël bashkëlidhur të BANKA TREGTARE E GREQISË (SHQIPËRI) SH.A, ("Banka") për vitin ushtrimor të mbyllur me datë 31 dhjetor 2002, dhe pasqyrave përkatëse të të ardhurave dhe fluksit të parasë për këtë ushtrim. Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare është përgjegjësi e Drejtimit të Bankës. Përgjegjësia jonë është që, bazuar në revizionin e kryer, të shprehim një opinon mbi këto pasqyra financiare.

Ne kryem revizionin në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Revizionit të publikuara nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve. Këto standarde kërkojnë që ne të planifikojmë dhe të kryejmë revizionin për të arritur një siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë gabime materiale. Revizioni përfshin ekzaminimin, mbi bazën e testeve, të evidencës që mbështet shumat dhe informacionet e dhëna në pasqyrat financiare. Revizioni përfshin, gjithashtu, vlerësimin e parimeve kontabël të përdorura dhe të çmuarjeve të rëndësishme të bëra nga Drejtuesit, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare. Ne besojmë se revizioni i kryer përbën një bazë të arsyeshme për opinionin tonë.

Opinioni ynë është që pasqyrat financiare paraqesin drejt, në çdo aspekt të rëndësishëm, gjendjen financiare të Bankës në 31 dhjetor 2002, si dhe rezultatet nga operacionet dhe flukset e parasë për ushtrimin e mbyllur në këtë datë, në pajtim me nenin 38 të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

28 MARS 2002,

KPMG POLSKA AUDYT SP. Z O.O.

(FIRMA)
DAVID POZZECCO
PARTNER

BANKA TREGTARE E GREQISË (SHQIPËRI)
BILANCI KONTABËL PËR 31 DHJETOR 2002

(në mijë Lekë)

		31 dhjetor 2002	31 dhjetor 2001
Aktivet	**Shënime**		
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	3	242,285	359,795
Kredi dhe paradhënie institucioneve të kreditit	4	1,039,871	435,923
Investime në letra me vlerë	5	680,524	292,915
Kredi dhe paradhënie klientëve	6	2,332,933	1,691,980
Makineri dhe pajisje	7	281,597	293,902
Aktive të patrupëzuara	8	27,095	37,918
Aktive të tjera	9	19,493	20,662
Totali i Aktiveve		**4,623,798**	**3,133,095**
Detyrimet			
Kredi dhe paradhënie nga institucionet e kreditit	10	1,172,075	37,480
Detyrimet ndaj klientëve	11	1,954,026	1,737,670
Detyrime të tjera	12	19,050	68,567
Totali i detyrimeve		3,145,151	1,843,717
Kapitali aksioner			
Kapitali i paguar	13	1,668,170	1,449,050
Diferencë rivlerësimi	13	(84,119)	(38,424)
Fitimi i mbartur (humbje e akumuluar)		(105,404)	(121,248)
Totali i kapitalit aksioner		1,478,647	1,289,378
Totali i detyrimeve dhe kapitalit aksioner		**4,623,798**	**3,133,095**

BANKA TREGTARE E GREQISË (SHQIPËRI)
PASQYRA E TË ARDHURA – SHPENZIMEVE DERI MË 31 DHJETOR 2002

(në mijë Lekë)

	Shënime	2002	2001
Të ardhura nga interesat	14	236,167	146,139
Shpenzime për interesat	15	(58,551)	(46,984)
Të ardhura neto nga interesat		177,616	99,155
Të ardhura nga komisionet	16	41,404	30,460
Shpenzime për komisione		(11,722)	(2,755)
Të ardhura neto nga komisionet		29,682	27,705
Rezultati neto nga këmbimet valutore		17,004	21,591
Të ardhura të tjera operative	17	12,663	9,773
		29,667	31,364
Provizione për humbje nga kreditë	6	(39,237)	(16,252)
Shpenzime të tjera operative	18	(181,884)	(167,781)
		(221,121)	(184,033)
Fitimi (humbja) përpara taksave		15,844	(25,809)
Tatim mbi fitimin	20	-	-
Fitimi (humbja) neto për vitin		**15,844**	**(25,809)**

BANKA TREGTARE E GREQISË (SHQIPËRI)
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2002

(në mijë Lekë).

	31 Dhjetor 2002	31 Dhjetor 2001
Fluksi i mjeteve monetare nga aktivitetet operuese		
Fitimi (humbja) neto	15,844	(25,809)
Rregullime për të kuadruar fitimin (humbjen) neto me fluksin neto të mjeteve monetare nga aktivitetet operuese		
Amortizimi (aktive të trupëzuara)	30,443	27,170
Amortizimi (aktive të patrupëzuara)	17,497	16,987
Provizione për humbje nga kreditë	39,237	16,252
Humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit e pajisjeve	807	-
Efektet e rivlerësimit	(39,812)	(73,637)
Fluksi i mjeteve monetare përpara ndryshimeve në aktivet e pasivet operuese	64,016	(39,037)
Ndryshime në aktivet dhe pasivet operuese		
(Rritja)/Pakësimi i kredive dhe i paradhënieve dhënë institucioneve të kreditit	(603,948)	746,295
Rritja e kredive dhe e paradhënieve dhënë klientëve	(680,190)	(1,625,154)
Rritje në aktive të tjera	1,169	22,273
Rritja/(Pakësimi) i kredive dhe paradhënieve nga institucionet e kreditit	1,134,595	(33,771)
Rritja e detyrimeve ndaj klientëve	216,356	952,918
Rritje/(Pakësim) në detyrime të tjera	(49,517)	25,513
Fluksi neto i mjeteve monetare i gjeneruar nga aktivitetet operuese	18,465	88,074
Fluksi i mjeteve monetare nga aktivitetet investuese		
Rritje e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara	(6,942)	(18,325)
Rritje e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara	(24,560)	14,922
Rritje në letra me vlerë	(387,609)	(175,706)
Fluksi neto i mjeteve monetare nga aktivitetet investuese	(419,111)	(179,109)
Fluksi i mjeteve monetare nga aktivitetet financuese		
Të ardhura nga emetimi i aksioneve	219,120	371,450
Fluksi neto i mjeteve monetare nga aktivitetet investuese	219,120	371,450
Rritja/Pakësimi në mjete monetare dhe ekuivalentet me to	(117,510)	241,378
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fillim të vitit	359,795	118,417
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fund të vitit (shënimi 3)	**242,285**	**359,795**

BANKA TREGTARE E GREQISË (SHQIPËRI)
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2002
(në mijë Lekë)

	Kapital i paguar	Diferencë rivlerësimi	Fitimi i mbartur	Totali
Balanca më 31 dhjetor 2000	1,077,600	35,213	(95,439)	1,017,374
Shpërndarja e humbjes për vitin 2000	-	4,161	-	4,161
Rritja në kapitalin e paguar	371,450	-	-	371,450
Ndryshime në diferencë rivlerësimi	-	(77,798)	-	(77,798)
Humbja neto për vitin	-	-	(25,809)	(25,809)
Balanca më 31 dhjetor 2001	**1,449,050**	(38,424)	**(121,248)**	**1,289,378**
Ndryshime në diferencë rivlerësimi	-	(45,695)	-	(45,695)
Rritja në kapitalin e paguar	219,120	-	-	219,120
Fitimi neto për vitin	-	-	15,844	15,844
Balanca më 31 dhjetor 2002	**1,668,170**	**(84,119)**	**(105,404)**	**1,478,647**

1. TË PËRGJITHSHME

COMMERCIAL BANK OF GREECE **(CBG)** është një institucion financiar ndërkombëtar me qendër në Greqi. Në tetor të vitit 1998, kjo bankë hapi filialin e saj në Shqipëri me zyrat qendrore në Tiranë, e cila në nëntor 1999 u autorizua të operojë në të gjitha fushat e aktivitetit bankar. Në tetor 1999, ky filial u quajt BANKA **NDËRTREGTARE** (Shqipëri) Sh.A. dhe gjatë vitit 2001 ndryshoi emrin në BANKA **TREGTARE** E GREQISË (Shqipëri) Sh.A. (këtej e tutje do të referohet si "CBG" ose "Banka"). Banka kryen aktivitetin e saj në përputhje me ligjin nr. 8565 të korrikut 1998 "Mbi sistemin bankar në Republikën e Shqipërisë" dhe me ligjin nr. 8269 të dhjetorit 1997 "Për Bankën e Shqipërisë".

Banka filloi aktivitetin e saj me një kapital aksioner prej 3,800,000 usd, i cili nga fundi i qershorit 2002 u rrit në 11,800,000 usd. Banka ka një staf prej 37 punonjësish përfshirë dy drejtues të huaj dhe operon vetëm brenda territorit gjeografik të Shqipërisë.

2. POLITIKAT THEMELORE TË KONTABILITETIT

(A) BAZAT E PËRGATITJES.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me nenin 38 të ligjit nr. 8365, datë 2 korrik 1998 "Për bankat në Republikën e Shqiipërisë".
Pasqyrat financiare janë paraqitur të rrumbullakuara në mijë lekë dhe të ndërtuara në bazë të parimit të kostos historike.

(B) MJETE MONETARE DHE EKUIVALENTE ME TO.

Mjete monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë bankënotat dhe monedhat metalike në arkë si dhe mjetet monetare të depozituara në Bankën Qendrore.

(C) MARRËVESHJET E RISHITJES DHE TË RIBLERJES.

Kur letrat me vlerë të borxhit shiten me angazhimin për t'i riblerë ato me një çmim të rënë dakord më parë, ato mbeten në bilanc dhe shuma e arkëtuar regjistrohet si "Kredi dhe paradhënie nga institucionet e kreditit". Anasjelltas, letrat me vlerë të borxhit të blera me një angazhim për t'i rishitur nuk regjistrohen në bilanc dhe shuma e paguar regjistrohet si "Kredi dhe paradhënie dhënë institucioneve të kreditit".

(D) INVESTIME NË LETRA ME VLERË.

Investimet në letra me vlerë përfshijnë bonot e thesarit dhe obligacionet qeveritare të blera me qëllim mbajtjen e tryre deri në maturim. Bonot e thesarit regjistrohen duke u bazuar në kosto, plus interesin e përllogaritur. Kur një bono thesari fiton interes, norma efektive e interesit llogaritet dhe mbartet.

Obligacionet qeveritare pqrfshihen nq bilanc mbi bazqn e kostos duke zbritur çdo provizion për pakësim të përhershëm të vlerës. Obligacionet regjistrohen me çmimin e blerjes, plus interesin e përllogaritur të kuponave të papaguar. Cdo zbritje e përfituar mbi vlerën nominale në momentin e blerjes mbartet në datën e shlyerjes së obligacionit.

(E) KREDITË DHE PARADHËNIET NDAJ KLIENTELËS DHE INSTITUCIONEVE TË KREDITIT.

Kreditë dhe paradhëniet ndaj klientelës dhe institucioneve të kreditit raportohen duke zbritur provigjonet e krijuara për humbjet e mundshme në mënyrë që të pasqyrojnë vlerën e tyre të rikuperueshme.

Për llogaritjen e provigjoneve, Banka i klasifikon kreditë në gjashtë kategori siç përshkruhet në rregulloren përkatëse të Bankës së Shqipërisë:

Tipi i kredisë	Ditë në vonesë	Provigjoni
Standarde	0 ditë	1%
E pakthyer në afat	1- 30 ditë	1%
Në ndjekje	31-90 ditë	5%
Nënstandarde	91-180 ditë	20%
E dyshimtë	181 – 365 ditë	50%
E humbur	Mbi 365 ditë	100%

(F) MAKINERI DHE PAJISJE

Makineri dhe pajisje regjistrohen sipas kostos minus amortizimin e akumuluar, i cili llogaritet me metodën lineare.

Normat vjetore të amortizimit të aktiveve të trupëzuara janë si më poshtë:

Ndërtesa	5%
Mjete transporti	20%
Pajisje zyre	20%
Kompjutera dhe pajisje elektronike	25%

(G) AKTIVE TË PATRUPËZUARA

Akitivet e patrupëzuara të Bankës regjistrohen bazuar në kosto minus amortizimin e akumuluar. Normat vjetore të amortizimit janë si më poshtë:

Shpenzime të nisjes dhe zgjerimit	20%
Programe kompjuterike	25%

(H) NJOHJA E TË ARDHURAVE.

Të ardhurat dhe shpenzimet për interes njihen në bazë të parimit të kompetencës (accruals), ndryshe nga interesi mbi kreditë e parregullta, i cili njihet në momentin e pagimit.

Të ardhurat nga komisionet merren në momentin që Banka u kryen një shërbim klientëve, duke përfshirë shërbimet e administrimit të mjeteve monetare, shërbimet komisionere dhe konsulencën financiare. Këto të ardhura njihen në momentin e kryerjes së shërbimit në fjalë.

(I) TË ARDHURAT NGA QIRAJA.

E ardhura nga qiraja njihet në pasqyrën e të ardhura – shpenzimeve në mënyrë lineare gjatë kohëzgjatjes së qirasë.

(J) TAKSIMI.

Banka përcakton tatimin në fund të vitit duke u bazuar në legjislacionin shqiptar mbi taksat. Në vitin 2002, tatimi mbi fitimin është llogaritur si 25 për qind i fitimit të tatueshëm. Fitimi i tatueshëm llogaritet duke rregulluar fitimin përpara taksave me disa zëra të ardhurash ose shpenzimesh sipas kërkesave të ligjit. (Detajet jepen në shënimin 20).

(K) TRANSAKSIONET NË MONEDHË TË HUAJ.

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në atë vendase sipas kursit të këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj, të deklaruara me kosto historike, konvertohen sipas normës së këmbimit të fundvitit. Diferencat nga konvertimi paraqiten në pasqyrën e të ardhurave - shpenzimeve. Aktivet dhe detyrimet jomonetare në monedhë të huaj, të deklaruara me kosto historike konvertohen sipas normës së këmbimit në datën e transaksionit, përveç zërit "Makineri dhe Pajisje" që konvertohet me normën e këmbimit të fundvitit. Referohu, gjithashtu, shënimit 7.

Kurset e këmbimit (nga Lekë në monedhë të huaj) për monedhat kryesore në datat 31 dhjetor 2002 dhe 2001 kanë qenë si me poshtë.

	2002	2001
USD	133.68	136.55
EUR	140.18	120.73
GBP	215.31	197.87
SFR	96.52	81.49

3. MJETET MONETARE DHE EKUIVALENTET ME TO.

Mjetet monetare dhe llogaritë me Bankën Qendrore janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2002	2001
Kartëmonedha dhe monedha metalike	46,462	160,306
Banka Qendrore		
Llogari rrjedhëse	6,484	6,919
Rezerva të detyrueshme	189,339	130,570
Depozita me afat	-	62,000
Totali	242,285	359,795

Në përputhje me kërkesat e Bankës së Shqipërisë, bankat duhet të mbajnë në Bankën e Shqipërisë një minimum prej 10 për qind të depozitave të klientëve si rezerve të detyrueshme.

4. KREDI DHE PARADHËNIE DHËNË INSTITUCIONEVE TË KREDITIT.

Kreditë dhe paradhëniet dhënë institucioneve të kreditit paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2002	2001
Llogari rrjedhëse		
Rezidentë	721	1,454
Jorezidentë	35,900	50,020
Llogari depozite dhe depozita me afat	1,003,250	384,449
Totali	1,039,871	435,923

Shumica e depozitave janë me bankën - mëmë, CBG si dhe me banka të tjera të lidhura. Pothuajse 53 për qind (2001: 93%) janë në Usd dhe pjesa tjetër në Euro. Normat e interesit luhaten nga 1.4 për qind në 3.28 për qind (2001: 3.3% ne 6.54%).

Shpërndarja gjeorgrafike e kredive dhe e paradhënieve, dhënë institucioneve të kreditit paraqitet si më poshtë:

	31 Dhjetor	
	2002	2001
Greqi	959,355	322,962
Shqipëri	52,721	101,879
Shtetet e Bashkuara të Amerikës	26,305	10,745
Të tjera	1,490	337
Totali	1,039,871	435,923

5. INVESTIME NË LETRA ME VLERË.

Letrat me vlerë mbahen deri në maturitet dhe përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor	
	2002	2001
Bono thesari	630,172	292,915
Obligacione qeveritare	50,352	-
Totali	680,524	292,915

Bono thesari.

Norma efektive e interesit të bonove të thesarit, gjatë vitit 2002, varioi nga 9.6 për qind dhe 13.6 për qind (2001: 7.6% dhe 13.9%). Bonot e thesarit sipas maturitetit jepen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2002			31 Dhjetor 2001		
	Vlera e blerjes	Interesi i përllogaritur	Vlera e bilancit	Vlera e blerjes	Interesi i përllogaritur	Vlera e bilancit
3- mujore	114,197	723	114,920	-	-	-
6- mujore	220,547	7,173	227,720	124,022	2,423	126,445
12- mujore	272,887	14,645	287,532	158,132	8,338	166,470
	607,631	**22,541**	**630,172**	**282,154**	**10,761**	**292,915**

Obligacionet qeveritare.

Gjate Dhjetorit 2002, Banka bleu dy obligacione qeveritare te emetuara ne monedhen vendase Leke. Ato kane nje maturitet prej 24 muajsh, skadojne ne Dhjetor 2004 dhe interesi merret cdo 6 muaj me nje kupon prej 14%. Detajet paraqiten si me poshte:

	31 Dhjetor 2002			
	Vlera e blerjes	Interesi i perllogaritur	Amortizimi i Primit	Vlera e Bilancit
24 mujore	50,085	269	(1.4)	50,352
	50,085	**269**	**(1.4)**	**50,352**

6. **KREDI DHE PARADHËNIE DHËNË KLIENTËVE.**

Kreditë dhe paradhëniet dhënë klientëve përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor	
	2002	2001
Kreditë dhe paradhëniet dhënë klientëve, bruto	2,389,261	1,709,071
Provizione për humbje nga huatë	(56,328)	(17,091)
Kreditë dhe paradhëniet dhënë klientëve, neto	2,332,933	1,691,980

Ndryshimet në provizionet për humbje nga huatë janë si më poshtë:

	2002	2001
Me 1 janar	17,091	839
Të vitit, neto nga rimarrjet	39,237	16,252
Më 31 dhjetor	56,328	17,091

Kreditë dhe paradhëniet ndaj klientelës detajohen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2002			31 Dhjetor 2001		
Kategoria	Individë	Shoqëri	Totali	Individë	Shoqëri	Totali
Standarde	328,113	1,250,250	1,578,363	181,041	1,528,030	1,709,071
Në ndjekje	-	810,898	810,898	-	-	-
Provigjone	(3,281)	(53,047)	(56,328)	(1,811)	(15,280)	(17,091)
Kredia neto	**324,832**	**2,008,101**	**2,332,933**	**179,230**	**1,512,750**	**1,691,980**

Tabela e mëposhtme paraqet shpërndarjen e ekspozimit të Bankës ndaj kredive dhënë klientelës sipas sektorëve të industrisë më 31 dhjetor 2002 dhe 2001:

	31 Dhjetor 2002	%	2001	%
Tregti	457,065	19.13	253,455	14.83
Industria përpunuese	381,565	15.97	370,185	21.66
Ndërtim	361,734	15.14	168,344	9.85
Pasuri të patundshme	312,276	13.07	170,053	9.95
Telekomunikacion	281,693	11.79	437,351	25.59
Import lëndësh djegëse	275,482	11.53	246,790	14.44
Prodhime të ndryshme	203,565	8.52	34,865	2.04
Shërbime	107,994	4.52	23,243	1.36
Të tjera	7,887	0.33	4,785	0.28
Kreditë dhe paradhëniet dhënë klientëve, bruto	2,389,261	100.00	1,709,071	100.00

7. AKTIVE TË QËNDRUESHME TË TRUPËZUARA.

Aktive të qëndrueshme të trupëzuara paraqiten si më poshtë:

	Ndërtesa	Kompjutera dhe pajisje elektronike	Pajisje zyre	Mjete transporti	Të tjera	Totali
Kosto						
Me 1 janar 2002	269,016	31,453	24,402	7,656	293	332,820
Shtesat	-	17,579	5,996	967	18	24,560
Pakësimet	-	(118)	(1,052)	-	(195)	(1,365)
Diferenca nga kursi i këmbimit	(5,654)	(1,391)	(600)	(189)	(3)	(7,837)
Më 31 dhjetor 2002	**263,362**	**47,523**	**28,746**	**8,434**	**113**	**348,178**
Amortizim i akumuluar						
Më 1 janar 2002	(14,727)	(13,331)	(7,321)	(3,319)	(220)	(38,918)
Amortizimi i vitit	(13,832)	(9,873)	(5,096)	(1,580)	(62)	(30,443)
Pakësimet	-	50	313	-	195	558
